| Metodat e vlerësimit: | <table border="0"> <tr> <td>Testimi i parë:</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Testimi i dytë:</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Seminaret</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Provimi final</td> <td>60%</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>100%</td> </tr> </table> | Testimi i parë: | 10% | Testimi i dytë: | 10% | Seminaret | 20% | Provimi final | 60% | Gjithsej | 100% |
| Testimi i parë: | 10% | | | | | | | | | | |
| Testimi i dytë: | 10% | | | | | | | | | | |
| Seminaret | 20% | | | | | | | | | | |
| Provimi final | 60% | | | | | | | | | | |
| Gjithsej | 100% | | | | | | | | | | |
| Literatura primare: | <ol style="list-style-type: none"> 1.Receptor Biology. 1st ed. M. Roberts & Kruchten A. Wiley-VCH, 2016 2.Essential Cell Biology, 4th ed. (Chapter 16). Bruce Alberts et al., 2014. | | | | | | | | | | |
| Literatura shtesë: | <ol style="list-style-type: none"> 1.Signal transduction: Pathways, Mechanisms and Diseases. Ari Sitaramayya. Springer; Heidelberg, 2016 2. Molecular Biology of the Cell. Alberts B. et al., 2007 (Chapter 15). | | | | | | | | | | |

| Hartimi i planit mësimor | |
|---------------------------------|---|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| <i>Java 1:</i> | Principet e përgjithshme të sinjalizimit qelizor |
| <i>Java 2:</i> | Tipet e sinjalizimit |
| <i>Java 3:</i> | Molekulat sinjalizuese – Ligandët. Molekulat gazore sinjalizuese. |
| <i>Java 4:</i> | Receptoret – klasifikimi i tyre |
| <i>Java 5:</i> | Struktura molekulare e receptoreve të lidhur me kanalet jonike |
| <i>Java 6:</i> | Mekanizmat e aktivizimit dhe inkubimit të receptoreve të lidhur me kanalet jonike |
| <i>Java 7:</i> | Struktura molekulare e receptoreve të shoqëruar me proteinën-G dhe klasifikimi i tyre |
| <i>Java 8:</i> | Vlerësimi i parë |
| <i>Java 9:</i> | Mekanizmat e aktivizimit dhe rrugët sinjalizuese përmes receptoreve të shoqëruar me proteinën-G |
| <i>Java 10:</i> | Struktura molekulare e receptoreve të lidhur me enzima dhe klasifikimi i tyre |
| <i>Java 11:</i> | Receptoret tirozine kinaza, receptoret e lidhur me tirozine kinaza, receptoret e ngjashëm me tirozine fosfataza |
| <i>Java 12:</i> | Receptoret serine/treonine kinaza, receptoret e lidhur me guanil ciklaza dhe receptoret e lidhur me histidin kinaza |
| <i>Java 13:</i> | Receptoret brendaqelizor – struktura dhe mekanizmi i sinjalizimit |
| <i>Java 14:</i> | Agonistët dhe antagonistët e ligandëve – interaksioni i tyre me ligandët |
| <i>Java 15:</i> | Vlerësimi i dytë |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse studenti nuk ndjek të paktën 75% të ligjëratave dhe seminareve, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

25. Biokimi gjenetike

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë-Drejtimi: Mjekësi e përgjithshmei; Katedra e Biokimisë |
| Titulli i lëndës: | BIOKIMI GJENETIKE |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti II-të; Sem. III-të |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 3 ECTS |
| Koha / lokacioni: | Amfiteatri i Fakultetit të Mjekësisë |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. asoc. Hidajet Paçarizi Prof.asoc. Valdete Topçiu-Shufta Prof. Ass. Zana Baruti Gafurri |
| Detajat kontaktuese: | Instituti i Biokimisë tel. 038/ 500-500-2302, 500-600-2309, 044 117 027, 049 137 239, 044 220 589. |
| Testet vlerësuese: | Testi vlerësues: Java e pesëmbëdhjetë e semestrit |
| Përshkrimi i lëndës | Biokimia gjenetike përqendrohet në patofiziologjinë, diagnozën dhe trajtimin e çrregullimeve metabolike të trashëguara. Ndërsa individualisht është e rrallë, incidenca e kombinuar e këtyre sëmundjeve ka të ngjarë të jetë më e madhe se 1: 3000 lindje të gjalla. Këto gjendje mund të paraqiten në periudhën neonatale si një sëmundje akute, kërcënuese për jetën, ose mund të shfaqen më vonë në fëmijëri me simptoma të neurodegenerimit progresiv, anomalive të skeletit dhe / ose dismorfisë. Kombinimi i ekzaminimit të zgjeruar të të porsalindurve dhe qasjeve të reja terapeutike, të tilla si terapia e zëvendësimit të enzimave deficient apo që mungojnë, ofron një përmirësim të dukshëm në menaxhimin e çrregullimeve metabolike. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi i modulit është që studenti të njihet me sëmundjet që janë si pasojë e çrregullimeve metabolike, |

| | |
|--|---|
| | <p>me mundësitë diagnostike duke aplikuar metodat e ndryshme biokimike si dhe ato gjenetike. Gjithashtu studenti do të kuptojë rëndësinë e identifikimit dhe mundësitë e ndërhyrjes në nivele të ndryshme në parandalimin e komplikimeve, mjekimin e mundshëm të çrregullimeve të tilla si dhe për t'i ofruar një kuptim themelor të teknikave gjenetike molekulare</p> |
| <p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p> | <p>Studenti do të:</p> <p>kuptojë dhe aftësohet që të identifikoj personat me probleme gjenetike dhe çrregullime që lidhen me të.</p> <p>Aftësohet që të dijë për mangësitë e ndryshme që lidhen me bazën gjenetike dhe mundësinë diagnostike.</p> <p>Të orientoi pacientin në mjekim të mundshëm dhe të dijë për mundësitë mjekuese në nivel të ndërhyrjes në gjenomë.</p> <p><i>Shkathësitë intelektuale</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Shfrytëzimi i duhur i burimeve për të ndihmuar në kuptimin e përmbajtjes këtij moduli. • Aftësimi për të diskutuar shkakun dhe pasojat e sëmundjeve të njeriut që rrjedhin nga çrregullimet e proceseve normale metabolike dhe gjenetike. <p><i>Shkathësitë praktike profesionale</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët duhet të janë të aftë të çmojnë literaturën dhe të paraqesin informacionet në mënyrë të kuptueshme dhe bindëse. • Studentët duhet të janë të aftë ti përpunojnë të dhënat eksperimentale bazike dhe të përdorin rezultatet për sqarimin e problemeve që kanë lidhje të përbashkët me sëmundjet e njeriut. <p><i>Shkathësitë për transferimin e njohurive</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i burimeve siç janë bibliotekat dhe <i>IT facilities</i>. • Paraqitja e e punës të një grupi në mënyrë të qartë. • Arsyetimi nga vetë studimi i tyre. |

| | |
|--|---|
| | <p>Qëndrimet dhe sjelljet Studentët do të mësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rëndësinë e ndjekjes së ligjëratave dhe seminareve. • Të tregojnë respekt për ekipin dhe për studentët tjerë, duke mbajtur qetësi në ligjëratat dhe seminare përderisa të mos kanë pyetje. |
|--|---|

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
|---|-----|-----------|-----------|
| Ligjërata | 1 | 1/15 | 15 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 1/3 | 3 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 1 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 1/15 | 15 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 1 | 1/15 | 15 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | 2 |
| Projektet,prezentimet ,etj | | | |

Totali

75

| | |
|-------------------------------------|--|
| Metodologjia e mësimdhënies: | Metodologjia e mësimdhënies përfshinë: ligjërata, ushtrime praktike, seminare, diskutim, dhe punë në grupe |
|-------------------------------------|--|

| | |
|------------------------------|--|
| Metodat e vlerësimit: | Vlerësimi bëhet me test ose me gojë. Pyetjet do të përgaditen nga banka e pyetjeve të cilat do të selektohen nga ekipi i profesorëve. Ato do të jenë të kombinuara; me |
|------------------------------|--|

| | |
|-------------------------------------|---|
| | një përgjigje të saktë, me disa përgjigje të sakta dhe me mundësi plotësimi me shkrim |
| Literatura | |
| Literatura bazë: | <ul style="list-style-type: none"> ▪ ABC of Clinical genetics, literatura online ▪ D. Thomas, textbook of Biochemistry with clinical correlation, 2006, Willei-Liss ▪ D. Metzeler Biochemistry, 2006, Israel |
| Literatura shtesë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Lubert Stryer. BIOCHEMISTRY, 1988, USA. 2. Norbert Titz. Clinical chemistry, USA, 2001 3. Thomas M.Devlin. Textbook of Biochemistry. Wiley-Liss, 2006 |
| Plani i dizajnuar i mësimit: | |
| Semestri III-të | |
| Java | Ligjerata që do të zhvillohet |
| Java e parë: | <p>Gabimet e lindura të metabolizmit.</p> <p>Objektivi: studenti do të njihet me trashëgiminë në nivel të kromozomeve autonome, si recesiv dhe domonant, si dhe trashëgiminë përmes kromozomit X.</p> |
| Java e dytë: | <p>Gjenomi human(gjenomiku funksional)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjenomi • Transkriptomi • proteomiku |
| Java e tretë: | <p>Sëmundjet e shkaktuara nga grumbullimi i glikogjenit</p> <p>Objektivi: Studenti do të njihet me llojet e enzimave që mungojnë në paraqitjen e ndryshimit , mundësitë diagnostike dhe terapeutike.</p> |
| Java e katërt: | <p>Pentozuria, metabolizmi i gallaktozës si dhe, fruktozemia</p> <p>Objektivi : Studentët njihen me pentozurit[esenciale dhe sekondare si dhe, metabolizmin e disa monosakarideve tjera dhe çrregullimin e mundëshëm.</p> |
| Java e pestë: | <p>Gabimet e lindura të metabolizmit të aminoacideve</p> <p>Objektivat: Studenti do të njihet me termat si fenilketonuri, alkaptonuri, albinizëm,</p> |

| | |
|-----------------------------|--|
| | hiperglicinemi, leucinozë, homocidtinemi, histidinemi si dhe ndryshimet në nivele molekulare të lidhura me këto ndryshime. |
| Java e gjashtë: | <i>Hiperamonemia</i> Studenti do të njihet me kushtet e rritjes së nivelit të amoniakut në gjak dhe defektet enzimatike dhe gjenetike që përcaktojnë mangësitë e enzimave në nivele të ndryshme gjatë ciklit të uresë |
| Java e shtatë: | Sëmundjet e deponimit të yndyrave (LSD) Objektivi: Studenti njihet me një numër sëmundjesh të lidhura me mangësitë e nezimave të ndryshme që shoqërohen me grumbullimin e yndyrave të ndryshme në qeliza dhe të cilat do të shkaktonin ndryshime klinike me pasoja. Përveç diagnostikës student merr njohuri për mundësitë e mjekimit në nivele molekulare ose edhe me ndërhyrje në nivelin e gjeneve të caktuar. |
| Java e tetë: | Mukopolisakaridozat Objektivi: Studenti do të njihet me sëmundjet e lidhura me grumbullimin e mukopolisakarideve siç është I – cell disease., me ecurinë, diagnostikon si dhe rëndësinë e manozë -6-fosfatit në diagnostikime të tyre. |
| Java e nëntë: | Fibroza cistike Objektivi: Studenti njihet me frekuencën e paraqitjes, diagnostikën orientuese si dhe vërtetimi i diagnozës, gjenezën si dhe masat parandaluese për komplikimet e mundshme. |
| Java e dhjetë: | Identifikimi i sëmundjeve gjenetike dhe bioinformatika Objektivi: Studenti njihet me mënyrën e identifikimit dhe diagnostikës të çrregullimeve të metabolizmit me bazë gjenetike, si dhe me metodat e inhibimit të caktuar në ekspresionin e gjeneve, korrigjimi i “ target gene mutacion correction”. |
| Java e njëmbëdhjetë: | Seminar në lidhje me bioinformatikën në gjenetikë |
| Java e dymbëdhjetë: | Marrja e materialit për analiza biogjenetike të çrregullimeve metabolike dhe gjenetike. |

| | |
|------------------------------|---|
| | Objektivi: studenti do të fitoi njohuri për mënyrën marrjes së materialit për hulumtim, përgatitja e lizatit të eritrociteve, përgatitja e lizatit të leukociteve konservimit të urinës për analizë të mëtejshme etj. |
| Java e trembëdhjetë: | Teknikat e gjenetikes molekulare (Molecular cloning.Polymerase chain reaction.Gel electrophoresis. Macromolecule blotting and probing.) |
| Java e katërbëdhjetë: | Përcaktimi i disa parametrave biokimik në urinë Objektivi: studenti do të njihet me metodat rutinë për përcaktimin cilësor të produkteve që lidhen me disa sëmundje si fenilketonurie, pentozuria, porfiria,etj <ul style="list-style-type: none">• Testi i klorurit ferrik me acidin fenilpiruvik• Testi i tirozوناftolit me tirozinë dhe derivatet e saj• Reaksioni i Millonit me tirozinë dhe derivatet e tirozinës• Testi i nitroprusidit me cistinë dhe homocistinë• Testi i nitroprusidit të argjendit me homocistinë |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Test vlerësues |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët do të mësojnë:

-Rëndësinë e ndjekjes së ligjëratave dhe seminareve.

-Të tregojnë respekt për ekipin dhe për studentët tjerë duke mbajtur qetësi në ligjëratat dhe seminare përderisa të mos kenë pyetje.

26. NUTRICIONI DHE DIETETIKA

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|-------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë - MP |
| Titulli i lëndës: | Nutricioni dhe Dietetika |
| Niveli: | bazik |
| Statusi lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti II/ semestri 3 |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 3 |
| Koha / lokacioni: | IKSHPK |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. Dr. Tahire Maloku-Gjergji |
| Detajet kontaktuese: | Tahire.gjergji@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | Nutricioni dhe Dietetika është modul me rëndësi të vecantë dhe studentët e marrin njohuritë bazike për rolin dhe rëndësinë e |

| | |
|---|---|
| | <p>ushqimit materiet ushqyese, efektet negative dhe positive të tyre në organizmin e shëndoshë dhe të semurë.</p> <p>Si ta ruajmë shëndetin nëpërmjet të ushqyerit e drejtë dhe si të mjekohemi me dietat specifike për sëmundjet e ndryshme në kombinim me terapinë medikamentoze.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Parimet bazë nga lëmia e nutricionit dhe dietetikës (zberthimi i nocionit për nutricion dhe dietetikë);</p> <p>Njohuritë themelore për grupet e nutrientëve, rolin dhe rëndësinë e tyre për shëndetin.</p> <p>Planifikimi racional i të ushqyerit</p> <p>Përpilimi i dietave të drejta për grup- moshat e ndryshme të njerëzve të shëndoshë.</p> <p>Regjimet dietetike për sëmundjet e vecanta.</p> <p>Stili i jetës, rekreacioni dhe dieta e shëndetëshme</p> |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Të dijë se ç'është nutricionit dhe si arrihet deri te zona normale e ushqyeshmërisë;</p> <p>Të përshkruan gjashtë klasat e nutrientëve, funksionin e tyre në shëndet, si dhe pasojat nga deficioni apo suficioni i tyre;</p> <p>Të përshkruan simptomat e malnutricionit</p> <p>Te përshkruan katër hapat themelore në vlerësimin e nutricionit (ushqyeshmërisë).</p> <p>Të përshkruan parimet themelore për një dietë të drejtë.</p> |

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënësve të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
|---|---|------------------|-----------------|
| Ligjërata | 1 | 1/15 | 15 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësuesin/konsulentin | 1 | 1/5 | 5 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiime,seminare | 1 | 1/15 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 1/2 | 2 |
| Koha e studimit vetanake të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 1/15 | 15 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 1 | 10/2 | 20 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | |
| Projektet,prezentimet ,etj | 1 | 1/3 | 3 |
| Totali | | | 75 |
| Metodologjia e mësimit: | Ligjerata interaktive, diskutim, studim rasti, prezentim I seminareve | | |

| | |
|------------------------------|--|
| Metodat e vlerësimit: | Provimi Nutricioni dhe Dietetika mbahet me test. Pyetjet në test janë me një përgjigje të mundshme, me shumë përgjigje të mundshme, me përgjigje të kryqëzuara, me plotësim dhe me shkruarje të përgjigjes. Provimi me test vlerësohet me pikë. Studenti kalon provimin nëse plotëson në mënyrë korrekte 51% të test-pyetjeve. Studenti nuk pranohet në provim pa indeks/ID. |
| Literatura bazë: | Ekologjia shëndetësore, Nurka Pranjiq, përkthyer në shqip nga Fadil Kryeziu, 2017 Nutricioni dhe sportistet Agron Rexhepi, 2010 Ekologjia Humane dhe Shëndeti publik: A.Pollozhani, V.Kendrovski, S.Krasniqi 2009 |
| Literatura shtesë: | Nutrition & Diet Therapy – 7-Th edition - Delmar Publishers; Carolynn E.Townsend & Ruth A. Roth <i>www. Who.int/food and Nutrition;</i> <i>cdc.gov/Nutrition and dietetics</i> |

Plani i dizajnuar i mësimit

| Java | Ligjerata që do të zhvillohet |
|------------------------------|---|
| Java e parë: | Hyrja, njoftimi me lëndën (prezentimi i Syllabusit), Literatura dhe web faqet, <u>Hyrja :historiku.Misioni,Objektivat</u> e lendes se Nutricionit |
| Java e dytë: | Roli dhe rëndësia e ushqimit |
| Java e tretë: | Makroelementet- proteinat, roli, rëndësia dhe pasojat |
| Java e katërt: | Makroelementet hidratet e karbonit dhe yndyrat, roli, rëndësia dhe pasojat |
| Java e pestë: | Mikroelementet- Vitaminat hidrosolubile roli, rëndësia, burimet, pasojat |
| Java e gjashtë: | Mikroelementet- Vitaminat liposolubile roli, rëndësia, burimet, pasojat |
| Java e shtatë: | Mineralet- roli, rëndësia, burimet, pasojat |
| Java e tetë: | Planifikimi racional i ushqimit |
| Java e nëntë: | Ekzaminimi i ushqyeshmerise metoda dietetike, funksionale dhe biokimike, ekzaminimet antropometrike, percaktimi i indeksit te mases trupore dhe peshes ideale trupore |
| Java e dhjetë: | Crregullimet e ushqyeshmërisë –Anoreksia dhe Bulemia |
| Java e njëmbëdhjetë: | Obeziteti, |
| Java e dymbëdhjetë: | Alergjite, intolerancat ushqimore, Celiakia |
| Java e trembëdhjetë: | Dieta te sëmundjet kardiovaskulare, dhe metabolike |
| Java e katërbëdhjetë: | Dieta te shtatëzënat , fëmijë dhe të moshuarit |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Përmbledhja e modulit |

Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.

27. Anatomia Klinike 1

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti I Mjekesise-Katedra e Anatomise |
| Titulli i lëndës: | Anatomia Klinike 1 per studentet e Mjekësi e përgjithshme |
| Niveli: | Themelor |
| Statusi lëndës: | Lende zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti II-dyte semestri i trete |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 3 kredi |
| Koha / lokacioni: | |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. dr Sadi Bexheti Prof. Ass.dr. Afrim Shabani Prof. Ass.dr. Premtim Rashiti Prof. Ass.dr. Jeton Shatri |
| Detajet kontaktuese: | Shefi i katedrsadrës Prof. dr Sadi Bexheti sadi.bexheti@uni-pr.edu Tel. 038 500 600 ex 2031 Zv. Shefi i katedrës Prof. Ass.dr. Jeton Shatri jeton.shatri@uni-pr.edu Sekretari i katedrës Ass.Dr. Alije Keka-Sylaj alije.keka@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | Lënda e Anatomisë Klinike do të ofrojë studentëve njohuri mbi ndërtimin anatomik të trupit të njeriut në funksion të arritjes së njohurive të domosdoshme për ndërtimin trupor të tyre. Këto njohuri do të mundësojnë kuptimin e lokalizimit të indeve, organeve dhe sistemeve të ndryshme të organeve. |

| | |
|---|--|
| | Ndërtimin e detajuar anatomikë të organeve dhe sistemeve të organeve si bazë themelore e domosdoshme për kuptimin e mëtutjeshëm e më të detajuar të funksionit, ndërtimit histologjikë, ndryshimet patologjike, rëndësinë klinike, radiologjike, kirurgjike, ortopedike, etj që do të plotësohet nga lëndët e tjera. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimet e lëndës së Anatomisë Klinike 1 janë të ofroj studentëve njohuri nga: a) Anatomie klinike te organeve te njeriut b) Anatomia klinike; problemet më të shpeshta klinike me të cilat atakohet organi dhe organizmi në terësi si dhe rugët më të sigurta të ndërhyrjes për eliminimin e tyre c) Të përvetësojë emërtimet latine sipas terminologjisë anatomike (nomenklaturës anatomike 1998,2011) që do t'ju mundësojë komunikimin në mënyrë efektive/adekuate me kolegët e tyre. |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <i>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jetë në gjendje që të:</i> 1. Kuptojnë qëllimin e studimit të anatomisë klinike te sistemit lokomotor, sistemit respirator, kardiovaskular dhe urogenital, koka dhe qafa dhe sistemit nervor. 2. Kenë njohuri të përgjithshme mbi qelizat, indet dhe sistemet funksionale dhe rëndësinë e anatomisë klinike 3. Njohin ndarjen e Anatomisë; pjesët kryesore të trupit të njeriut, regjionet, vijat orientuese dhe pikat referente, pozicionin dhe planet/rrafshet anatomike, nomenklaturën anatomike 4. Kuptojnë metodën e studimit që do të përdoret dhe mënyrën se si lënda është e organizuar. |

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
|-------------------------------|------------|------------------|------------------|
| Ligjërata | 1 | 1/15 | 15 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 0 | 0 | 0 |
| Punë praktike | | | |

| | | | |
|--|---|------|-----------|
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 1/15 | 15 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 1/15 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 1/15 | 15 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 1 | 1/15 | 15 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | |
| Projektet,prezentimet ,etj | | | |
| Totali | | | 75 |
| Metodologjia e mësimdhënies: | <i>Mësimi do të realizohet në formë të: ligjëratave dhe seminareve</i> | | |
| Metodat e vlerësimit: | <i>Me test (me shkrim)</i> | | |
| Literatura | | | |
| Literatura bazë: | <p><i>Literatura baze:</i></p> <p><i>Netter's Clinical Anatomy, John T. Hansen, 4th edition,</i></p> <hr/> <p><i>Literatura plotesuese:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Alush Gashi, Agim Vela: Osteologjia, 1984</i> ▪ <i>Alush Gashi: Kafazi i kraharorit, 1989</i> ▪ <i>Hilmi Dauti, Bajram Nuraj: Kombliku, 1995</i> ▪ <i>Bajram Nuraj: Sistemi nervor periferik, 1998</i> ▪ <i>Agim Vela: Anatomia e Abdomenit, 2001</i> ▪ <i>Sadi Bexheti, Jeton Shatri me bp. Anatomia e Njeriut- gjymtyra e siperme dhe e poshtme, 2019</i> | | |

| | |
|-------------------------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sadi Bexheti, Jeton Shatri me bp. Anatomia e Njeriut- Osteologjia membrum suerius dhe inferius, 2018 ▪ |
| Literatura shtesë: | <i>Listoni literaturën e rekomanduar/shtesë.</i> |
| Plani i dizajnuar i mësimit: | |
| Java | Ligjerata |
| <i>Java e parë:</i> | Anatomia klinike gjymtyreve te sipërme : eshtrat, nyjetimet dhe muskujt |
| <i>Java e dytë:</i> | Anatomia klinike gjymtyreve te sipërme: enet e gjakut dhe nyjet limfatike, nervat; regjionet topografike te gjymtyreve te sipërme |
| <i>Java e tretë:</i> | Anatomia klinike-e gjymtyreve te poshtëm: eshtrat, nyjetimet dhe muskujt |
| <i>Java e katërt:</i> | Anatomia klinike- enet e gjakut dhe nyjet limfatike, nervat; regjionet topografike te gjymtyreve te poshtëm |
| <i>Java e pestë:</i> | Anatomia klinike e mureve te toraksit: eshtrat ,nyjetimet dhe muskujt, enet e gjakut, nervat , gl. mammae; regjionet topografike te mureve te toraksit |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Anatomia klinike e rrugeve dhe organeve respiratore |
| <i>Java e shtatë:</i> | Anatomia klinike-e zemres dhe eneve te gjakut |
| <i>Java e tetë:</i> | Anatomia klinike-e mureve te barkut: muri anterolateral dhe posterior; regjionet topografike; pikat e dobëta te mureve te barkut me thekste vecante - kanali inguinal. |
| <i>Java e nëntë:</i> | Anatomia klinike e peritoneumit, burses omentale, enet e gjakut, enet dhe nyjet limfatike; nervat në kavitetin abdominal |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Anatomia klinike e lukthit, zorres dymbëdhjetegjishore, zorres se holle mezenteriale dhe zorres se trashe |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Anatomia klinike e heparit dhe rrugeve biliare; pankreasit dhe shpretkes |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Anatomia klinike e Traktit urinar |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Anatomia klinike e mureve te pelvikut:eshtrat, nyjetimet, muskujt ,enet e gjakut,nyjet limfatike dhe nervat |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | Anatomia klinike e organeve gjendore mashkullore |

| | |
|------------------------------|--|
| Java e pesëmbëdhjetë: | Anatomia klinike e organeve gjenitale femerore |
|------------------------------|--|

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti gjat semestrit duhet të jetë i rregullt në ligjërata dhe ushtrime, duhet ti përmbahet orarit të fillimit të mësimin, të ketë njohuri paraprake mbi ligjëratatën/ushtrimin, të jetë i sjellshëm dhe të mos pengojë mbajtjen e mësimin.

28. Mjekësia e bazuar në evidencë

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|-------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | MJEKËSIA E BAZUAR NË EVIDENCË |
| Niveli: | Bachelor/ Mjekësi e përgjithshme |
| Statusi lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | II/ Semestri III |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 3 |
| Koha / lokacioni: | Përcaktohet nga orari i ligjëratave |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Instituti/Instituti i Fiziologjisë Patologjike (IFP) Konsultimet: Prof. ass. Qëndresë Daka -Dhoma nr.2, E Mërkurë, 8:00-10:00 Ass.dr. Dafina Bytyqi -Dhoma nr.3, E Martë,8:00-10:00 1970 MCMLXX |
| Detajet kontaktuese: | qendrese.daka@uni-pr.edu dafina.bytyqi@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | Lënda ka për qëllim të siguroj njohuritë dhe shkathtësitë për MBE në mënyrë që profesionistët mjekësorë të mund të zgjedhin problemet klinike bazuar në të dhënat shkencore. Profesionistët mjekësorë në përditshmëri duhet të marrin vendime për diagnostikimin, trajtimin dhe edukimin e pacientëve. Këto vendime duhet të bazohen në evidenën më të mirë, andaj është e |

| | |
|---|--|
| | <p>nevojshme që të zhvillojnë shkathtësi për të vlerësuar të dhënat nga hulumtimet mjekësore. Ofruesit e ardhshëm të kujdesit shëndetësor duhet të kenë njohuri dhe të zhvillojnë aftësi për të përcaktuar vlefshmërinë, kuptimin dhe zbatueshmërinë e gjetjeve të provave kërkimore.</p> <p>Zotësimi i MBE e rrit vetëbesimin e profesionistëve mjekësor për marrjen e vendimeve, kualitetin e kujdesit, dhe aftësinë e tyre për të komunikuar me kolegët, pacientët dhe familjet e tyre- elemente kyce të profesionalizmit. Prandaj kjo lëndë i përket zhvillimit profesional.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Lënda ka për qëllim të përgadit studentët të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Përdorin MBE për të siguruar kujdes shëndetësor kualitativ për individët dhe popullatën; 2.Përdorin metoda hulumtuese shkencore kualitative; |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Pas përfundimit të lëndës studentët do të kenë mundësi të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Kuptojnë MBE dhe hapat për praktikimin e saj; 2. Kuptojnë qëllimet e ndryshme për kërkimin e literaturës biomjekësore; 3. Performojnë kërkim efficient të evidencës biomjekësore duke i përdorur si duhet teremt dhe veglat në databaza; 4. Ruajnë dhe nxjerrin materialet në softwer të përshtatshëm; 5. Ti qasen në mënyrë kritike punimeve shkencore; 6. Aplikojnë evidencën më të mirë për qëllime profesionale dhe shkencore; 7. Të bëjnë hulumtime nga rishikimi i literaturës |

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
|--|------------|------------------|------------------|
| Ligjërata | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | - | - | - |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 2 | 2 |

| | | | |
|--|---|----|----|
| Ushtrime në teren | - | - | - |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 15 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | - | - | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 6 | 6 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 1 | 6 | 6 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 1 | 1 | 1 |
| Projektet,prezentimet ,etj | 2 | 15 | 30 |

Totali

75

***Semstri Veror**

| | |
|-------------------------------------|--|
| Metodologjia e mësimdhënies: | <p>Ligjërata</p> <ul style="list-style-type: none"> - Huluntimi i çështjeve të përzgjedhura duke përdorur burimet e internetit - Detyra me shkrim dhe redaktim nga kolegët/instruktorët - Raporte të shkurtra studentore nga lista e leximit - Diskutim në klasë <p>studentët do të kenë një projekt që duhet ta realizojnë përgjatë kursit (në klasë dhe shtëpi) dhe ta prezantojnë në fund.</p> |
| Metodat e vlerësimit: | <p>iRAT: 10%</p> <p>tRAT: 10%</p> <p>Projekti: 30%</p> <p>Prezentimi: 20%</p> <p><u>Provimi final</u> 30%</p> <p>Gjithsej 100%</p> |

Literatura

| | |
|-------------------------------------|---|
| Literatura bazë: | <p>1. G1. Guyatt G, Rennie D, Meade MO, Cook DJ, eds. Users' Guides to the Medical Literature: A Manual for Evidence-Based Clinical Practice. 2nd Ed. McGraw-Hill; 2015.</p> <p>2. Straus SE, Glasziou P, Richardson WS, Haynes RB. Evidence-Based Medicine. How to practice and teach EBM. 5th Ed. Elsevier; 2019.</p> <p>3. Mayer D. Essential Evidence-Based Medicine. 2nd Ed., Cambridge University Press; 2010.</p> <p>4. Greenhalgh T. How to Read a Paper: The Basics of Evidence-based Medicine and Healthcare. 6th Ed. John Wiley & Sons Ltd; 2019.</p> |
| Literatura shtesë: | <p>Burime të tjera (online tutorials dhe video, softwer për menagjim dhe kalkulim etj) për të zgjedhur problemet e secilit sesion.</p> <p>Punime të botuara që do të shpërndahen, përmes së cilave studentët zhvillojnë shkathhtësistë.</p> |
| Plani i dizajnuar i mësimit: | |
| Java | Ligjerata që do të zhvillohet-Semestri Dimëror |
| <i>Java e parë:</i> | <p>Mjekësia e Bazuar në Evidencë dhe hapat e saj.</p> <p>Përdorimi i literaturës shkencore për të përmirësuar kujdesin ndaj pacientit.</p> <p>Përshkrimi i diferencës në mes të pyetjeve kërkuese dhe objektive të kërkimit.</p> |
| <i>Java e dytë:</i> | <p>Formulimi korrekt i pyetjeve kilinike/hulumtuese varësisht nga problemet e pacientëve.</p> <p>Kërkimi i evidencës më të mirë aktuale.</p> <p>Përshkrimi i strategjisë së përgjithshme për kërkimin e literaturës; MeSH termet, operatorët Boolean, fjalët kyçe.</p> |
| <i>Java e tretë:</i> | <p>Kërkimi në PUBMED: hartimi i strategjisë së kërkimit, identifikimi i termeve të kërkimit, abreviacioneve dhe sinonimeve për termet kryesore dhe përshtatja me PUBMED MeSH termet</p> |
| <i>Java e katërt:</i> | <p>Kërkimi në PUBMED: përdorimi i funksioneve tjera për avancimin e kërkimit; verifikimi i citimeve përmes Citation Matcher, ruajtja e kërkimeve; marrja e teksteve të plota të punimeve të gjetura; eksportimin; software për mengjimin e referencave etc.</p> |
| <i>Java e pestë:</i> | <p>Kërkimi në databazat tjera: COCHRANE Library, National Guidelines Clearinghouse, EMBASE, WHO database etj.</p> |

| | |
|------------------------------|--|
| Java e gjashtë: | Kërkimi në databazat tjera: COCHRANE Library, National Guidelines Clearinghouse, EMBASE, WHODatabase etj. |
| Java e shtatë: | Rëndësia e vlerësimit të evidencës së studimeve Përshkrimi i veglave dhe elementeve për vlerësimin e dizajneve të ndryshme të studimit Kuptimi dhe aplikimi i evidencës në praktikë |
| Java e tetë: | Vlerësimi i evidencës mbi intervenimet: llojet e studimeve intervenuese , përshkrimi i termeve dhe aplikimi i udhëzuesëve për vlerësimin e studimeve intervenuese. |
| Java e nëntë: | Vlerësimi i evidencës mbi intervenimet: definimi, kalkulimi dhe interpretimi i rezultateve dhe përshkrimi i principeve për aplikimin e të dhënave nga studimet te pacientët individual. |
| Java e dhjetë: | Vlerësimi i evidencës mbi rriskun: llojet e studimeve mbi rriskun, aplikimi i udhëzuesëve për vlerësimin e studimeve mbi rriskun. |
| Java e njëmbëdhjetë: | Vlerësimi i evidencës mbi rriskun: definimi, kalkulimi dhe interpretimi i rezultateve dhe përshkrimi i principeve për aplikimin e të dhënave nga studimet te pacientët individual. |
| Java e dymbëdhjetë: | Vlerësimi i evidencës mbi testet diagnostikuese: përshkrimi i termeve që përdoren në studimet mbi saktësinë e testeve, aplikimi i udhëzuesëve për vlerësimin e këtyre studimeve, definimi, kalkulimi dhe interpretimi i rezultateve dhe përshkrimi i principeve për aplikimin e të dhënave nga studimet te pacientët individual. |
| Java e trembëdhjetë: | Vlerësimi i evidencës mbi studimet sistematike: principet e metodave, hapat dhe llojet e studimeve sistematike; aplikimi i udhëzuesëve për vlerësimin e studimeve sistematike. definimi, kalkulimi dhe interpretimi i rezultateve dhe përshkrimi i principeve për aplikimin e të dhënave nga studimet te pacientët individual. |
| Java e katërbëdhjetë: | Prezentimet e projekteve në klasë Reagimet e kolegëve Revidimi i projekteve |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Prezentimet e projekteve në klasë Reagimet e kolegëve Revidimi i projekteve |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të ndjekin mësimin teorik dhe praktik në përputhje me rregulloret e lëshuara nga Universiteti i Prishtinës dhe rregullorja për studime themelore e Fakultetit të Mjekësisë. Studentët duhet t'i përmbahen edhe rregullave tjera si më poshtë:

T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë.

T'u kushtojnë vëmendje studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitete akademike;

Të sillen mire në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos diskredituar Universitetin.

Të respektojnë të gjitha rregullat e vendosura nga njësia akademike ku organizohet mësimi.

29. MJEKESIA FAMILJARE

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë/ Dega Mjekësia e përgjithshme/ Katedra e Mjekësisë sociale, Mjekësisë së Punës dhe Mjekësia Familjare |
| Titulli i lëndës: | Mjekësia Familjare |
| Niveli: | Studimet Themelore |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | Viti i II- studimeve, semestri IV |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+2 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 4 |
| Koha / lokacioni: | / Dekanat |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof.asoc.dr Ibrahim Rudhani |
| Detajat kontaktuese: | QKUK Insstituti B. 044178573 ose 049178573 E-mail: Ibrahim.rudhani@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | Ky modul njohton studentët me aspektet e kujdesit parësor shëndetësor / mjekësisë familjare e cila përfshinë një rrjet të shërbimeve shëndetësore në bazë apo qendër në komunitet, institucionet e kujdesit paresor shendetesor, Qendrat Kryesore te Mjekësisë Familjare si bartëse të shërbimeve kujdesit parësor shëndetësor në bazë të koncepteve të Mjekësisë familjare dhe njesite e tyre, organizimin e sistemit shendetesor me theks ne KPSH, ekipin e mjekesise familjare detyrat dhe obligimet, problemet me te shpeshta qe hasen dhe principet dhe metodat shkencore qe shfrytezohen ne KPSH. |

| | |
|---|--|
| <p>Qëllimet e lëndës:</p> | <p>Qëllimet lëndës së mjekësisë familjare janë që përmes teorisë dhe praktikës t'i njoftoj studentet me aspektet e kujdesit parësor shëndetësor / mjekësisë familjare e cila përfshinë një rrjet të shërbimeve shëndetësore në bazë apo qendër në komunitet.</p> <p>Qendrat e Mjekësisë Familjare janë bartëse të shërbimeve kujdesit parësor shëndetësor në bazë të koncepteve të Mjekësisë familjare.</p> <p>Rezultatet e pritura të nxënies nënkuptojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë që do ti fiton studenti pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lëmie.</p> <p>Lënda do të jetë e përqendruar në studentë dhe do të jetë interaktive. Studentët do të përdorin edhe ditarin e punës ku do t'i evidentojnë rastet klinike, trajtimin dhe menaxhimin e tyre</p> |
| <p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p> | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptoj organizimin e sistemit shëndetësor në Kosovë dhe ofrimin e shërbimeve në kujdes parësor shëndetësor / mjekësi familjare dhe në komunitet dhe definicionin e kujdesit parësor shëndetësor /mjekësisë familjare dhe shërbimet që ofrohen në KPSH/MF ▪ Të bëjë identifikimin e problemeve të cilat paraqiten në mjekësi familjare si dhe zgjidhjet e duhura për njohje, parandalim dhe kujdes të vazhdueshëm të pacientëve të tyre ▪ Të kuptoj rëndësinë e raportit të mirë mjek-pacient përmes shkathtësive të mira të komunikimit dhe konsultimeve cilësore ▪ Të kuptoj konceptin, planifikimin, menaxhimin dhe evaluimin e shërbimeve të mjekësisë familjare ▪ Të aplikoj qasje sistemike dhe gjithëpërfshirëse për pacientët dhe familjet e tyre ▪ Të kuptoj rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm dhe çështjeve që kanë të bëjnë me cilësinë ▪ Të aplikoj principe të shëndetësisë publike, përshkrimin, sqarimin dhe zgjidhjen e problemeve në ofrimin e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor / mjekësisë familjare |
| <p>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)</p> | |
| <p>Aktiviteti</p> | <p>Orë Ditë/javë Gjithësej</p> |
| <p>Ligjërata</p> | <p>2 15 30</p> |
| <p>Ushtrime teorike/laboratorike</p> | <p>2 15 30</p> |

| | | | |
|---|--|------|------------|
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | | | |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 1/3 | 3 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 1/30 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 1 | 5 | 5 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | 2 |
| Projektet,prezentimet ,etj | | | |
| Totali | | | 100 |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Ligjërata interaktive, ushtrime përmes punës në grupe, seminare, mësimi i vetëdrejtuar, takime punuese, prezente nga studentët. | | |
| Metodat e vlerësimit: | <p>Metodat e vlerësimit do të bazohen në vlerësimin e njohurive dhe shkathtësive praktike të studentëve duke përdorur testet me zgjidhje të shumëfishta (PZSH), testet me përgjigjen më të mirë të mundshme, ekzaminimet klinike objektive të strukturuar në laborator duke përdorur modele (OSCE), ushtrimet klinike me pacientë, marrja e anamnezës (tandem konsultime) dhe provimi final.</p> <p>Vlerësimi i parë : 10%</p> <p>Vlerësimi i dytë : 20%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi final: 60%</p> | | |

| Literatura | |
|-------------------------------------|---|
| Literatura bazë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Mjekësia familjare, Zagreb, 2. “Orientimi në Mjekësinë Familjare “ 2003 – 2004 3. “Të Menduarit kritik dhe hulumtimi” 2003 – 2004 4. The New Public Health, Theodore Tulchinsky, Elena A.Varavikova 5. Socijalna Medicina – Želimir Jakšić, Luka Kovačić i suradnici 2000 6. Sistemet Shëndetësore/Transition in Health and Health Care in Kosovo-Prof.Ass.Dr.Merita Koçinaj, Fatime Arënlju –Qosaj 2010 7. Edukimi Shëndetësor”- Ilir Begolli 2001 8. Konceptet e ligjerimeve, libri ne dorëshkrim 9. Textbook of Family Medicine, 8 th Edition, Robert David Rakel, 2011 10.Textbook of Family Medicine, 9 th EditionRobel E. Rakel and David P.Rakel |
| Literatura shtesë: | Web faqet e ndryshem: www. Evidence Based Medicine |
| Plani i dizajnuar i mësimit: | |
| Java | Ligjerata që do të zhvillohet |
| Java e parë: | <ul style="list-style-type: none"> - Hyrja, njoftimi me lëndën (prezentimi i Syllabusit) - Organizimi i sistemit shëndetësor në Kosovë |
| Java e dytë: | <ul style="list-style-type: none"> - Definicioni i Kujdesit parësor shëndetësor dhe rëndësia e MF - Zhvillimi i MF në vende të ndryshme dhe te ne - Komunikimi me pacientë |
| Java e tretë: | <ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi verbal -Komunikimi joverbal - Konsultimi dhe rëndësia e konsultimit në mjekësi familjare (7 detyrat e konsultimit) |
| Java e katërt: | <ul style="list-style-type: none"> - Procesi diagnostik në mjekësinë familjare / Metodrat induktive dhe hipotetiko-deduktive të zgjedhjes së problemeve - Dosjet mjekësore për Mjekësinë Familjare |
| Java e pestë: | <ul style="list-style-type: none"> - Kartelat shëndetësore për pacientë - Praktika e mire mjekësore, Kompetencat dhe detyrat e mjekut familjar |
| Java e gjashtë: | <ul style="list-style-type: none"> - Çanta e mjekut |

| | |
|------------------------------|---|
| | -Ndikimi i mjedisit në shëndet |
| Java e shtatë: | - Problemet më të shpeshta në kujdesin parësor - Kujdesi për popullatën e grupeve të caktuara |
| Java e tetë: | - Zhvillimi fizik i fëmijëve shkollor - Kujdesi për adoleshentët |
| Java e nëntë: | - Kujdesi për popullatën e grupeve të caktuara - Shëndeti i femrës (Planifikimi familjar) |
| Java e dhjetë: | - Kujdesi për popullatën e grupeve të caktuara - Kujdesi për të moshuarit |
| Java e njëmbëdhjetë: | -Vlersimi i pare intermediar - Puna ekipore |
| Java e dymbëdhjetë: | - Formimi i grupeve të rishqyrtimit kolegjial - Mjekësia e bazuar në hulumtime të dëshmuara |
| Java e trembëdhjetë: | - Auditi në Kujdesin Parësor Shëndetësor - Skreningu në Kujdesin Parësor Shëndetësor |
| Java e katërbëdhjetë: | - Çështjet e cilësisë në Kujdes parësor shëndetësor / mjekësi Familjare - Vlersimi i dyte intermediar |
| Java e pesëmbëdhjetë: | - Përdorimi i udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike - Rekapitullimi i lëndës dhe ligjërata përmbledhëse |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara*

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

30. Citologji submikroskopike

| | | | |
|--|--|------------------|-----------------|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë – Mjekësi e Përgjithshme / Stomatologji | | |
| Titulli i lëndës: | Citologji submikroskopike | | |
| Niveli: | Studime themelore të integruara | | |
| Statusi i lëndës: | Zgjedhore | | |
| Viti i studimeve: | Viti II Semestri IV | | |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 | | |
| Kreditë ECTS: | 3 ECTS | | |
| Koha / Vendi: | Institutet B Sipas orarit | | |
| Mësimdhënësi: | Prof.Dr.Ruke Shala Beqiraj Prof.Ass.Dr.Fisnik Kurshumliu | | |
| Të dhënat kontaktuese: | ruke.beqiraj@uni-pr.edu +38344219977 fisnik.kurshumliu@uni-pr.edu +38349279010 | | |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda Citologji submikroskopike studion strukturën submikroskopike të qelizës dhe qelizave të indeve të ndryshme. | | |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimet e lëndës Citologji submikroskopike është ofrimi i njohurive mbi ndërtimin struktural të qelizës dhe qelizave të indeve të ndryshme. | | |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të kësaj lënde studenti duhet të jetë në gjendje të : <ul style="list-style-type: none"> - Të ketë njohuri mbi tipet e ndryshme qelizore të indeve dhe organeve - Të ketë njohuri mbi organelet qelizore. - Të ketë njohuri mbi veçoritë morfologjike të organeleve qelizore. - Të ketë njohuri mbi veçoritë funksionale të organeleve qelizore. | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjëratat | 1 | 15 | 15 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | 1 | 15 | 15 |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 45 |
| Përgatitja për provimin final | | | |

| | | | |
|---|--|--|-----------|
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 75 |

| | |
|--------------------------------|---|
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjeratat mbahen në grupe të mëdha në sallë të ligjeratave apo online përmes Power Point, GoogleMeet dhe/ose YouTube. Ushtrimet mbahen në grupe të vogla në sallat përkatëse të ushtrimeve përmes vizatimeve në dërrasë të bardhë (<i>white board</i>) dhe demonstrimit mikroskopik apo mikroskopit virtual (<i>virtual microscope</i>) |
|--------------------------------|---|

| | |
|------------------------------|---|
| Metodat e vlerësimit: | Seminaret 10% Vlerësimet intermediare 10% Provimi praktik 30%; Provimi përfundimtar (testi) 50%. |
|------------------------------|---|

| | |
|----------------------------|---|
| Literatura primare: | CITOLOGJIA SUBMIKROSKOPIKE – Përkthim nga Prof.Dr.Ruke Shala Beqiraj dhe Prof.Dr.Remzije Belegu |
|----------------------------|---|

| | |
|---------------------------|--|
| Literatura shtesë: | Ligjeratat online në YouTube nga Prof.Ass.Dr.Fisnik Kurshumliu |
|---------------------------|--|

Hartimi i planit mësimor

| Java | Titulli i ligjëratës |
|-----------------|--|
| Java 1: | Organizimi i përgjithshëm i qelizës |
| Java 2: | Gjaku, palca kockore dhe qelizat limfatike I |
| Java 3: | Gjaku, palca kockore dhe qelizat limfatike II |
| Java 4: | Gjaku, palca kockore dhe qelizat limfatike III |
| Java 5: | Qelizat e indit lidhor |
| Java 6: | Qelizat e Indit muskular |
| Java 7: | Qelizat e enëve të gjakut |
| Java 8: | Qelizat e lëkurës dhe epiteleve tjera |
| Java 9: | Qelizat e sistemit digjestiv I |
| Java 10: | Qelizat e sistemit digjestiv II |
| Java 11: | Qelizat e sistemit digjestiv III |
| Java 12: | Qelizat e sistemit respirator |
| Java 13: | Qelizat e sistemit urinar |
| Java 14: | Qelizat e sistemit nervor I |
| Java 15: | Qelizat e sistemit nervor II |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon më kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimi duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

31. Teknikat e Ekzaminimeve Radiologjike

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Katedra e radiologjisë- Mjekësi e Përgjithshme |
| Titulli i lëndës: | Teknikat e ekzaminimeve radiologjike |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi i lëndës: | Lende zgjedhore |
| Viti i studimeve: | viti i II-të, semestri i IV-të; |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Kreditë ECTS: | 3 |
| Koha / Vendi: | Prof Asoc.Dr Serbeze Kabashi Muçaj, dita e marte ora 9:00-10:00 QKUK Klinika e Radiologjise Prof Ass.Dr Kreshnike Dedushi, dita e enjte ora 9:00-10:00 QKUK Klinika e Radiologjisë |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof.Asoc.Dr Serbeze Kabashi-Muçaj, Prof.Ass.Dr.Kreshnike Dedushi Hoti |
| Detajet kontaktuese: | tel. +383/48 257 554; serbeze.kabashi@uni-pr.edu tel +383/45101015: kreshnike.dedushi@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | Në rrjedhën e studimeve të mjekësisë si e domosdoshme paraqitet nevoja e njohjes së: Teknikave te ekzaminimeve radiologjike . Prandaj është e nevojshme që studenti të marrë njohuritë elementare mbi imazherinë si pjesë me interes në diagnostikimin dhe trajtimin e semundjeve, sipas sistemeve. |
| Qëllimet e lëndës: | Është që studenti ynë te fiton shkathtësi në lëndën e cekur, të njoh teknikat e ekzaminimit të sistemeve të organeve. <ul style="list-style-type: none"> • Të njoh gjitha teknikat imazherike të sistemeve te ndryshme. • Të mësoj shenjat karakteristike radiologjike të sëmundjeve, lokalizimin e tyre, formën, madhësinë dhe në bazë të tyre të përcaktoj ndryshimet patologjike. • Të aftësohet në bazat e mbrojtjes nga rrezet jonizuese si problem parësor në shëndetësi. • Këto teknika janë të rëndesishme për diagnozë te saktë për pacientin duke e fokusuar saktësisht në segmentin e kërkuar nga mjeku. |

| | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> Më këtë nënkuptojnë njohuritë, shkathësitë dhe aftësitë që do t'i fiton studenti pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi-moduli. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <ul style="list-style-type: none"> Të njeh mirë teknikat e ekzaminimit me qëllim të përfitim të imazhit radiologjik në film dhe ekran te jene sa ma precize me qëllim te interpretimit ma korrekt të imazheve radiologjike. Ti mësoj teknikat e ekzaminimit të sistemeve, të organeve, shenjat radiologjike karakteristike të sëmundjeve në radiologji. Të njeh strukturat anatomike si dhe metodat e përdorura për ekzaminim. |

| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
|--|---|------------------|-----------------|
| Aktiviteti | Orë/mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 15 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 7 | 7 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 15 | 15 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 1 | 8 | 8 |
| Projektet, prezantimet ,etj | | | |
| Totali | | | 75 |
| Metodat e mësimdhënies: | Njohuritë per teknikat e ekzaminimeve Radiologjike do të përfitohen, përmes: Ligjëratave, ushtrimeve, seminareve, diskutimeve, punë në grupe sipas sistemeve. | | |
| Metodat e vlerësimit: | Vlerësimi i studentit do të bëhet përmes: vlerësimit të pjesës seminarike, testit me shkrim dhe provimit teorik. Një nga mënyrat e vlerësimit mund të jetë: Vlerësimi i parë 5% (vlerësimi 1-5 pikë) | | |

| | |
|---------------------------------|--|
| | <p>Vlerësimi i dytë 5% (vlerësimi 1-5 pikë) Vijimi i rregulltë 5 % (vlerësimi 1-5 pikë) Puna seminarike 35% <u>Provimi final 50 %</u> Gjithsejt 100% (100 pikë maksimum)</p> <p>Kriteret e vleresimit:</p> <p>Mbi 51%, student kalon</p> <p>51-60% - Nota 6</p> <p>61-70% - Nota 7</p> <p>71- 80%- Nota 8</p> <p>81-90%- Nota 9</p> <p>91-100%- Nota 10</p> |
| Literatura | |
| Literatura primare: | <p>7. Prof. Dr. Krenar Preza: Diagnostika e Imazherisë Diagnostike I dhe II, 2006 Tiranë;</p> <p>8. Prof. Ass. Dr. Halit Ymeri: Radiologjia e Përgjithshme për studentë, Prishtinë.</p> <p>9. Brant W, Fundamentals of Diagnostic Radiology</p> <p>10. Rockall A Diagnostic Imaging 7th Edition</p> <p>11. Plats GJ, Medical X-Ray Techniques in Diagnostic Radiology</p> <p>12. Leksionet e marra gjatë ligjeratave</p> |
| Literatura shtesë: | <p>2. Çfarëdo literature tjetër që i përshtatet këtij syllabusi (Internet etj.)</p> |
| Hartimi i planit mësimor | |
| Java | Titulli i ligjëratisë |
| Java e 1: | Njohja me lëndën – teknikat e ekzaminimeve radiologjike, rëndësia e tyre ne diagnostikim te sakt te patologjive ne sistemet e ndryshme si dhe roli ketyre projeksioneve te ndryshme ne imazheri |
| Java e 2: | Teknikat e ekzaminimeve historiku i zhvillimit qe lidhet me përfitimin e rezeve X, spektri i rezeve, cilësitë fizike, aparatet radiologjike. |
| Java e 3: | Fizika dhe teknika Radiologjike, përfitimi i imazhit Radiologjik në ekran, dhe në film, projeksioni, qartësia dhe kontrasti i imazhit. Teknikat themelore dhe te komplikuar te ekzaminimeve Radiologjik. |

| | |
|-------------------|--|
| <i>Java e 4:</i> | Mbrojtja nga rrezet jonizuese , gjat teknikave diagnostiko, veprimi biologjik i rrezeve X, principet e mbrojtjes së përgjithshme gjate projesioneve te ndryshme per pacientin. |
| <i>Java e 5:</i> | Skeleti I teknikat e ekzaminimit, anatomia normale, Radiologjike e skeletit. |
| <i>Java e 6:</i> | Skeleti II teknikat themelore radiologjike të sëmundjet e skeletit. Ndryshimet në formë, në rritje, ndryshimet në strukturën kockore përcjell edhe ne inde të buta. |
| <i>Java e 7:</i> | <u>Teknikat diagnostike ne imazherine e sistemit kardiovaskular:</u> RTG anatomia e zemrës dhe enëve të mëdha të gjakut; metodat e ekzaminimeve në imazherinë e zemrës dhe enëve të gjakut; anatomia normale e zemrës, aortës dhe art. Pulmonare |
| <i>Java e 8:</i> | <u>Teknikat imazherike ne sistemin respirator:</u> Projeksionet themelore per diagnostikim; shenjat kardinale të imazhit në sistemin respirator; sëmundjet e parenkimës së mushkrive; ndryshimet ventilatore në mushkëri; sindromi akut respirator; sëmundjet infektive të mushkërive; sëmundjet profesionale të mushkërive. Tumoret e mushkerive, Radiografia CT |
| <i>Java e 9:</i> | <u>Teknikat iamzherike ne Diagnostiken e sistemit digjestiv– Ndërtimi dhe funksioni, metodat e ekzaminimit.</u> |
| <i>Java e 10:</i> | <u>Diagnostika imazherike e aparatit tretës:</u> -teknikat diagnostike të ekzaminimit; anatomia dhe RTG anatomia normale; Semiotika imazherike; teknikat imazherike te :hipofaringut; ezofahut; Herniet diafragmale; iamzheria e stomakut; diagnostika imazherike e zorëve të holla dhe të trasha. Fluoroscopia, CT enterografia, MRI enterografia |
| <i>Java e 11:</i> | <u>Teknikat imazherike e sistemit hepatobiliar:</u> – diagnostika imazherike e sëmundjeve të mëlqisë; rrugët biliare; sëmundjet e pankreasit; sëmundjet e shpretkës; dg imazherike e kvitetit peritonal. Ultrazeri, MRCP |
| <i>Java e 12:</i> | <u>Teknikat imazherike e aparatit urinar dhe gjëndrrave mbiveshkore:</u> – Teknikat, metodat e diagnostikimeve imazherike; Anatomia, fiziologjia dhe rtg anatomia e aparatit urinar; sëmundjet e veshkave dhe ureterëve; anatomia imazherike e gjëndrave mbiveshkore; diagnostika imazherike e gjëndrave mbiveshkore. Urografia intravenoze, CT urografia, Cistografia, MRI urografia , MRI |
| <i>Java e 13:</i> | <u>Teknikat imazherike tek organet gjenitale dhe hapesirës retroperitoneale:</u> teknikat e ekzaminimit imazherik; të dhënat anatomike dhe fiziologjike; diagnostika imazherike e uterusit dhe |

| | |
|-------------------|---|
| | tubave uterine; diagnostika imazherike e organeve gjenitale mashkullore; Diagnostika imazherike e hapesirës retroperitoneale; metodat e diagnostikimit; të dhënat anatomike dhe fiziologjike; Sëmundjet e hapsirës retroperitoneale dhe diagnostikimi ityre. Ultrazeri transrektal, transvaginal, MRI |
| <i>Java e 14:</i> | <u>Teknikat imazherike tek sëmundjet e kokës dhe kolonës vertebrale:</u> teknikat e ekzaminimeve imazherike te rendesishme per; Diagnostiken imazherike te kockave të kraniumit; imazheria diagnostike e sëmundjeve të intrakraniumit; traumat; patologjitë inflamatore; sëmundjet vasculare të trurit; tumoret. Metodat e ekzaminimit të kolonës vertebrale; të dhënat anatomike dhe fiziologjike; sëmundjet dhe diagnostikimi imazherik i tyre. CT, MRI, spektroskopja |
| <i>Java e 15:</i> | <u>Teknikat imazherike në urgjencat dhe metodat e reja diagnostikuese në imazheri:</u> Ekzaminimi imazherik i pacientit të traumatizuar; urgjencat ne neruroradiologji, toraks, abdomen, pelvik, ekstremitete etj. Patologjitë posttraumatike te diagnostikura me Tomografi te Kompjuterizuar; Ultrasonografi; Rezonanca magnetike. |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Politika akademike dhe rregullat e mirësjellsjelljës: mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirë sjelljes si: Mbajtja e qetësisë në mësim, ç'kyçja e telefonave celular, hyrja në sall me kohë etj.

32. REANIMIMI KARDIOPULMONAR

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|-------------------------------|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Reanimimi Kardiopulmonar |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | Lëndë zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti II-të; Sem. IV-të |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Kreditë ECTS: | 3 ECTS |
| Koha / Vendi: | Katedra e AR Sipas orarit |

| | |
|--|---|
| Mësimdhënësi: | Prof Asoc Antigona Hasani |
| Të dhënat kontaktuese: | antigona.hasani@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Arresti kardiak dhe reanimimi kardiopulmonal janë pjesët më dramatike dhe jetëkërcënuese në mjekësi. Duke konsideruar se orët nga lënda e anesteziologjisë dhe reanimacionit nuk janë të mjaftueshme për ta shtjelluar këtë temë, shtohet kjo lëndë zgjedhore. Aftësimi i studentit në njohjen e arrestit kardiak dhe fillimin sa më të shpejt të reanimimit kardiopulmonal është baraz me një jetë. |
| Qëllimet e lëndës: | <ul style="list-style-type: none"> • Aftësimi në njohjen dhe identifikimin e arrestit kardiak . • Njohuria praktike dhe teorike nga lëmia e reanimimit kardiopulmonal. • Aplikimi i përkrahjes bazike të jetës dhe përkrahjes së avansuar të jetës. • Njohja dhe menaxhimi i reaksioneve alergjike, respektivisht shokut anafilaktik. • Trajtimi i atakut epileptic dhe asmatik dhe gjendjeve tjera kritike. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <p>Pas përfundimit të orës së mësimit, studenti duhet të jetë i aftë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikimi i arrestit kardiak dhe njohja me shkaktarin. 2. Aplikimi i përkrahjes bazike të jetës. 3. Aplikimi i përkrahjes së avansuar të jetës. 4. Identifikimi, njohja dhe menaxhimi i situatave kritike. <p>Studentët do të jenë në gjendje të përdorin njohuritë e marra nga lënda e Reanimacionit Kardiopulmonar në praktikë në laboratorin e simulimit.</p> |

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---------------------|------------------|-----------------|
| Ligjëratat | 1 | 15 | 15 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | - | - | - |
| Punë praktike | 1 | 15 | 15 |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | - | - | - |
| Testi, punimi seminarik | 1 | 10 | 10 |
| Detyrë shtëpie | 1 | 15 | 15 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 1 | 10 | 10 |
| Përgatitja për provimin final | 1 | 10 | 10 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | - | - | - |
| Projektet, prezantimet, etj. | - | - | - |
| Total | | | 75 |

| | |
|---|--|
| Metodat e mësimdhënies: | <ul style="list-style-type: none"> - Ligjërata - Hulumtimi i çështjeve të përzgjedhura duke përdorur burimet e internetit - Detyra me shkrim dhe redaktim nga kolegët/instruktorët - Raporte të shkurtra studentore nga lista e leximit - Diskutim në klasë -Puna praktike në laboratorin e simulimit. |
| Metodat e vlerësimit: | <ul style="list-style-type: none"> · Prania dhe pjesëmarrja në klasë: 10% · Prezantimi i temave/aktiviteteve: 20% · Kuize: 20% · Prezantimi përfundimtar: 10% · Provimi përfundimtar: 40% |
| Literatura primare: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Anesteziologjia dhe reanimacioni- Nehat Baftiu, botim i parë, 2015 2. Anesteziologjia Klinike-Carl &Matthew Gwinnut, Wiley Blackwell, botim i 4-të, 2012 (përkthyer në shqip). 3. Anesteziologjia dhe Mjekimi Intensiv, grup autorësh nga Tirana, botim i 1-rë, 2011 4. Anesteziologjia-Xhymret Skenderi, botim i 1-rë, 2011 |
| Literatura shtesë: | <ol style="list-style-type: none"> 5. Essentials of Anesthetic Equipment-B. Al-Shaikh, S. Stacey.Churchill Livingstone, botimi 3, 2007 6.BLS for Healthcare Providers Student Manual & CD Product. American Heart Association. 7.ALS Provider Manual (includes Student CD, Pre course Preparation Checklist, ACLS Pocket Cards). AHA |
| Hartimi i planit mësimor | |
| Java | Titulli i ligjërates |
| <i>Java 1:</i> | Hyrja në lëndë. Oksigjeni, hipoksia dhe anoksia |
| <i>Java 2:</i> | Anatomia dhe fiziologjia e rrugëve të frymëmarrjes. |
| <i>Java 3:</i> | Hapja e rrugëve të frymëmarrjes |
| <i>Java 4:</i> | Rrugët e vështira të frymëmarrjes dhe menaxhimi i tyre. |
| <i>Java 5:</i> | Arresti kardiak, njohja dhe shkaku. |
| <i>Java 6:</i> | Reanimimi kardiopulmonar. |
| <i>Java 7:</i> | Principet bazike të reanimimit kardiopulmonarë(BLS). |
| <i>Java 8:</i> | rincipet e reanimimit kardiopulmonarë të avancuar (ALS). |
| <i>Java 9:</i> | Defibrilimi i zemrës. |
| <i>Java 10:</i> | Preparatet që perdoren gjatë reanimimit. |
| <i>Java 11:</i> | Shoku anafilaktik –njohja dhe menaxhimi i tij. |
| <i>Java 12:</i> | Ataku asmatik, laringospazmi dhe bronkospazmi. |
| <i>Java 13:</i> | Ataku epileptic dhe menaxhimi i tij. |
| <i>Java 14:</i> | Lëngjet dehidrimi dhe rehidrimi |
| <i>Java 15:</i> | Etika dhe reanimimit kardiopulmonar. Rekapitullimi dhe përmbledhja e lëndës. |
| Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes | |
| <p>Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë. Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.</p> | |

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

33. Anatomia Klinike 2

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|----------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti I Mjekesise-Katedra e Anatomise |
| Titulli i lëndës: | Anatomia Klinike 2 |
| Niveli: | Themelor |
| Statusi lëndës: | Lende zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti II-dyte semestri i katert |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 3 kredi |
| Koha / lokacioni: | |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. dr Sadi Bexheti Prof. Ass.dr. Afrim Shabani Prof. Ass.dr. Premtim Rashiti Prof. Ass.dr. Jeton Shatri |
| Detajet kontaktuese: | Shefi i katedrsadrës Prof. dr Sadi Bexheti sadi.bexheti@uni-pr.edu Tel. 038 500 600 ex 2031 Zv. Shefi i katedrës Prof. Ass.dr. Jeton Shatri jeton.shatri@uni-pr.edu Sekretari i katedrës Ass.Dr. Alije Keka-Sylaj alije.keka@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | Lënda e Anatomisë Klinike do të ofrojë studentëve njohuri mbi ndërtimin anatomik të trupit të njeriut në funksion të arritjes së njohurive të domosdoshme për ndërtimin trupor të tyre. Këto njohuri do të mundësojnë kuptimin e lokalizimit të indeve, organeve dhe sistemeve të ndryshme të organeve. |

| | | | |
|---|--|------------------|------------------|
| | Ndërtimin e detajuar anatomikë të organeve dhe sistemeve të organeve si bazë themelore e domosdoshme për kuptimin e mëtutjeshëm e më të detajuar të funksionit, ndërtimit histologjikë, ndryshimet patologjike, rëndësinë klinike, radiologjike, kirurgjike, ortopedike, etj që do të plotësohet nga lëndët e tjera. | | |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Qëllimet e lëndës së Anatomisë Klinike 2 janë të ofroj studentëve njohuri nga:</p> <p>a) Anatomine klinike te organeve te njeriut</p> <p>db Anatomia klinike; problemet më të shpeshta klinike me të cilat atakohet organi dhe organizmi në terësi si dhe rugët më të sigurta të ndërhyrjes për eliminimin e tyre</p> <p>c) Të përvetësojë emërtimet latine sipas terminologjisë anatomike (nomenklaturës anatomike 1998,2011) që do tju mundësojë komunikimin në mënyrë efektive/adekuate me kolegët e tyre.</p> | | |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p><i>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jetë në gjendje që të:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. Kuptojnë qëllimin e studimit të anatomisë klinike te sistemit lokomotor, sistemit respirator, kardiovaskular dhe urogenital, koka dhe qafa dhe sistemit nervor.</i> <i>2. Kenë njohuri të përgjithshme mbi qelizat, indet dhe sistemet funksionale dhe rendesine e anatomise klinike</i> <i>3. Njohin ndarjen e Anatomisë; pjesët kryesore të trupit të njeriut, regjionet, vijat orientuese dhe pikat referente, pozicionin dhe planet/rrafshet anatomike, nomenklaturën anatomike</i> <i>4. Kuptojnë metodën e studimit që do të përdoret dhe mënyrën se si lënda është e organizuar.</i> | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjërata | 1 | 1/15 | 15 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 0 | 0 | 0 |
| Punë praktike | | | |

| | | | |
|--|---|------|----|
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 1/15 | 15 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 1/15 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 1/15 | 15 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 1 | 1/15 | 15 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | |
| Projektet,prezentimet ,etj | | | |
| Totali | 75 | | |
| Metodologjia e mësimdhënies: | <i>Mësimi do të realizohet në formë të: ligjëratave dhe seminareve</i> | | |
| Metodat e vlerësimit: | <i>Me test (me shkrim)</i> | | |
| Literatura | | | |
| Literatura bazë: | <p><i>Literatura baze:</i></p> <p><i>Netter's Clinical Anatomy, John T. Hansen, 4th edition,</i></p> <p><i>Literatura plotesuese:</i></p> <p><i>Neuroanatomy, A.R. Crossman, second edition</i></p> <p><i>Keith Moore, Anne Agur En : "Essential Clinical Anathomy"</i></p> <p><i>Literatura plotesuese:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Alush Gashi, Agim Vela: Osteologjia, 1984</i> ▪ <i>Agim Vela, Sadi Bexheti, Sistemi nervor qendror</i> ▪ <i>Bajram Nuraj,Agim Vela; Koka dhe Qafa</i> | | |

| | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sadi Bexheti, Jeton Shatri me bp. Anatomia e Njeriut- Osteologjia membrum suerius dhe inferius, 2018 ▪ |
| Literatura shtesë: | <i>Listoni literaturën e rekomanduar/shtesë.</i> |
| Plani i dizajnuar i mësimit: | |
| Java | Ligjerata |
| <i>Java e parë:</i> | Anatomia klinike e neurokraniumit dhe viscerokraniumit. |
| <i>Java e dytë:</i> | Anatomia klinike e enëve të gjakut, enëve dhe nyjeve limfatike të Kokës dhe të Qafës. |
| <i>Java e tretë:</i> | Anatomia klinike e nervave kranialë I-VI. |
| <i>Java e katërt:</i> | Anatomia klinike e nervave kranialë VII-XII, Pleksus cervikalis |
| <i>Java e pestë:</i> | Anatomia klinike e gojes dhe fytit (cavitas oris et pharynx). |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Anatomia klinike e hundës dhe laringut (cavitas nasi e larynx). |
| <i>Java e shtatë:</i> | Anatomia klinike e syrit. |
| <i>Java e tetë:</i> | Anatomia klinike e veshit. |
| <i>Java e nëntë:</i> | Anatomia klinike e palcës kurrizore (medulla spinalis) dhe trungut truror (truncus encephali). |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Anatomia klinike e sistemit motorik (pyramidal dhe ekstrapiramidal). |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Anatomia klinike e sistemit somatosenzorik, vizuel dhe auditiv. |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Anatomia klinike e sistemit limbic dhe olfaktory. |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Anatomia klinike. Hipotalamus dhe SNA. |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | Anatomia klinike e fushave kortikale të trurit të madh. |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | Anatomia klinike e enëve të gjakut, LCS dhe sistemit ventricular. |
| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: | |
| <p>Studenti gjat semestrit duhet të jetë i rregullt në ligjërata dhe ushtrime, duhet ti përmbahet orarit të fillimit të mësimit, të ketë njohuri paraprake mbi ligjërataën/ushtrimin, të jetë i sjellshëm dhe të mos pengojë mbajtjen e mësimit.</p> | |

34. PARANDALIMI DHE KONTROLLI I INFEKSIONEVE

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti i II Semestri IV |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Kreditë ECTS: | 3 ECTS |
| Koha / Vendi: | Amfiteatër Sipas orarit |
| Mësimdhënësi: | Lul Raka |
| Të dhënat kontaktuese: | lul.raka@uni-pr.edu , 044 368 289 |
| Përshkrimi i lëndës: | Kjo lëndë përmban të dhënat mbi parimet e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve gjatë kujdesit shëndetësor, aspektet moderne diagnostike të tyre, infeksionet kyçe spitalore me faktorët më të shpeshtë etiologjikë. Moduli identifikon edhe vatrat kryesore të infeksioneve spitalore tok me grupet e veçanta të rrezikuara të pacientëve. Një vend me rëndësi i është dhënë edhe shfaqjes së infeksioneve të bashkëshoqëruara nga procedurat diagnostike dhe terapeutike, mbrojtjes së punëtorëve shëndetësorë dhe aspekteve mjedisore që ndërlidhen me infeksione spitalore. Në përfundim të kursit jepen koordinatat për menaxhimin efikas të këtyre infeksioneve dhe sigurisë së pacientëve. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi i modulit është që studenteve t’ua sigurojë bërthamën e njohurive për rolin dhe përgjegjësitë në parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve që shfaqen si rrjedhojë e kujdesit mjekësor. Objektivat tjerë do të jenë edhe kuptimi i parimeve të epidemiologjisë së infeksioneve spitalore, diagnozës dhe parandalimit të tyre si dhe identifikimi i faktorëve të rrezikut për pacientet dhe departamentet më të prekura nga këto infeksione. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <ul style="list-style-type: none"> • t’i kuptojnë infeksionet më të shpeshta spitalore dhe rrugën e tyre të përhapjes; • ta zvogëlojnë mundësinë e bartjes së infeksioneve spitalore gjatë aplikimit të procedurave diagnostiko-terapeutike; • të përpilojnë planin për menaxhimin e infeksioneve në nivel multidisiplinar me masat parandaluese kundrejt rrezikut të identifikuar për infeksione dhe • ta përmirësojnë Sigurinë e Pacientit. |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | |

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|--|-----------|-----------|
| Ligjëratat | 1 | 15 | 15 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | 1 | 15 | 15 |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja për provimin final | | | |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 75 |
| Metodat e mësimdhënies: | <ul style="list-style-type: none"> - Ligjërata - Huluntimi i çështjeve të përzgjedhura duke përdorur burimet e internetit - Detyra me shkrim dhe redaktim nga kolegët/instruktorët - Raporte të shkurtra studentore nga lista e leximit - Diskutim në klasë | | |
| Metodat e vlerësimit: | <ul style="list-style-type: none"> · Prania dhe pjesëmarrja në klasë: 10% · Prezantimi i temave/aktiviteteve: 20% · Kuize: 20% · Prezantimi përfundimtar: 10% · Provimi përfundimtar: 40% | | |
| Literatura primare: | <ul style="list-style-type: none"> • Mayhall's Hospital Epidemiology and Infection control, D. Weber & Th.Talbot. LWW, 5th edition, 2020 • Jim Parker. The APIC/JCR Infection Prevention and Control Workbook, Third Edition; Joint Commission Resources, 2017 • Nizam Damani. Manual of Infection Prevention and Control, 4th Edition, Oxford University Press; 2019 • Bennet JV and Brachman PS: Jarwis' Hospital Infections, 5th ed., Philadelphia, LWW, 2013 | | |
| Literatura shtesë: | <ul style="list-style-type: none"> • J. Meddings, V.Chopora, S. Saint: Preventing Hospital Infections: Real-World Problems, | | |

| | |
|--|---|
| | <p>Realistic Solutions 2nd Edition, Oxford University Press, 2021</p> <ul style="list-style-type: none"> • Wachter R, Gupta K. Understanding patient safety, 3rd edition, Lange; 2017 • L.Raka, D.Pittet, B.Allegranzi, G.V. Knippenberg.Higjiena e duarve ne kujdesin shendetesor, Prishtine, 2010 • Kontrolli dhe parandalimi i infeksioneve spitalore-mauar përdorimi. Spitali Rajonal Lezhë, USAID, 2014 |
|--|---|

| Hartimi i planit mësimor | |
|---------------------------------|---|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| <i>Java e parë:</i> | Siguria e pacientit |
| <i>Java e dytë:</i> | Hyrje në infeksionet spitalore dhe kontrollin e infeksionit |
| <i>Java e tretë:</i> | Mbikqyrja e infeksioneve dhe hulumtimi i shpërthimeve epidemike |
| <i>Java e katërt:</i> | Pastrimi, dezinfektimi dhe sterilizimi |
| <i>Java e pestë:</i> | Higjiena e duarve |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Rreziku nga sëmundjet profesionale për personelin shëndetësor |
| <i>Java e shtatë:</i> | Masat e izolimit |
| <i>Java e tetë:</i> | Parandalimi i infeksioneve të plagëve kirurgjike |
| <i>Java e nëntë:</i> | Parandalimi i sepsës spitalore |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Parandalimi i infeksioneve të traktit respirator |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Parandalimi i infeksioneve të traktit urinar |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Rezistenca antimikrobike dhe infeksionet spitalore |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Parandalimi i infeksioneve virale hematogjene tek pacientët dhe punëtorët shëndetësorë |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | Parandalimi i TB në institucionet shendetesore |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | Menaxhimi i mbeturinave mjekësore |

| Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes |
|--|
| <p><i>Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.</i></p> <p><i>Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.</i></p> <p><i>Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.</i></p> |

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %

35. Imunologji

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Imunologji |
| Niveli: | Studime themelore të integruara |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti i III Semestri i V |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+2 |
| Kreditë ECTS: | 3 ECTS |
| Koha / Vendi: | 8:00-16:00 Katedra e Fiziologjisë dhe Imunologjisë |
| Mësimdhënësi: | Prof.ass. Luljeta Neziri Ahmetaj |
| Të dhënat kontaktuese: | luljeta.ahmetaj@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda e Imunologjisë do t'u ofroj studentëve njohuritë themelore nga Imunologjia. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi i njohjes së Imunologjisë, në veçanti i mekanizmave imunologjik të kater tipeve është e domosdoshme për zotërimin me suksese të kësaj lënde. Vend të veçantë kanë metodat laboratorike, imunocitologjike për verifikimin e saktë të mekanizmiave të reaksionit imunologjik. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jetë në gjendje të sqarojnë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Integrimin e sistemit imunitar të organizmit. 2. Rregullimin e mbrojtjes normale fiziologjike të organizmit 3. Mënyrën se si sistemi imunitar përmes mekanizmave specifik dhe jospecifik e realizon mbrojtjen e organizmit. 4. Mënyrën se si sistemi imunitar e dëmton vetë organizmin gjatë patologjive të ndryshme (kur është i tejsenzibilizuar). 5. Sëmundjet që lidhen me sistemin imunitar |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | |

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---|-----------|-----------|
| Ligjëratat | 1 | 15 | 15 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | 1 | 15 | 15 |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 10 |
| Përgatitja për provimin final | | | |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | 5 |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 75 |
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjerata Seminare Ushtime praktike | | |
| Metodat e vlerësimit: | <p>Vlerësimi në lëndën e <u>Imunologjise</u> do të bëhet nga dy forma të vlerësimit: provimi praktik dhe provimi teorik</p> <p>Provimi praktik Studenti do ta punoj nje ushtrim dhe gjate semestrit edhe seminare, keto do t'i mbron para asistentit me prezence edhe te profesorit</p> <p>Studenti i nënshtrohet provimit me test me anë të test pyetjeve nga përmbajtja teorike e lëndës.</p> <p>Nota nga provimi praktik përbën 15% të vlerësimit të lëndës, 5% vijushmeri ne ligjerata, 10% nga seminari, ndërsa 70% i takon provimit me test nga përmbajtja teorike e lëndës.</p> <p>Nota përfundimtare është rezultat i provimit praktik dhe atij teorik.</p> | | |
| Literatura primare: | Abbas, Cellular and Molecular Immunology - 9th Edition – Elsevier <u>Kuby Immunology, 8th Edition</u> | | |
| Literatura shtesë: | Immunology-Ivan Roitt Immunology-Ian Tood, Gavin Spickett | | |
| Hartimi i planit mësimor | | | |
| Java | Titulli i ligjëratës | | |
| <i>Semestri dimëror</i> | | | |

| | |
|-------------------------|--|
| <i>Java 1:</i> | Natyra e imunitetit |
| <i>Java 2:</i> | Njohja imunitare |
| <i>Java 3:</i> | Zhvillimi dhe aktivizimi i limfociteve |
| <i>Java 4:</i> | Ndërveprimi i limfociteve, citokinat dhe sistemi limfoid |
| <i>Java 5:</i> | Imunoglobulinat |
| <i>Java 6:</i> | Imunoglobulina A sekretore dhe kaviteti oral |
| <i>Java 7:</i> | Fagocitet dhe Komplementi |
| <i>Java 8:</i> | Mastocitet, bazofilet dhe eozinofilet |
| <i>Java 9:</i> | Qelizat vrasëse |
| <i>Java 10:</i> | Imuniteti dhe infeksioni |
| <i>Java 11:</i> | Çrregullimet primare dhe sekondare të imunodeficiencës |
| <i>Java 12:</i> | Lindja e përgjigjeve që dëmtojnë indet |
| <i>Java 13:</i> | Mekanizmat imunologjike të demtimit të indeve |
| <i>Java 14:</i> | Sëmundjet limfoproliferative |
| <i>Java 15:</i> | Terapia imunitare |
| | |
| <i>Semestri dimëror</i> | <i>Ushtrimet</i> |
| <i>Java 1:</i> | Hyrje, njohje me lëndën dhe laboratorin |
| <i>Java 2:</i> | Precipitimi-Metoda Ouchterloni |
| <i>Java 3:</i> | Precipitimi-Metoda Mancini |
| <i>Java 4:</i> | Aglutinimi |
| <i>Java 5:</i> | RIA |
| <i>Java 6:</i> | RIST, RAST |
| <i>Java 7:</i> | Seminar përmbledhës për ushtrimet e mbajtura |
| <i>Java 8:</i> | Reaksioni i lidhjes së komplementit |
| <i>Java 9:</i> | ELISA |
| <i>Java 10:</i> | Imunofluoreshenca |
| <i>Java 11:</i> | Nephelometria |
| <i>Java 12:</i> | Flowcytometry |
| <i>Java 13:</i> | Skin Prick Test |
| <i>Java 14:</i> | Reakcionet qelizore |
| <i>Java 15:</i> | Seminar përmbledhës për ushtrimet e mbajtura |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Nga të gjithë studentët prezent në provim pritet që të kontribuojnë në mbajtjen e një ambienti me sinqeritet akademik. Çdo student në provim duhet ta ketë me vete ID kartelen.

Sjelljet në vijim janë të ndaluara gjatë mbajtjes së provimit: bisedat, përdorimi i telefonave celular, çdo formë e kopjimit. Studenti i cili gjatë provimit konstatohet se kopjon do të largohet nga provimi dhe do t'i anulohet provimi. Të gjitha çantat, palltot dhe gjësendet tjera duhet të lihen në një vend të caktuar në hapësirat ku mbahet provimi.

36. Anatomi Patologjike

Informatat themelore për lëndën

| | |
|--------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë – Mjekësi e Përgjithshme |
| Titulli i lëndës: | Anatomia Patologjike |

| | |
|-------------------------------|---|
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi i lëndës: | Obligativ |
| Viti i studimeve: | Viti i III-të; Semestri i V-të dhe VI-të |
| Numri i orëve në javë: | 2+1+4 |
| Kreditë ECTS: | 15 |
| Koha / Vendi: | Fakulteti i Mjekësisë – Mjekësi e Përgjithshme E hënë 8.00-8.45; 8.50-9.35; 9.45-10.30 Grupi i parë i ligjëratave E hënë 11:40-12:25; 12:30-13:15;13:30-14:15 Grupi i dytë i ligjëratave Ligjëratat:Amfiteatri Dekanat Ushtrimet: Instituti i Anatomisë Patologjike |
| Mësimdhënësi: | Prof. Dr. sc Ragip Shabani Prof. Dr.sc Suzana Manxhuka Kërliu Ass. Dr.sc Merita Hashani, Ass. Dr.sc Rinë Limani, Ass. Dr.sc Labinot Shahini, Ass. Dr.sc Goneta Gashi, Ass. Dr.sc Arjeta Podrimaj, Ass.Dr. Mr.Sci.Arijeta Baruti, Ass.Dr. Shkelzen Reçica Ass.Dr. Esat Belaj |
| Të dhënat kontaktuese: | tel.: 500 600 2029, ragip.shabani@uni-pr.edu tel.: 500 600 2020, suzana.kerliu@uni-pr.edu tel.: 500600 2051, merita.hashani@uni-pr.edu tel.: 500 600 2051, rine.limani@uni-pr.edu tel.: 500600 2051, labinot.shahini@uni-pr.edu tel.:500600 2051 goneta.gashi@uni-pr.edu tel.: 500 600 2051, arjeta.podrimaj@uni-pr.edu tel.: 500 600 2051, arijeta.baruti@uni-pr.edu tel.: 500 600 2028, shkelzen.recica@uni-pr.edu tel.: 500 600 2028, esat.belaj@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda e Patologjisë mësohet në vitin e tretë të studimeve (semestri i V-VI-të). Patologjia si shkencë është urë lidhëse ndërmjet shkencave bazike dhe përvojës praktike, e cila merret me hulumtimin e shkaktarit të sëmundjes (etiologjisë) dhe mekanizmit të zhvillimit (patogenezës) i cili përcillet me simptomat dhe shenjat përkatëse të pacientit. Në patologji përdoren teknika të ndryshme molekulare, mikrobiologjike dhe imunologjike për t'i kuptuar ndryshimet strukturale dhe funksionale të cilat paraqiten në qeliza, inde dhe organe. Në patologji identifikohen ndryshimet makroskopike dhe dukja mikroskopike (morfologjia) e qelizave dhe indeve, për të përcaktuar diagnozën e sëmundjes dhe për të menaxhuar |

| | |
|--|---|
| | <p>terapinë. Patologjia si disiplinë ndahet në patologjinë e përgjithshme dhe në patologjinë speciale.</p> <p>Në patologjinë e përgjithshme shpjegohen ndryshimet fundamentale në qeliza dhe përgjigja e indit nës timuj, ndërsa në pjesën e patologjisë speciale shpjegohen proceset e ndryshme në organe dhe sisteme.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | Të mësohen konceptet bazë të patologjisë së përgjithshme dhe speciale. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <p>Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të definoj terminologjinë në patologji. 2. Të identifikoj, emërtoj dhe përshkruaj, shkaktarët bazik dhe mekanizmat e sëmundjes, duke përfshirë edhe proceset e dëmtimeve reversibile dhe ireversibile të qelizave dhe indeve, proceset inflamatore, riparimin e indeve, çrregullimet hemodinamike, sëmundjet e imunitetit, sëmundjet gjenetike, sëmundjet pediatrike, neoplazmat dhe sëmundjet e ambientit. 3. Të shqyrtoj dhe ndërlihd se si këto procese ndikojnë në strukturën dhe funksionin e organeve të ndryshme. 4. Të ketë njohuri themelore mbi të cilat mund të ndërtohet studimi më i detajizuar në patologjinë sistemike si dhe aftësi mjekësor klinik në vitet e ardhshme të studimit. 5. Të integroj informatat e fituara gjatë ligjëratave, orëve laboratorike si dhe nga studimi vetanak për t'i zgjedhur problemet më të thjeshta. 6. Të dijë t'i shpjegoj sëmundjet sistemike mbështetur në proceset patologjike. |

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Semestri dimëror -V | | | |
|--|------------|------------------|------------------|
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 4 | 15 | 60 |
| Punë praktike/Diagnostika Makroskopike | 4 | 2 | 8 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 3 | 3 |
| Ushtrime në teren | - | - | - |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 15 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | - | - | - |

| | | | |
|--|--|------------------|------------------|
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 3 | 15 | 45 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 2 | | 2 |
| Projektet,prezentimet ,etj | 2 | | 2 |
| Totali | | | 195 |
| Semestri veror-VI | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 4 | 15 | 60 |
| Punë praktike/Diagnostika Makroskopike | 4 | 2 | 8 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 3 | 3 |
| Ushtrime në teren | - | - | - |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 15 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | - | - | - |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 2 | 15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 2 | | 2 |
| Projektet,prezentimet ,etj | 2 | | 2 |
| Totali | | | 180 |
| Metodat e mësimdhënies: | Mësimi do të mbahet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve praktike, puna individuale (mësimi), shfrytëzimi i internetit (web faqeve të ndryshme). | | |
| Metodat e vlerësimit: | Vlerësimi do të bëhet në mënyrë kontinuale, kollokfiume, punime seminarike, vijueshmeria në ligjerata dhe ushtrime, pjesa praktike si dhe në fund me test. | | |
| Literatura primare: | 1.Anatomia Patologjike 1 (Prof. Dr. Lutfi Alia dhe Prof. Dr. Suzana Manxhuka Kërliu) 2009 – Pjesa e Përgjithshme 2.Bazat Patologjike të sëmundjeve (Prof. Dr Lutfi Alia) 2020- Vol 1, 2, 3,4. 3.Robbins Basic Pathology (Vinay Kumar, Abul K. Abbas, Jon Aster), 8 th Edition, 2020 | | |

| | |
|---------------------------------|---|
| Literatura shtesë: | <p>11. Patologjia, Shyqri Shubashi, Eduart Haxhihyseni, 2004 – Pjesa Speciale</p> <p>2. Rubin's Pathology (Emanuel Rubin, Fred Gorstein, Raphael Rubin, Roland Schwarting, David Strayer), 4th edition 2005.</p> |
| Hartimi i planit mësimor | |
| Java | Titulli i ligjëratisë – semestri dimëror |
| <i>Java 1:</i> | <p>Vështrim i përgjithshëm mbi anatominë patologjike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Definicioni i Anatomisë Patologjike • Objektivi i Anatomisë Patologjike • Metodatat e studimit të anatomisë patologjike • Teknikat e anatomisë patologjike • Histopatologjia tradicionale • Histokimia • Imunohistokimia • Histoautoradiografia • Citometria • Biologjia molekulare • Ekzaminimi mikroskopik |
| <i>Java 2:</i> | <p>Dëmtimi qelizor, shkaktarët dhe mekanizmat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkaktarët e dëmtimit qelizor • Mekanizmat e dëmtimit të qelizave • Adaptimi • Përgjigja subqelizore në dëmtim • Grumbullimet intraqelizore • Kalcifikimet patologjike |
| <i>Java 3:</i> | <p>Dëmtimet reversibile dhe ireversibile, apoptoza dhe plakja e qelizës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Karakteristikat e përgjithshme të dëmtimeve • Mekanizmat e dëmtimit ireversibil • Tipat morfologjik të dëmtimeve ireversibile • Apoptoza- vdekja e programuar e qelizës • Plakja qelizore |
| <i>Java 4:</i> | <p>Inflamacioni akut dhe kronik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inflamacioni akut • Inflamacioni kronik |
| <i>Java 5:</i> | <p>Inflamacioni akut dhe kronik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inflamacioni akut • Inflamacioni kronik |
| <i>Java 6:</i> | <p>Riparimi (regjenerimi dhe fibroza)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjenerimi qelizor • Përgjigja inflamatore- reparative |
| <i>Java 7:</i> | <p>Çrregullimet e qarkullimit të gjakut, tromboza, embolia, infarkti dhe shoku</p> |

| | |
|-----------------|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Edemi • Hiperemia (aktive dhe pasive) • Hemorragjia • Tromboza • Embolia • Infarkti • Shoku |
| Java 8: | <p>Çrregullimet e qarkullimit të gjakut dhe shoku</p> <ul style="list-style-type: none"> • Edemi • Hiperemia (aktive dhe pasive) • Hemorragjia • Tromboza • Embolia • Infarkti • Shoku |
| Java 9: | <p>Sëmundjet gjenetike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Citogjenetika • Sëmundjet citogjenetike • Mutacioni i gjenit • Sëmundjet Mendeliane (monogjenike) • Modalitetet e transmetimit të sëmundjeve monogjenike • Vështrim morfogjenetik për disa sëmundje gjenetike • Sëmundjet me hereditet multifaktorial • Sëmundjet monogjenike me modalitetet atipike hereditare • Sëmundjet me ndryshueshmëri të sfondit gjenetik • Sëmundjet e të porsalindurve dhe të moshës fëmijërore |
| Java 10: | <p>Sëmundjet imunitare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Reaksionet e hipersensibilitetit • Afeksionet e sistemit imunitar • Autoimuniteti • Amiloidoza (β- fibroliza) |
| Java 11: | <p>Sëmundjet e ambientit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndotja e ambientit • Pneumokoniozat • Silikoza • Azbestozi dhe sëmundjet e ndërlidhura me azbest • Berilioza • Pirja e duhanit • Dëmtimet me agjens kimik • Dëmtimet me agjens fizik • Traummat mekanike • Dëmtimet termike • Dëmtimet elektrike • Dëmtimet nga rrezatimi jonizues |

| | |
|-----------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Sëmundjet e ushqyeshmërisë • Kequshqyeshmëria me proteina- karbohidrate • Mungesa e vitaminave • Obeziteti • Mënyra e ushqyerjes (dieta) dhe kanceri |
| Java 12: | <p>Patologjia e përgjithshme e sëmundjeve infektive</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sëmundjet e reja infektive • Kategoritë dhe agjensët infektiv • Barrierat e nikoqirit për infeksion dhe si tejkalohen këto barriera • Shpërndarja e mikrobeve nëpër organizëm • Lirimi i mikrobeve nga organizmi • Mekanizmi i dëmtimeve të shkaktuara nga virusi • Mekanizmi i dëmtimeve të shkaktuara nga bakteret • Mbizotërimi i imunitetit nga mikrobet • Teknikat e posaçme për diagnostikimin e agjensëve infektiv • Përgjigja inflamatore ndaj agjensëve infektiv |
| Java 13: | <p>Neoplazmat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Definicioni • Emërtimi • Karakteristikat e përgjithshme të tumoreve beninje • Karakteristikat e përgjithshme të tumoreve malinje |
| Java 14: | <p>Neoplazmat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Epidemiologjia • Karcinogjeneza |
| Java 15: | <p>Neoplazmat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Etiologjia • Karcinogjenët kimik • Roli i radiacionit në karcinogjenezë • Onkogjeneza virale dhe mikrobiale • Mbrojtja e organizmit nga tumoret |

| Hartimi i planit mësimor | |
|---------------------------------|---|
| Java | Titulli i ligjëratës – semestri veror |
| Java 1: | <p>Sëmundjet e eneve të gjakut</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ateroskleroza • Hipertensioni arterial • Vaskulitet • Vaskulitet me qeliza gjigante • Trombangjiiti obliterant • Aneurizmat |

| | |
|----------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Venat varikoze • Flebitet • Patologjia e eneve limfatike • Patologjia e mikroqarkullimit • Tumoret e eneve te gjakut |
| Java 2: | <p>Semundjet e zemres</p> <ul style="list-style-type: none"> • Keqformimet e lindura • Defekt i septumit atrial • Defekt i septumit ventrikular • Kanali arterial • Bikuspidia e valvules aortale • Koarktacioni i aortes • Tetralogjia Fallot • Patologjite e endokardit • Endokarditet • Veset e fituara te zemres • Stenoza mitrale • Insuficienca mitrale • Stenoza e aortes • Insuficienca e aortes • Patologjite e miokardit • Semundjet ishemike te miokardit • Angina pectoris • Infarkti i miokardit • Miokarditet • Miokardiopatie • Perikarditet • Tumoret e zemres • Mixoma |
| Java 3: | <p>Sistemi hematopoetik dhe limfoid</p> <ul style="list-style-type: none"> • Patologjitë e eritrociteve • Anemitë • Policitemia • Diatezat hemorragjike • KID • Hemofilia • Defektet e trombociteve • Anomalitë e enëve • Patologjia e leukociteve • Leukopenia • Leukocitoza • Limfadenitet • Leukemite • Limfomat malinje • Sëmundjet e plazma gelizave |

| | |
|----------------|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Histiocitoza • Shpretka dhe patologjia e saj |
| Java 4: | <p>Trakti gastrointestinal</p> <ul style="list-style-type: none"> • Patologjia e indeve te buta te gojes • Keqformimet • Semundjet inflamatore • Patologjia e dhembëve • Tumoret e gojës • Patologjitë e gjëndrrave të pështymës • Patologjitë e ezofagut • Keqformimet e lindura • Ezofagu i Barrett-it • Tumoret e ezofagut • Patologjia e stomakut • Keqformimet • Gastritet • Ulçera gastroduodenale • Tumoret e ezofagut • Patologjia e zorrëve • Keqformimet • Patologjia vaskulare • Keqthithja • Patologjia inflamatore • Morbus Crohn • Colitis ulcerosa • Apendiciti • Ileuset • Tumoret e zorrëve |
| Java 5: | <p>Veshka dhe sistemi urinar</p> <ul style="list-style-type: none"> • Patologjitë glomerulare • Glomerulonefritet • Patologjitë tubulare • Nekroza tubulare akute • Nefropatia osmotike • Nefropatia kolemitike • Patologjitë intersteciale • Pyelonephritis • Nefriti interstecial • Patologjia vaskulare • Nefroangioskleroza beninje • Nefroangioskleroza malinje • Nefroangioskleroza aterosklerotike • Nekroza kortikale difuze • Mikroangiopatia trombotike • Tumoret e aparatit urinar • Tumoret e veshkave |

| | |
|----------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Karcinoma renale • Nefroblastoma • Tumoret e rrugëve urinare • Papilloma e fshikës urinare • Karcinoma papilare e fshikes urinare • Keqformimet e lindura • Sëmundja policistike e të rriturve • Sëmundja policistike e fëmijëve • Keqformimet e lindura të rrugëve urinare • Gurët urinar • Hidronefroza • Infeksionet e rrugëve urinare • Cistitet |
| Java 6: | <p>Mëlçia dhe rrugët biliare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Keqformimet hepatike • Patologjitë disciklike të heparit • Patologjitë inflamatore • Hepatiti viral • Absceset hepatike • Cirroza e heparit • Tumorët e mëlçisë • Sëmundjet e rrugëve biliare • Kolelitiaza • Kolecistitet |
| Java 7: | <p>Sistemi respirator</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sëmundjet inflamatore të rrugëve respiratore • Trupat e huaj në rrugët e frumëmarrjes • Astma bronkiale • Bronkiektazia • Patologjitë e mushkërive • Keqformimet e lindura • Tromboembolitë pulmonare • Infarktët pulmonar • Hipertensioni pulmonar • Edema pulmonare • Pneumonia • Abscesi pulmonar • Tuberkulozi • Atelektaza • Emfizema • Sëmundjet e pleurës • Pleuritët • Tumorët pulmonar |
| Java 8: | <p>Patologjia e pankreasit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Keqformimet e lindura |

| | |
|-----------------|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Patologjia e pankreasit ekzokrin • Pankreatitet • Tumoret • Patologjia e pankreasit endokrin • Diabeti i sheqerit • Tumorët e ishujve pankreatik |
| Java 9: | <p>Sistemi seksual femeror dhe gjiri</p> <ul style="list-style-type: none"> • Patologjite e vulves dhe vagines • Inflamacionet • Tumoret • Patologjite e qafes se mitres • Cervicitet • Displazite • Tumoret e qafes se mitres • Patologjite e trupit te mitres • Keqformimet e uterusit • Endometritet • Metrorragjite • Hiperplazia glandulare e endometrit • Endometrioza • Tumoret e trupit te mitres • Patologjite e tubave uterine • Patologjite e vezoreve • Tumoret e vezoreve • Patologjite e gjirit • Mastitet • Tumoret e gjirit |
| Java 10: | <p>Sisitemi seksual mashkullor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Orkiepididimitet • Tumoret e testiseve • Seminoma • Karcinoma embrionale • Teratoma • Patologjite e prostates • Prostatitet • Hiperplazia e prostates • Karcinoma e prostates |
| Java 11: | <p>Sistemi endokrin</p> <ul style="list-style-type: none"> • Patologjia e hipofizës • Tumoret • Patologjia e tiroides • Hipotiroidizmi • Anomalitë e zhvillimit • Struma • Sëmundja Graves • Tiroiditet |

| | |
|-----------------|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Tumoret e tiroides • Patologjia e gjëndrave paratiroide • Hipoparatiroidizmi • Pseudohipoparatiroidizmi • Hiperparatiroidizmi • Gjëndrrat mbiveshkore • Sindroma e hiperfeksionit të kores • Sindroma e hiperfeksionit medulo-suprarenal • Sindromat e hipofeksionit te kores |
| Java 12: | <p>Lëkura</p> <ul style="list-style-type: none"> • Patologjia me dëmtime epidermale • Patologjia me dëmtime epidermale dhe dermale • Patologjitë me dëmtime dermale • Patologjitë me dëmtime subkutane • Patologjitë hiperplazike • Tumoret e lëkurës |
| Java 13: | <p>Sistemi Nervor Qendror</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lezionet elementare • Atrofia cerebrale • Edema cerebrale • Hipertensioni intrakranial • Herniacioni cerebral • Keqformimet e lindura • Anencefalia • Cranium bifidum • Spina bifida • Hidrocefalia • Traumat e SNQ • Traumat kranio-cerebrale • Traumat vertebro-medulare • Patologjitë cerebro-vaskulare • Encefalomalacia • Dëmtimet cerebrale anoksike • Hemorragjia intrakaniale • Patologjia inflamatore • Encefalitet • Mielitet • Meningitet • Absceset cerebrale • Tuberkuloma • Pakimeningitet • Sëmundjet demielinizuese • Skleroza multiple • Sëmundjet degjenerative • Sëmundja Alzheimer |

| | |
|-----------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Sëmundja Pick • Sëmundja e Parkinson • Sëmundja Huntington • Tumoret e SNQ • Tumorët neuronal • Tumorët glial • Tumorët e strukturave kufizuese |
| Java 14: | <p>Sistemi osteomuskular</p> <ul style="list-style-type: none"> • Patologjitë e muskulaturës • Distrofitë muskulare • Miopati të lindura • Sindromet miastenike • Amiotrofia • Inflamacionet muskulare • Patologjitë metabolike • Patologjia tumorale • Patologjia e kockave • Dëmtimet elementare • Sëmundjet e kockave • Patologjite nutritive-rakiti • Patologjitë inflamatore-osteomielitet • Sëmundja Paget e kockave • Neoplazmat e kockave • Patologjia e artikulacioneve • Artritit infektive • Spondiliti ankilozant • Sindroma Reiter • Arriti psoriatik • Arriti enteropatik • Artrozat • Sinoviti |
| Java 15: | Testi formativ |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

- Studentët janë të obliguar të vijojnë mësimin teorik dhe praktik në përputhje me rregulloret e lëshuara nga Universiteti i Prishtinës dhe rregullorja për studime themelore e Fakultetit të Mjekësisë. Studentët duhet t'i përmbahen edhe rregullave tjera si më poshtë:
- T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë.
- T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
- Të respektojnë të gjitha rregullat e vendosura nga njësia akademike ku organizohet mësimi.

37. Fiziologjia patologjike

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Fiziologjia Patologjike |
| Niveli: | Studime të integruara/Mjekësi e Përgjithshme |
| Statusi lëndës: | Obligativ |
| Viti i studimeve: | III-të, Semestri V-të dhe i VI-të |
| Numri i orëve në javë: | 2+1+3 (V) dhe 2+0+2 (VI) |
| Vlera në kredi – ECTS: | 10 ECTS |
| Koha / lokacioni: | Përcaktohet nga orari i ligjëratave |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof.Ass. Burim Neziri Prof.Ass. Argjira Juniku-Shkololli Prof.Ass. Qëndresë Daka |
| Detajat kontaktuese: | Instituti/Instituti i Fiziologjisë Patologjike (IFP) Prof.ass. Burim Neziri - Shefi i Katedrës Konsultimet me student – IFP, Dhoma nr.4, Çdo të Hënë, 8:00-10:00 Prof.ass. Argjira Juniku-Shkololli - Konsultimet me student – IFP, Dhoma nr.3, Çdo të Martë, 8:00-10:00 Prof.ass. Qëndresë Daka - Konsultimet me student – IFP, Dhoma nr.2, Çdo të Mërkure, 10:00-12:00 |
| Përshkrimi i lëndës | <p>Plani mësimor i lëndës së Fiziologjisë Patologjike bazohet në konceptin e përmbajtjes së mëimit klinik të orientuar të Fakultetit të Mjekësisë. Kjo lëndë mund të konsiderohet si urë lidhëse në mes disiplinave mjekësore paraklinike dhe atyre klinike.</p> <p>Përmes mëimit të kësaj lënde studentët marrin bazat shkencore për kuptimin e mekanizmave të zanafillës së sëmundjeve të veçanta dhe shenjave të tyre, të cilat do ti vërejnë më pas në lëndët klinike. Përmes studimit të Fiziologjisë Patologjike mund të njihen faktorët e veçantë etiologjik, posaçërisht vetitë e tyre të cilat mund të inicojnë procesin patologjik. Me hulumtimin e Fiziologjisë Patologjike, fitohen njohuri mbi mekanizmat patogjenikë, të cilët janë të përbashkët për sëmundjet e shumta dhe njëherit zhvillohet kuptimi për çasje integrative të procesit patologjik të sëmurit e jo vetëm kah organet e veçanta të sëmurura.</p> <p>Funksionet e çrregulluara të sistemeve individuale shihen në unitetin e proceseve patologjike në larminë e pafund të sëmundjeve. Qasja integrale, që është thelbi i përshkrimit të një procesi patofiziologjik, është shumë e rëndësishme në ditët e sotme për shkak të specializimeve gjithnjë e më të ngushta. Prandaj, plani është që të vendoset pacienti në radhë të parë si individ biologjik, me të gjitha karakteristikat e tij të trashëguara dhe të</p> |

| | |
|---|---|
| | fituara, përfshirë ndërtimin dhe reaktivitetin e tij specifik. |
| Qëllimet e lëndës: | Njohja e studentëve me çrregullimet e funksioneve fiziologjike të organizmit si pasojë e veprimit të shkaktarëve të ndryshëm patologjik. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <p>Të mendojnë për ekzistencën e këtyre sindromeve në kuadrin e sëmundjeve infektive</p> <p>Të mësojnë për diagnositikimin me kohe dhe adekuat të këtyre sindromeve</p> <p>Të mësojnë për trajtimin e këtyre sindromeve në kuadër të trajtimit të sëmundjes infektive</p> |
|--|---|

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|--------------|-----------|-----------|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | 0.5 | 6 | 3 |
| Puna në terren | 2 | 1 | 2 |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | 1 | 15 | 15 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 3 |
| Përgatitja për provimin final | | | 4 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | 3 |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 60 |

| | |
|--------------------------------|--|
| Metodat e mësimdhënies: | <p>Moduli do të jetë i kombinuar me ligjërata, diskutime të rasteve të demonstruara, dhe me teste laboratorike. Metoda e mësimdhënies do të ju mundësojë studenteve si të përdorin mendimin kritik në zgjidhje të problemeve. Ushtrimet do të organizohen në Klinikën Infektive si dhe në Departamentet tjera të QKUK ku gjenden këta të sëmurë, si dhe laboratorin e Klinikës Infektive. Secila njësi mësimore do të jetë e mbështetur nga pjesa teorike e cila do të ndërlihet me pjesën praktike dhe laboratorike. Secila njësi mësimore do të përgatis studentet si ti detektojnë infeksionet të këta pacient.</p> |
|--------------------------------|--|

| | |
|------------------------------|---|
| Metodat e vlerësimit: | <p>Do të mbahen dy testime intermediare dhe një test final. Ekzaminimi i parë do të bëhet me pyetësorë me përgjigje të shumëfishta pas realizimit të 40% të materialit, ndërsa vlerësimi i dytë do të realizohet pas përfundimit të 80% të materialit të parapare.</p> <p>Vlerësimi i dytë do të jetë vlerësim i plote (total) dhe mesatarja e këtyre dy vlerësime do të përbejnë 2/3 e notes së studentit. Një e treta (1/3) tjetër do të vlerësohet nga praktika në laborator, praktika klinike, si dhe aktivitet tjera si (seminaret, testimet, prezantimet). Nëse studentet kërkojnë vlerësim me gojë, kjo do të ju mundësohet. Pjesëmarrja e studenteve në ligjërata, praktike klinike, ushtrime laboratorike do të këtë rëndësi të veçantë.</p> |
|------------------------------|---|

| | |
|---------------------------------|---|
| | <p>Provimi do te bazohet ne materialet e ligjëruara, ushtrimet praktike dhe laboratorike.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i pare: 25% 2. Vlerësimi i dyte: 25% 3. Detyrat e shtëpisë dhe aktivitet tjera: 10% 4. Pjesëmarrja: 5% <p>Testi Final ose vlerësimi me oral: 40%</p> |
| Literatura primare: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Core Concepts in Clinical Infectious Diseases (CCCID). Carlos Franco-Parades. Academic Press. 2016. Elsevier Inc. 2. Sëmundjet infektive. Ilir Tolaj. Universiteti i Prishtinës. 2018. |
| Literatura shtesë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Clinical Management of Infections in Immunocompromised Infants and Children by Christian C. Patric. Press 2005. 2. Feigin and Cherry's Textbook of Pediatric Infectious Diseases: Expert Consult. by Ralph D. Feigin, James Cherry, Gail J. Demmler-Harrison, and Sheldon L. Kaplan; Feb 20, 2009. 3. Infection Control in the Intensive Care Unit (Topics in Anaesthesia and Critical Care) by H.K.F. van Saene, L. Silvestri, and M.A. de la Cal (Paperback - Jul 21, 2005). 4. Principles and Practice of Infectious Diseases, by Gerald Mandell, John Bennet and Raphael Dolin, 2015. |
| Hartimi i planit mësimor | |
| Java | Titulli i ligjëratisë |
| <i>Dita 1:</i> | Hyrje në konceptet themelore dhe materialet që do të ligjërohen Sindromet e organeve specifike në sëmundjet infektive |
| <i>Dita 2:</i> | Rhabdomyolysis Çrregullimet acido-bazike dhe sëmundjet infektive |
| <i>Dita 3:</i> | Abnormalitetet e elektroliteve dhe sëmundjet infektive |
| <i>Dita 4:</i> | Organet endocrine dhe sëmundjet infektive Disfunksioni pituitar Çrregullimet e tireoidesë Gonadet |
| <i>Dita 5:</i> | Gjëndrrat adrenale Abnormalitetet hematologjike |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

66. BAZAT E GERONTOLOGJISË DHE GERIATRISË

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | BAZAT E GERONTOLOGJISË DHE GERIATRISË |
| Niveli: | Studime Themelore të Integruara |
| Statusi i lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti IV, Semestri VII |
| Numri i orëve në javë: | 1 + 1 + 0 |
| Kreditë ECTS: | 2 |
| Koha/Vendi: | Sipas orarit. IKSHPK |
| Mësimdhënësi: | Prof. Ass. Dr. Naim Jerliu |
| Të dhënat kontaktuese: | naim.jerliu@uni-pr.edu; IKSHPK, Kati 4. |
| Përshkrimi i lëndës: | <p>Ky modul ia prezenton studentit konceptet kryesore të moshës dhe moshimit, tendencat demografike në botë dhe vendin tonë, dhe bazat e gerontologjisë dhe geriatriisë.</p> <p>Adresohen struktura dhe funksioni normal dhe jonormal, përfshirë historinë natyrore të sëmundjeve njerëzore, mekanizmat mbrojtës të trupit, paraqitjen e sëmundjes dhe përgjigjet ndaj sëmundjes tek pacientët e moshuar. Përshkruhen aspektet relevante të patofiziologjisë, diagnozës, menaxhimit dhe strategjive parandaluese për problemet e zakonshme tek njerëzit e moshuar. Gjendjet/problemet e zakonshme mjekësore te njerëzit e moshuar, kryerja e vlerësimit geriatrik, përdorimi i barnave, respektimi i pacientit të moshuar, çështjet kryesore etike dhe ligjore të rëndësishme në kujdesin e njerëzve të moshuar diskutohen në lidhje me rolin e mjekut dhe profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor.</p> <p>Përmbajtja e modulit është hartuar bazuar në Kurrikulën Evropiane universitare në mjekësinë geriatrike (<i>The European undergraduate curriculum in geriatric medicine</i>) që pasqyron kërkesat e dëshiruara siç rekomandohet nga një panel i 49 ekspertëve që përfaqësojnë 29 vende të lidhura me Bashkimin Evropian të Specialistëve Mjekësorë (<i>European Union of Medical Specialists-UEMS</i>). Kurrikula Evropiane universitare në mjekësinë geriatrike (<i>The European undergraduate curriculum in geriatric medicine</i>) përmban një set thelbësor të deklaratave që përbëjnë</p> |

| | |
|---|---|
| | atë që anëtarët e panelit propozojnë të jetë niveli minimal i njohurive thelbësore, aftësive dhe qëndrimeve që studentët e mjekësisë duhet të kenë fituar me rastin e diplomimit. |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Qëllimet e lëndës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të sigurojë një përvojë edukative që do të zhvillojë aftësitë e studentit për të lehtësuar zhvillimin e gjykimit të pavarur dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve në lidhje me trajtimin dhe kujdesin për njerëzit e moshuar; • të sigurojë një kornizë edukative që do të inkurajojë studentin të zhvillojë aftësitë e saj / tij të analizës dhe vetëdijes kritike për të stimuluar një qasje kërkuese dhe krijuese ndaj teorisë dhe praktikës së geriatriës dhe kujdesit gerontologjik; • të zhvillojë aftësinë e studentit për t'iu përgjigjur ndryshimit të nevojave në geriatri dhe kujdes gerontologjik në mënyrë analitike. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies | <p>Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studenti:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njih dhe kupton strukturën dhe funksionin normal dhe anormal, duke përfshirë historinë natyrore të sëmundjeve njerëzore, mekanizmat mbrojtës të trupit, paraqitjen e sëmundjes dhe përgjigjet ndaj sëmundjes në pacientët e moshuar (teoritë e moshimit, ndryshimet që lidhen me moshimin, patologjinë e shoqëruar me moshimin normal, proceset e sëmundjes të lidhura me moshën, paraqitja atipike (jo specifike) e sëmundjes) 2. Din për gjendjet (problemet) e zakonshme mjekësore të njerëzit e moshuar 3. Përshkruan aspektet relevante të patofiziologjisë, diagnozës, menaxhimit dhe strategjive parandaluese për problemet e zakonshme të njerëzit e moshuar, 4. Ka aftësitë e veçanta të nevojshme për të marrë një histori (anamnezë) dhe për të kryer një vlerësim të një pacient i moshuar 5. Njih dhe kupton parimet e trajtimit, duke përfshirë përdorimin efektiv dhe të sigurt të barnave si bazë për përshkrimin të një pacient i moshuar 6. Njih rëndësinë e përgjigjeve ndaj sëmundjeve, duke siguruar ndihmë drejt rimëkëmbjes dhe zvogëlimin ose menaxhimin e dëmtimeve dhe aftësive të kufizuara 7. Njih dhe kupton çështjet kryesore etike dhe ligjore që lidhen me kujdesin ndaj njerëzve të moshuar në kontekstin ndërkombëtar dhe vendor 8. Njih, kupton dhe respekton rolet dhe ekspertizën e profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor dhe social në kujdesin e të moshuarve 9. Din rreth kujdesit për pacientët e moshuar në mjedise të ndryshme dhe përshkruan konceptet e vlerësimit dhe menaxhimit geriatrik të pacientëve të moshuar në mjedise të ndryshme 10. Din për aspektet specifike të rëndësishme për kujdesin shëndetësor dhe social për personat e moshuar në vendin tonë. 11. Komunikon në mënyrë të përshtatshme me njerëzit e moshuar, përfshirë ata me dëmtime njohëse ose shqisore |

| | 12. Mban një qasje profesionale ndaj personit të moshuar dhe respekton pacientët pavarësisht nga moshja e tyre. | | |
|---|--|--------------------|--------------|
| Obligimet e studentit (duhet të përputhet me rezultatet e të nxënit të studentit) (orët / semestri, ECTS): | | | |
| Aktiviteti | Orët | Ditë / javë | Total |
| Ligjërata | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrim praktik / laboratorik | | | |
| Punë praktike / praktikë klinike | | | |
| Kontakti me profesorin/konsultat | | | |
| Ushtrime në terren | | | |
| Seminar praktik / kopjimi i detyrave | 1 | 15 | 15 |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Vetë studim (bibliotekë ose shtëpi) | | | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | | | |
| Koha për vlerësimin e studentëve (teste, kuiz, provimi përfundimtar) | | | |
| Projekte, prezantime, etj. | | | |
| Total | | | 60 |
| Metodat e mësimdhënies: | <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ligjërata</i> me pjesëmarrje aktive të studentëve (shpjegim, diskutim, pyetje, shembuj, zgjidhje e problemeve); • <i>Tutorial</i>: Përgatitja, prezantimi dhe mbrojtja e suksesshme e një seminari (zgjidhje e problemit – PBL, studime të rastit me diskutim, metodat e të menduarit kritik, me reflektimin e përvojës, vlerësimin, punën e projektit, puna në skuadër). • <i>Praktika klinike</i>: aplikimi i njohurive të marra në mjedisin klinik. | | |
| Metodat e vlerësimit: | <ul style="list-style-type: none"> • Vijueshmëria dhe pjesëmarrja në klasë: 10% • Përgatitja, prezantimi dhe mbrojtja e punimit seminarik/studimit të rastit: 20% • Kuize / Teste: 20% • Provimi përfundimtar: 50% | | |
| Literatura | | | |
| Literatura bazike: | <ul style="list-style-type: none"> • Regina Roller-Wirnsberger, Katrin Singler, Maria Cristina Polidori (Editors). Learning Geriatric Medicine. A Study Guide for Medical Students. Springer International Publishing AG, 2018 • Naim Jerliu (2019). Kujdesi ndaj pacientëve të moshuar. <i>Aspekte të menaxhimit të sëmundjeve kronike dhe të komunikimit me pacientët e moshuar</i>. AQH, Prishtinë • O. P. Sharma. Principles & Practice of Geriatric Medicine, Viva Books Private Limited, 2019 | | |

| | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Lesley K. Bowker, James D. Price, Ku S. Shah, Sarah C. Smith. Oxford Handbook of Geriatric Medicine. Third Edition. Oxford University Press, 2018 |
| <p>Literatura shtesë:</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Merck Manual for the Professional. https://www.merckmanuals.com/professional/geriatrics • B. Lynn Beattie, Finbarr C. Martin, Jean-Pierre Michel, Jeremy D. Walston. Oxford Textbook of Geriatric Medicine. Oxford University Press, 2018 • Nair, Balakrishnan Kichu R. Geriatric medicine: a problem-based approach. Springer, 2018 • Howard M. Fillit, Kenneth Rockwood, John B Young. Brocklehurst's Textbook of Geriatric Medicine and Gerontology, 8th Edition, Elsevier Health Sciences, 2016 • Alan J. Sinclair, John E. Morley. Principles and Practice of Geriatric Medicine, Volume 1- 2, 2006 • Jeffrey B. Halter, Joseph G. Ouslander, Mary Tinetti, Stephanie Studenski, Kevin P. High, Sanjay Asthana . Hazzard's Geriatric Medicine and Gerontology, Sixth Edition, 2008. • David Sinclair, Matthew D. LaPlante (2019). <i>Lifespan: Why We Age - and Why We Don't Have To</i>. Atria Books. • Tahir Masud, Adrian Blundell, Adam Lee Gordon, Ken Mulpeter, Regina Roller, Katrin Singler, Adrian Goeldlin, Andreas Stuck, European undergraduate curriculum in geriatric medicine developed using an international modified Delphi technique, <i>Age and Ageing</i>, Volume 43, Issue 5, September 2014, Pages 695–702, https://doi.org/10.1093/ageing/afu019 • Jerliu N, Burazeri G, Toçi E, Philp I, Czabanowska K, Ramadani N, Brand H. Application of EASY-Care Standard 2010 instrument in a population-based survey in transitional Kosovo. <i>Eur J Public Health</i>. 2018 Aug 31. • Jerliu N, Burazeri G, Toci E, Kempen GIJM, Jongen W, Ramadani N, Brand H. Social networks, social participation and self-perceived health among older people in transitional Kosovo. <i>Eur J Public Health</i> (2014) 24 (2):333-337. • Jerliu N, Toçi E, Burazeri G, Ramadani N, Brand H. Prevalence and socioeconomic correlates of chronic morbidity among elderly people in Kosovo: a population-based survey. <i>BMC Geriatrics</i> 2013; • Jerliu N, Toçi E, Burazeri G, Ramadani N, Brand H. Socioeconomic conditions of elderly people in Kosovo: a cross-sectional study. <i>BMC Public Health</i> 2012, 12:512 • Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) (2018). Don't get old. A report on the standard of living of Kosovo's elderly. Prishtina. • Rueben D. Geriatrics at Your Fingertips 2008-2009. New York: American Geriatrics Society; 2008. • Kane RL, Ouslander JG, Abrass IB, Kane R. Essentials of Clinical Geriatrics. McGraw-Hill; 2004. |
| <p>Plani i detajuar mësimor</p> | |

| Java | Titulli i ligjëratës/Tema |
|-----------------|--|
| Java 1: | <ul style="list-style-type: none"> • Moshja dhe moshimi, moshimi gjatë historisë në botë dhe Kosovë. • Trendet demografike, ndikimi shoqëror dhe pikëpamjet mbi moshën, moshimin dhe të moshuarit. • <i>Qasja profesionale ndaj personit të moshuar</i> • <i>Mitet dhe stereotipet e ndryshme në lidhje me njerëzit e moshuar</i> • <i>Moshizmi dhe efekti i tij në kujdesin optimal të njerëzve të moshuar</i> • <i>Heterogjeniteti i njerëzve të moshuar dhe nevoja për ta parë secilin person si një individ</i> |
| Java 2 : | <ul style="list-style-type: none"> • Teoritë e moshimit: <i>teoritë biokimike, qelizore, gjenetike dhe psikosociale. Teoria e informacionit e moshimit.</i> • <i>Ndryshimet e moshimit. Ndryshimet anatomike, histologjike dhe fiziologjike të ndërlidhura me moshimin.</i> • <i>Patologjia e asociuar me moshimin normal dhe proceset e sëmundjes të asociuara me moshën</i> • <i>Paraqitja atipike (jo specifike) e sëmundjes tek pacientët e moshuar</i> • <i>Parimet e mjekësisë së bazuar në prova dhe përdorimi i udhëzimeve në kujdesin e njerëzve të moshuar, duke marrë parasysh multimorbiditetin</i> |
| Java 3 : | <ul style="list-style-type: none"> • <i>Gerontologjia. Zhvillimi, elementet thelbësore dhe konceptet kyçe, parimet udhëzuese, qëllimet dhe organizimi, promovimi i shëndetit, parandalimi.</i> • <i>Geriatra. Zhvillimi, elementet thelbësore dhe konceptet kyçe, parimet udhëzuese, qëllimet dhe organizimi, sëmundjet më të zakonshme kronike në moshë të shtyrë.</i> |
| Java 4 : | <ul style="list-style-type: none"> • <i>Gjendjet (problemet) e zakonshme mjekësore tek të moshuarit</i> <i>Patofiziologjia, diagnoza, vlerësimi, menaxhimi dhe strategjitë parandaluese për sindromat geriatrike të zakonshme tek të moshuarit:</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Dhimbja kronike</i> • <i>Demenca dhe deliriumi</i> • <i>Rëni dhe çrregullimet e lëvizjes</i> • <i>Çrregullimet e dëgjimit dhe shikimit</i> • <i>Kequshqyerja dhe sarkopenia</i> • <i>Ulcerat e presionit</i> • <i>Inkontinenca urinare dhe fekale</i> • <i>Abuzimi i të moshuarve: fizik, psikologjik, financiar dhe seksual</i> |
| Java 5: | <ul style="list-style-type: none"> • <i>Aspektet relevante të patofiziologjisë, diagnostikimit, menaxhimit dhe strategjitë parandaluese për problemet e zakonshme tek të moshuarit</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Sëmundjet kardiovaskulare (përfshirë dështimin e zemrës dhe hipertensionin)</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Sëmundja cerebrovaskulare dhe goditja në tru</i> • <i>Sëmundja kronike obstruktive e mushkërive dhe pneumonia</i> • <i>Depresioni</i> • <i>Diabeti</i> • <i>Çrregullimet e ekuilibrit të lëngjeve</i> • <i>Osteoporozë</i> • <i>Dështimi i veshkave</i> |
| Java 6: | <ul style="list-style-type: none"> • <i>Marrja e historisë (anamnezës) dhe kryerja e një vlerësimi në një pacient të moshuar</i> • <i>Kryerja e një vlerësimi geriatrik (me një qasje të standardizuar mbi):</i> |

| | |
|------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet themelore dhe instrumentale të jetës së përditshme • Njohje • Ecja dhe ekuilibri • Dëgjimi • Humori • Ushqyerja • Shikimi |
| Java 7: | <ul style="list-style-type: none"> • Kujdesi ndaj personave të moshuar me sëmundje/gjendje kronike. <i>Menaxhimi dhe vetëmenaxhimi i gjendjeve kronike në pacientët e moshuar. (Gjendjet/problemet më të zakonshme kronike të njerëzve të moshuar- Diabeti, Hipertensioni, Sëmundjet kardiovaskulare, Artriti,...).</i> |
| Java 8: | <ul style="list-style-type: none"> • Kujdesi shëndetësor i të moshuarve me demencë. <i>Llojet e demencës, simptomat e identifikimit, funksionimi i të moshuarit në varësi nga shkalla e demencës, modelet e zhvillimit / fazat, metodat dhe parimet e trajtimit</i> |
| Java 9: | <ul style="list-style-type: none"> • Përgjigjet ndaj sëmundjes (<i>Ndihma drejt rimëkëmbjes dhe reduktimi ose menaxhimi i dëmtimeve dhe aftësive të kufizuara</i>) • <i>Koncepti i Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF)</i> • <i>Koncepti i brishtësisë (frailty) në njerëz të moshuar</i> |
| Java 10: | <ul style="list-style-type: none"> • Mjetet dhe instrumentet për vlerësimin geriatric • <i>Vlerësimi gjithëpërfshirës geriatric dhe përbërësit e tij</i> • <i>Interpretimi i të gjeturave të vlerësimit geriatric (diagnostik, terapeutik dhe hapat e menaxhimit si rezultat i gjetjeve abnormale)</i> • <i>Roli i faktorëve socialë dhe mjedisorë dhe përvoja e jetës në kujdesin për pacientët e moshuar</i> • <i>Roli i mjeteve ndihmëse (p.sh. aparatet e dëgjimit, pajisjet e tualetit, mjetet e transferimit, mjetet e ecjes) në menaxhimin e njerëzve të moshuar me kufizim funksional</i> |
| Java 11: | <ul style="list-style-type: none"> • Komunikimi me pacientë të moshuar. • <i>Komunikimi i duhur me njerëz të moshuar, duke përfshirë ata me dëmtime njohëse ose ndijore</i> |
| Java 12 : | <ul style="list-style-type: none"> • Parimet e trajtimit dhe administrimit të barnave tek i moshuari (<i>përfshirë përdorimin efektiv dhe të sigurt të barnave si bazë për përshkrimin e recetave</i>) • <i>Efekti i moshimit në farmakodinamikën dhe farmakokinetikën tek njerëzit e moshuar</i> • <i>Praktika e përshkrimit të sigurt dhe të përshtatshëm tek të moshuarit, duke marrë parasysh fiziologjinë e ndryshme, ndërveprimet e barnave, dhe patologjitë e shumta dhe reagimet negative të barnave</i> • <i>Zbulimi dhe menaxhimi i nënpërdorimit, përdorimit të tepruar (duke përfshirë përdorimin e papërshtatshëm të ilaçeve) dhe polifarmacia në njerëz të moshuar</i> • <i>Integrimi i preferencave dhe vlerave të pacientit në vendimet për terapinë me barna</i> |
| Java 13 : | <ul style="list-style-type: none"> • Çështjet kryesore etike dhe ligjore në kujdesin për të moshuarit (në kontekstin ndërkombëtar dhe vendor) • <i>Marrja e vendimeve tek pacientët me aftësi të dëmtuar mendore për të marrë vendime (përfshirë konceptin e interesave më të mira dhe direktivat paraprake)</i> |

| | |
|------------------|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> • <i>Konceptet etike si bazë për marrjen e vendimeve mjekësore (koncepti i katër parimeve të autonomisë, bamirësisë, të mos bërit keq dhe drejtësisë)</i> • <i>Çështjet ligjore etike dhe specifike të vendit (lidhur me) :</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ushqimin dhe ushqimin artificial</i> • <i>Vendimet e reanimacionit kardiopulmonar</i> • <i>Tërheqja dhe ndalimi i trajtimit mjekësor</i> • <i>Eutanazia dhe vdekja e asistuar</i> |
| Java 14 : | <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kujdesi për pacientët e moshuar në mjedise të ndryshme</i> • <i>Konceptet e vlerësimit dhe menaxhimit geriatrik të pacientëve të moshuar në mjedise të ndryshme:</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kujdesi parësor dhe i komunitetit</i> • <i>Kujdesi akut në spital dhe kujdesi urgjent</i> • <i>Kujdesi rehabilitues spitalor dhe ambulator</i> • <i>Kujdesi afatgjatë institucional dhe jo-institucional</i> • <i>Kujdes paliativ dhe në fund të jetës</i> • <i>Kujdesi i integruar për të moshuarit. Qasja e integruar në kujdesin ndaj të moshuarit, trajtimi në institucione, në shtëpi, në bashkëpunim me ofrues të ndryshëm të shërbimeve.</i> |
| Java 15 : | <ul style="list-style-type: none"> • <i>Cilësia e jetës dhe moshimi. Nevojat dhe rreziqet e personave të moshuar.</i> • <i>Strategjitë e zhvillimit të mbrojtjes së të moshuarve në botë dhe Kosovë. Dokumentet themelore, mbrojtja e të drejtave të njerëzve të moshuar, organizatat dhe shërbimet.</i> • <i>Moshimi i shëndetshëm. Promovimi dhe mbrojtja e shëndetit të të moshuarve .</i> |

Politikat akademike dhe rregullat e sjelljes:

Celularët / telefonat inteligjentë dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod) duhet të jenë të fikura (ose në dridhje) dhe jo të ekspozuara gjatë kohës së mësimi.

Kompjuterët laptopë dhe tabletë lejohen vetëm për përdorim të heshtur; ndalohen aktivitetet e tjera të tilla si kontrollimi i postës elektronike personale ose shfletimi i internetit.

67. PËRDORIMI I ANTIBIOTIKËVE DHE REZISTENCA

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Përdorimi i antibiotikëve dhe rezistenca |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti i IV Semestri VII |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Kreditë ECTS: | 2 ECTS |
| Koha / Vendi: | Amfiteatër Sipas orarit |
| Mësimdhënësi: | Lul Raka |
| Të dhënat kontaktuese: | lul.raka@uni-pr.edu , 044 368 289 |
| Përshkrimi i lëndës: | Rezistenca ndaj antibiotikëve është një nga kërcënimet kryesore të shëndetit publik. Parandalimi i shfaqjes së |

| | |
|--|--|
| | rezistencës antimikrobike dhe shpërndarja e mikroorganizmave rezistentë do të zvogëlojë efektet e dëmshme dhe kostot përcjellëse të tyre. Një nga forcat kryesore lëvizëse për zhvillimin e rezistencës antimikrobike është përdorimi i pakontrolluar i antibiotikëve. Përdorimi joracional i antibiotikëve me spektër të gjerë nxit shfaqjen e rezistencës antimikrobiale në pacientë të zgjedhur, njësi specifike të kujdesit për pacientin dhe brenda institucioneve shëndetësore. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi është që të përgatisë mjekët e ardhshëm për përdorim të matur të antibiotikëve (përkrahja e qartë dhe saktë, barnat e duhura dhe terapitë e tjera me kontekstin klinik, rishikon përshtatshmërinë e barnave dhe terapitë e tjera dhe vlerëson përfitimet dhe treguesit e mundshme) dhe komunikon në mënyrë efektive në një kontekst mjekësor . |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kuptojnë rëndësinë e zgjedhjes antimikrobike, dozën, intervalin, kohëzgjatjen, përgatitjen dhe administrimin e antimikrobikëve. 2. Të njohin parimet e mikrobiologjisë në identifikimin e patogjenëve nga mostrat klinike. 3. Të njohin rolin themelor diagnostikues të laboratorit të mikrobiologjisë. 4. Të kuptojnë epidemiologjinë lokale të AMR, modelet e rezistencës dhe ndjeshmërisë dhe përdorimin e udhëzimeve klinike. 5. Të përvetesojnë parimet e këshillimit të pacientit, teknikat e diskutimit dhe psikologjinë për komunikimin e pacientit. 6. Të kuptojnë parimet e opsioneve të trajtimit empirik, sindromik ose të bazuar në kulturë në lidhje me përzgjedhjen e antimikrobikëve. |

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---------------------------------|--------------|-----------|----------|
| Ligjëratat | 1 | 15 | 15 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |

| | | | |
|---|--|----|-----------|
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | 1 | 15 | 15 |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja për provimin final | | | |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 60 |
| Metodat e mësimdhënies: | <ul style="list-style-type: none"> - Ligjërata - Huluntimi i çështjeve të përzgjedhura duke përdorur burimet e internetit - Detyra me shkrim dhe redaktim nga kolegët/instruktorët - Raporte të shkurtra studentore nga lista e leximit - Diskutim në klasë | | |
| Metodat e vlerësimit: | <ul style="list-style-type: none"> · Prania dhe pjesëmarrja në klasë: 10% · Prezantimi i temave/aktiviteteve: 20% · Kuize: 20% · Prezantimi përfundimtar: 10% · Provimi përfundimtar: 40% | | |
| Literatura primare: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Walsh C. Antibiotics: Actions, Origins, Resistance, ASM Press, 2003 2. A.Hauser. Antibiotic basics for clinicians- ABC of choosing the right antibacterial agent, LWW, 2013 3. K.Kon, M.Ra. Antibiotic Resistance: Mechanisms and New Antimicrobial Approaches, Academic Press, 2016 4. Antimicrobial stewardship-from principles to practice, BSAC (https://bsac.org.uk/antimicrobial-stewardship-from-principles-to-practice-e-book/) | | |
| Literatura shtesë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. M.D. Gilbert, David N. M.D. Chambers, Henry F. The Sanford Guide to Antimicrobial Therapy 2020 | | |
| Hartimi i planit mësimor | | | |
| Java | Titulli i ligjëratisë | | |
| <i>Java e parë:</i> | 1. Parimet kryesore të përdorimit të antibiotikëve dhe rezistencës ndaj tyre | | |

| | |
|------------------------------|---|
| <i>Java e dytë:</i> | 2. Situata globale dhe lokale e rezistencës antimikrobike- Qasja “Një Shëndet” |
| <i>Java e tretë:</i> | 3. shkaktarët kryesorë të AMR |
| <i>Java e katërt:</i> | 4. Grupet kryesore të antibiotikëve |
| <i>Java e pestë:</i> | 5. Përcaktimi i parimeve të përdorimit të antibiotikëve |
| <i>Java e gjashtë:</i> | 6. Profilaksia, terapia empirike, terapia definitive dhe drejtuesit e përdorimit të tepërt të antibiotikëve |
| <i>Java e shtatë:</i> | 7. Rezistenca antimikrobike |
| <i>Java e tetë:</i> | 8. Diagnostikimi i infeksionit |
| <i>Java e nëntë:</i> | 9. Trajtimi i infeksionit |
| <i>Java e dhjetë:</i> | 10. Parandalimi i infeksionit |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | 11. Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | 12. Sindromat klinike |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | 13. Programet e Kujdestarisë së Antibiotikëve |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | 14. Kujdesi parësor, dytesor dhe tretësor |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | 15. Shkathtësitë e komunikimit |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %

68. Kujdesi Holistik

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë, Mjekësi e përgjithshme |
| Titulli i lëndës: | Kujdesi Holistik |
| Niveli: | Bachelor |

| | |
|---|--|
| Statusi lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti IV, semestri VII |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 2 |
| Koha / lokacioni: | Klinika e Neurologjisë |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. Asoc. Zylfije Hundozi Prof. Asoc. Afrim Blyta Prof. Ass. Nexhmedin Shala Asistentët: Ass. Dr. Sci.Vera Kukaj Ass. Dr. Sci.Valbona Govori Ass. Dr. Blerim Myftiu, (<i>kandidat i PhD-së</i>) |
| Detajet kontaktuese: | Prof. Asoc. Zylfije Hundozi, (Klinika e Neurologjisë, tel kontaktues 0385006002860, zylhundozi@hotmail.com). Konsultimet, e enjte ora 10:00-11:00. Prof. Asoc. Afrim Blyta, (Klinika e Neurologjisë, tel kontaktues 0385006002803, afimblyta@gmail.com). Konsultimet: e mërkurë ora:10:00-11:00. Prof. Ass. Nexhmedin Shala (Klinika e Neurologjisë, tel kontaktues 0385006002821, drnexhmedin_shala@hotmail.com) Ass. Dr. Sci. Vera Kukaj (Klinika e Neurologjisë, tel kontaktues 0385006002803, verekukaj@hotmail.com). Ass. Dr. Sci. Valbona Govori (Klinika e Neurologjisë, tel kontaktues 0385006002005, valbonagovori@hotmail.com) Ass. Dr. Blerim Myftiu, (Klinika e Neurologjisë, tel kontaktues 044 306 831, blerimmyftiu@gmail.com) |
| Përshkrimi i lëndës | Kujdesi holistik nënkupton ofrimin e kujdesit fizik, emocional, social, ekonomik dhe shpirtëror ndaj pacientit. Lënda ka për detyrë që përveç kujdesit klasik shëndetësor, të ofrojë njohuri edhe për aspektet e tjera të nevojave të pacientëve, siç janë mirëkuptimi i tyre, ofrimi i mbështetjes emocionale dhe këshillimi për një baraspeshë më të mirë emocionale dhe fizike. Lënda shqyrton opsionet jomedikamentoze shtesë të trajtimit të patologjive të ndryshme, opsione të cilat përgjithësisht emërtohen si mjekësi alternative dhe komplementare. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi i modulit është ofrimi i njohurive bazike të kujdesit të përgjithshëm fizik dhe emocional ndaj pacientëve nga ana e infermierëve. |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | -Di bazën e komunikimit me pacientin dhe të krijojë raport të mirë komunikimi me pacientë -Dallon aspektet e vuajtjes emocionale dhe shpirtërore të pacientit -Kupton simptomatologjinë, klinikën e sëmundjeve dhe të njihet me metodat e rehabilitimit dhe adaptimit të pacientëve në familje dhe shoqëri. |

| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | | | | | |
|---|--|------------------|----------------------|-----------------------|-----|-----|--|
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej | | | | |
| Ligjërata | 1 | 15 | 15 | | | | |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | | | | | |
| Punë praktike | | | | | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsulti met | | | 3 | | | | |
| Ushtrime në teren | | | | | | | |
| Kollokviume, seminare | 1 | 15 | 15 | | | | |
| Detyra të shtëpisë | | | | | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 10 | 10 | | | | |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 15 | 15 | | | | |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | | | 2 | | | | |
| Projektet, prezantimet, etj | | | | | | | |
| Totali | | | 60 orë | | | | |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Metodat e mësimdhënies: Mësimi do të mbahet në formë të ligjëratave, seminareve dhe ushtrimeve praktike. | | | | | | |
| Metodat e vlerësimit: | Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit | | | | | | |
| | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Pjesa teorike</th> <th>Pjesa praktike</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>60%</td> <td>40%</td> </tr> </tbody> </table> | | Pjesa teorike | Pjesa praktike | 60% | 40% | |
| Pjesa teorike | Pjesa praktike | | | | | | |
| 60% | 40% | | | | | | |
| | <p><i>Vlerësimi do të bëhet me provim praktik ,e pastaj studenti i nënshtrohet vlerësim përfundimtar me test.</i></p> | | | | | | |
| Literatura | | | | | | | |
| Literatura bazë: | 1. D. Amen, (1998). Change your brain, change your life: The breakthrough program for conquering anxiety, depression, obsessiveness, anger, and impulsiveness. New York, NY: Three Rivers Press & Random House INC. Audiobook CD | | | | | | |

| | |
|---------------------------|--|
| Literatura shtesë: | <p>1. Adams, M. (2012). The Water Cure: An Interview with Dr. Batmanghelidj. Retrieved from: http://www.naturalnews.com/Report_water_cure_0.html (Links to an external site.)Links to an external site.</p> <p>2.Adams, M. (2006). Counter think: Cow's Milk is for Baby Cows. Retrieved from: http://www.counterthink.com/Cows_Milk_is_For_Baby_Cows.asp</p> |
|---------------------------|--|

Plani i dizajnuar i mësimit:

| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
|------------------------------|---|
| <i>Java e parë:</i> | Hyrje në mjekësinë holistike, komplementare dhe integrative |
| <i>Java e dytë:</i> | Qasjet komplementare në kujdesin shëndetësor (kiropraktika, naturopatia, akupunktura, ajurveda, homeopatia, mjekësia tibetane, mjekësia tradicionale kineze, akupunktura) |
| <i>Java e tretë:</i> | Stresi, shëndeti, sëmundja |
| <i>Java e katërt:</i> | Ushqimi si ilaç |
| <i>Java e pestë:</i> | Vetëdija për shëndetin holistik |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Fuqia shëruese e ujit |
| <i>Java e shtatë:</i> | Identifikimi i ushqimit i cili mund të jetë i dëmshëm |
| <i>Java e tetë:</i> | Roli i toksinave dhe si mund të eliminohen ato |
| <i>Java e nëntë:</i> | Mjekësia trup-mendje (vizatimi, meditimi, imagjinata, trajnimi autogjen) |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Ushtrimet (aktiviteti fizik) dhe kujdesi shëndetësor |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Kultura, tradita, bindjet dhe kujdesi shëndetësor. Terapia muzikore. |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Spiritualiti (besimi, lutja, religjioni) dhe kujdesi shëndetësor |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Gjenogrami (aplikimi në kujdesin shëndetësor) |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | Roli i familjes, shoqërisë dhe komunitetit në kujdesin shëndetësor |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | Aplikimi i kujdesit holistik në modelin aktual biomjekësor (mjekësinë moderne) |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Ligjëratat duhet të vijohen së paku 70%. Nëse studenti mungon më tepër se dy ushtrime ose nuk është aktiv gjatë mësimit, duhet të hyjë në kolokvium/test plotësues. Provimi organizohet me test përfundimtar dhe provim praktik. Provimi praktik është kusht për hyrje në provim përfundimtar Studenti nuk pranohet në provim pa indeks. Kërkohet mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë.

69. Mjekësi interne - NEFROLOGJI

| Informatat themelore për lëndën | | | |
|---|--|-----------|----------|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekesise | | |
| Titulli i lëndës: | Mjekësi interne - Nefrologji | | |
| Niveli: | Bachelor, Master | | |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm | | |
| Viti i studimeve: | Viti i IV-të Semestri i VIII-të | | |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+1 | | |
| Kreditë ECTS: | 3 | | |
| Koha / Vendi: | Sipas orarit/ Klinika e Nefrologjisë | | |
| Mësimdhënësi: | Prof.asoc. Ibrahim Rudhani Ass.dr. Naim Morina, PhDc | | |
| Të dhënat kontaktuese: | Klinika e Endokrinologjisë, kati i IV-të, zyra e shefit të katedrës | | |
| Përshkrimi i lëndës: | Moduli synon të pajisë studentin me njouri te pergjithsheme per nefrologjine, me njohuri teorike dhe praktike lidhur me semundje te veshkave dhe aparatit urinar. Ata pajisen me njohuri ne lidhje me çrregullime te ekuilibrit te brendshem dhe mjekimine tyre. Gjithashtu ata pajisen menjohuri per diagnostikimin dhe mjekimin e semundjeve te veshkeve , insuficiences renale akute e kronike, glomerulonefritet, terapine renale zevendesuese (hemodializa, dialia peritoneale, transplantu renal). | | |
| Qëllimet e lëndës: | Perftimi i njohurive baze per semundjet e aparatit urinar Aftesimi per te ekzaminuar pacientin me semundje te veshkev Aftesimi per te diagnostikuar pacientin me semundje te veshkeve Aftesimi per te mjekuar te semurin me semundje te veshkës | | |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Studenti te jete i afte te percaktoje problematiken renale te pacientit Studenti te jete i afte te zgjedhe metodat diagnostike qe duhen perdorur ne problematika te ndryshme renale Studenti te jete ne gjendje per te vene diagnozen e semundjeve renale Studenti te jete i afte te mjekojë semundjet renale | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjëratat | 2 | 15 javë | 30 orë |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | 1 | 15 javë | 15 orë |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| <i>Puna në terren</i> | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |

| | | | |
|---|---|--|---------------|
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 30 |
| Përgatitja për provimin final | | | |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 75 orë |
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjërata me diskutime interaktive, seminare, ushtrime praktike dhe konsultime. | | |
| Metodat e vlerësimit: | Vlerësimi i studentit zhvillohet në tri faza: I, II, III Testet Intermediare (me shkrim) Test Preliminar (me shkrim) Provimi Përfundimtar (me gojë) | | |
| Literatura primare: | <p>18. Thereska. N, Kodra S, Koroshi. A, Barbullushi. M, Strakosha. A, Pashko. Nevi. Sëmundjet e veshkave, Trianë 2015</p> <p>19. Harrison's Principles of Internal Medicine, 17th Edition, International edition, 2008</p> <p>20. Vrhovac B, Francetic I, Jaksic B, Labar B, Vucelic B. Interna Medicina, Zagreb, 2003</p> <p>21. Edgar V, Lerma i, Allen R. Nissenson, Nephrology & Hypertension</p> | | |
| Literatura shtesë: | 15. Alex M. Davison, J. Stewart Cameron, Jean-Pierre Grunfeld, Claudio Ponticelli, Eberhard Ritz, Christopher G Winearls, Charles van Ypersele, Traktati i Oksfordit-Nefrologjia Klinike | | |
| Hartimi i planit mësimor | | | |
| Java | Titulli i ligjërates | | |
| <i>Java 1:</i> | Anatomia dhe fiziologjine e veshkave, metodat diagnostike të sëmundjeve të traktit urinar | | |
| <i>Java 2:</i> | Analiza e urinës | | |
| <i>Java 3:</i> | Vlersimi i funksionit te veshkeve, ekzaminimet imazherike dhe radioizotopike ne nefrologji | | |
| <i>Java 4:</i> | Infeksionet e traktit urinar. Tuberkulozi i traktit urinar | | |
| <i>Java 5:</i> | Sëmundjet e glomerulare (primare dhe sekondare) Sindroma nefrotike | | |
| <i>Java 6:</i> | Glomerulonefritet dytesore: nefriti lupik, vaskulitet me prekje te veshkeve | | |
| <i>Java 7:</i> | Semundjet renale hereditare, veshka polikistik, Sy. Alport | | |
| <i>Java 8:</i> | Pamjaftushmeria akute e veshkeve, etiopatogeneza, klasifikimi, klinika, cregullimet hidroelektrolotike dhe statusit acidobazik | | |
| <i>Java 9:</i> | Pamjaftushmeria akute e veshkeve – diagnoza, diagnoza diferenciale, mjekimi | | |
| <i>Java 10:</i> | Veshka dhe hipertensioni, veshka dhe shtatëzania | | |
| <i>Java 11:</i> | Pamjaftushmeria kronike e veshkeve: etiopatogeneza, diagnoza, klinika, nephropathia diabetike | | |

| | |
|-----------------|--|
| Java 12: | Mjekimi medikamentoz i pamjaftushmerise kronike te veshkeve |
| Java 13: | Sëmundjet tubulointerstiale të veshkave: nefropatia endemike; nefropatia toksike |
| Java 14: | Nefrolitiaza, uropatia obstruktive, tumoret e sistemit urinar |
| Java 15: | Hemodializa dhe dializa peritoneale, transplantimi i veshkës |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*

70. Mjekësi interne - ENDOKRINOLOGJI

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekesise |
| Titulli i lëndës: | Mjekësi interne - Endokrinologji |
| Niveli: | Bachelor, Master |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti i IV-të Semestri i VIII |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+1 |
| Kreditë ECTS: | 3 |
| Koha / Vendi: | Sipas orarit/ Klinika e Endokrinologjisë |
| Mësimdhënësi: | Prof.ass. Venera Berisha-Muharremi Ass.dr. Merita Emini-Sadiku PhD Ass.dr. Rina Tafarshiku, PhDc |
| Të dhënat kontaktuese: | Klinika e Endokrinologjisë, kati i IV-të, zyra e shefit të katedrës |
| Përshkrimi i lëndës: | Moduli synon të pajisë studentin me formim të përgjithshëm mbi patologjitë endokrine. Endokrinologjia është një specialitet i rëndësishëm në formimin e mjekut të përgjithshëm. Nëpërmjet saj synohet që studenti të njihet me sëmundjet endokrinologjike më të shpeshta dhe më të rëndësishme, strukturën e patologjive, etiologjinë dhe patogjenezën, semiotikën kliniko-laboratorike, algoritmin e diagnozës, diagnozat diferenciale, parimet e mjekimit të tyre. |
| Qëllimet e lëndës: | -Përfitimi i njohurive bazë të studentit mbi sistemin endokrin dhe sëmundjet endokrine. -Të kuptuarit e rëndësisë së gjendrave endokrine, rolin dhe funksionin e gjendrave të ndryshme endokrine, mekanizmin feed-back dhe funksionimin e tij në rregullimin e sistemit endokrin. Provat funksionale, |

| | <p>algoritmet e diagnozës dhe trajtimit të patologjive endokrine.</p> <p>-Aftësimi për të njohur sistemin endokrin në tërësi, gjendrat e ndryshme me funksion endokrin, strukturën e patologjive endokrine, etiologjinë, patogjenezën, klinikën dhe ekzaminimet laboratorike që ndihmojnë në diagnozën e sëmundjeve endokrine.</p> <p>- Aftësimi për t'u njohur me shenjat klinike, diagnozat diferenciale dhe parimet e mjekimit të sëmundjeve të ndryshme endokrine. Aftësimi nëpërmjet rasteve klinike, demonstrimeve praktike, imazherike dhe diskutimit në grup, lidhur me etapat e ndryshme të diagnozës dhe trajtimit të patologjive endokrine.</p> | | |
|--|--|------------------|-----------------|
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <p>-Kuptimi logjik i koncepteve bazë të funksionimit të sistemit endokrin. Roli i provave të stimulimit dhe frenimit në diagnozën e sëmundjeve endokrine.</p> <p>-Kuptimi i algoritmeve të diagnostikimit, trajtimit dhe ndjekjes së patologjive endokrine.</p> <p>-Njohja e shenjave klinike dhe diagnoza diferenciale e sëmundjeve endokrine.</p> <p>-Rëndësia e zbulimit të hershëm dhe e parandalimit të disa sëmundjeve endokrine si obeziteti, Diabeti Mellitus tip 2, struma endemike.</p> | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjëratat | 2 | 15 javë | 30 orë |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | 1 | 15 javë | 15 orë |
| Konsultime me mësimdhënësin | 0.25 | 15 javë | 2.5 orë |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 15 orë |
| Përgatitja për provimin final | 0.7 | 15 javë | 10.5 orë |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 1 | 1 javë | 1 orë |
| Projektet, prezantimet, etj. | 1 | 1 javë | 1 orë |
| Total | | | 75 orë |
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjëratë me diskutime interaktive, seminare, ushtime praktike dhe konsultime. | | |
| Metodat e vlerësimit: | Vlerësimi i studentit zhvillohet në tri faza: I, II, III Testet Intermediare (me shkrim) Test Preliminar (me shkrim) | | |

| Provimi Përfundimtar (me gojë) | |
|--------------------------------|---|
| Literatura primare: | <p>22. Fauci A, Braunwald E et all. <i>Harrison's Principles of Internal Medicine</i>, 18th Edition, International edition, 2012</p> <p>23. Grup Autorësh. <i>Parimet e Mjekësisë së Përgjithshme</i>. Tiranë, 2002</p> <p>24. Kumar P, Clark M. Kumar & Clark Clinical Medicine, 6th Edition, International edition, 2005</p> <p>25. Vrhovac B, Francetic I, Jaksic B, Labar B, Vucelic B. <i>Interna Medicina</i>, Zagreb, 2003</p> |
| Literatura shitesë: | <p>16. Boon A.N, Colledge R.N, Walker B.R, Hunter J. Davidson's Principles and Practice of Medicine, 20th Edition, International edition, 2006</p> <p>17. Ylli A, Agaçi F. Endokrinologjia, Diabeti, Metabolizmi. Tiranë, 1999</p> |
| Hartimi i planit mësimor | |
| Java | Titulli i ligjëratës |
| Java 1: | Hyrje në Endokrinologji. Sistemi endokrin, funksioni i gjendrave endokrine. Mekanizmi feed-back. Hormonet e hypofizës anteriore. Hiperfunksioni i hypofizës anteriore. |
| Java 2: | Hypofunksioni i hypofizës anteriore. Hypofiza posteriore. Tumoret josekretore të hypofizës. |
| Java 3: | Gjendra tiroide. Hiperfunksioni i saj, format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. |
| Java 4: | Hypotiroidizmi. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. Gusha endemike. Etiologjia, patogjeneza, klinika, trajtimi, parandalimi. |
| Java 5: | Tiroiditet. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. Kanceri i tiroides. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. |
| Java 6: | Gjendrat paratiroide. Hiper dhe hypofunksioni i tyre. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. |
| Java 7: | Hiperfunksioni dhe hipofunksioni i gjendrave adrenale. Sindr. Cushing. M. Addison. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi |
| Java 8: | Hipofunksioni i gjendrave adrenale. M. Addison. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. |
| Java 9: | HTA endokrin. Feokromocitoma. M. Conn. Hiperplazia adrenale kongenitale. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. |
| Java 10: | Hypogonadizmi femëror dhe mashkullor. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. |
| Java 11: | Diabeti Mellitus. Format dhe shenjat klinike. Personat e rrezikuar. Diagnoza, diagnoza diferenciale. |
| Java 12: | Dieta, aktiviteti fizik dhe trajtimi medikamentoz i Diabetit Mellitus. |

| | |
|-----------------|--|
| Java 13: | Ndërlikimet kronike të Diabetit Mellitus. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. |
| Java 14: | Obeziteti. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. Dislipidemitë. Format dhe shenjat klinike. Diagnoza, trajtimi. |
| Java 15: | Urgjencat endokrine. Etiologjia, format dhe shenjat klinike. Diagnoza, diagnoza diferenciale, trajtimi. |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*

71. Mjekësi interne - REUMATOLOGJI

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekesise |
| Titulli i lëndës: | Mjekësi interne – Reumatologji |
| Niveli: | Bachelor, Master |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti i IV-të Semestri i VIII-të |
| Numri i orëve në javë: | 1+0+1 |
| Kreditë ECTS: | 2 |
| Koha / Vendi: | Sipas orarit/ Klinika e Reumatologjisë |
| Mësimdhënësi: | Prof.ass. Shemsedin Sadiku Prof.ass. Aurora Bakalli Ass.dr. Mjellma Rexhepi, PhDc Ass.dr. Rrezarta Alihajdari , PhDc |
| Të dhënat kontaktuese: | Klinika e Endokrinologjisë, kati i IV-të, zyra e shefit të katedrës |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda e Reumatologjisë shtjellon problematikën mbi sëmundjet reumatizmale inflamatore, degjenerative, rrethartikulare, metabolike te kockave dhe sëmundjet e ralla reumatike dhe para reumatike. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimet kryesore janë të shtjellohen teorikisht dhe të demonstron në praktikë sëmundjet reumatizmale. Të ofrohen njohuri për etiologjinë e tyre, pasqyrën klinike, komplikimet e mundshme, diagnostikimin, diagnozën diferenciale dhe mjekimin këtyre sëmundjeve. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Studenti duhet: -të njoh dhe kuptoj metodat klinike bazë për ekzaminimin e pacientit me sëmundje reumatizmale, |

| | |
|--|---|
| | <p>-të bëjë diagnostikimin e tyre dhe diagnozën diferenciale,</p> <p>-të ordinoj terapinë dhe të përcjellë klinikisht efektin e saj,</p> <p>-të bëjë diferencimin dhe menaxhimin e situatave urgjente në kushte jashtëspitalore,</p> <p>-të identifikoj rastet të cilat kërkojnë trajtim spitalor në nivelet e shërbimeve shëndetësore sekondare ose terciare, si dhe të udhëzoj pacientin në institucionin përkatës mjekësor,</p> <p>-të përcjellë gjendjen klinike të pacientit pas lëshimit nga spitali, të ordinoj terapinë sipas rekomandimeve ose në marrëveshje me specialistin.</p> |
|--|---|

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---------------------|------------------|-----------------|
| Ligjëratat | 1 | 15 javë | 15 orë |
| Përshkrimi i lëndës: | Zhvillimi i kujdesit për traumën pasqyron kontributet e shumë civilizimeve dhe kulturave dhe përvetësimin e ngadaltë të njohurive shkencore. Kur njeriu eci për herë të parë në këtë planet, lëndimet e tij duhet të kenë qenë një takim i afërt i llojit të parë. Edhe pse është e vështirë të vizualizosh luftën e njerëzve të hershëm për mbijetesë në një mjedis armiqësor, shkrimet më të hershme sugjerojnë që trauma ishte një problem i madh. Trauma është një sëmundje multisistemike dhe, si e tillë, përfiton pothuajse nga çdo përparim në shkencën mjekësore. Ndërsa mësojmë më shumë rreth fiziologjisë dhe biokimisë së sistemeve të ndryshme të organeve, ne mund të sigurojmë menaxhim më të mirë për viktimat e traumës. Teknikat e përmirësuara të imazherive medikale, vlerësimi më i mirë i tolerancës fiziologjike dhe kuptimi i shtuar i efekteve anësore të procedurave specifike kirurgjikale janë kombinuar për të zvogëluar ndërhyrjen operative si një përbërës i kujdesit të pacientit trauma. |
| Qëllimet e lëndës: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Të demonstroj njohuri mbi parimet themelore të traumës kirurgjikale 2. Të dëshmojë njohje të metodave diagnostike në Traumën Kirurgjike. 3. Të demonstroj njohuri themelore për kujdesin e pacientëve të lënduar. 4. Të demonstroj njohuri themelore për të menaxhuar me sukses organizimin kompleks, që është qendra moderne e traumës. 5. Të demonstrojë njohje të parimeve dhe teknikave bazike adekuate të traumës kirurgjike, në praktikën klinike, në sallën e operacionit, i ndihmuar dhe pa ndihmën e asistentit apo profesori. 6. Të jetë në gjendje të ndihmojë në sallën e operacionit të traumës. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Të fitoj njohuri themelore për kujdesin e pacientëve të lënduar. 2. Fiton njohuri themelore për traumën diagnostike, indikacionet për trajtimin kirurgjik dhe mënyrën e realizimit të teknikave kirurgjikale. 3. Fiton njohuri themelore rreth organigramës së punës klinike dhe punës në ekip. 4. Fiton njohuri themelore në lidhje me rrugët për rehabilitim brenda ditëve të para të lëndimit dhe intervalin midis dëmtimit dhe rehabilitimit |

| | 5. Merrë njohuri themelore të mbledhjes elektronike dhe vendosjen të të dhënave në skedar, dhe përdorimin e metodave statistikore për kërkime klinike dhe shkencore. | | |
|--|---|-----------------------|-----------|
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjëratat | 2 | 1/15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | 5 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 15 |
| Përgatitja për provimin final | | | 10 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 60 |
| Metodat e mësimdhënies: | Mësimi do të jetë i rregullt, dhe do të organizohen ligjërata grupore (dy grupime), puna klinike do të organizohet nëpër të gjitha Klinikat e Kirurgjisë, si pjesë e ushtrimeve praktike, punë seminarike në grupe të vogla dhe zbatimi i metodologjisë së të nxënurit njohuri; mësimi i bazuar në problem (MBP). | | |
| Metodat e vlerësimit: | <p>Studjëtët do të vlerësohen për punën e tyre; me seminare, kollokiume, teste dhe provim final. Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv.</p> <p>Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:</p> <p style="padding-left: 20px;">Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</p> <p style="padding-left: 20px;">Vijimi i rregullt: 5%</p> <p style="padding-left: 20px;">Provimi praktik: 40%</p> <p style="padding-left: 20px;">Provimi final: 50%</p> <p style="padding-left: 20px;">Total 100%</p> | | |
| | Pjesa Teorike | Pjesa Praktike | |
| | 60% | 40% | |
| Literatura primare: | <p>Trauma Contemporary Principles and Therapy 1st Edition, 2008. Editors: Flint, Lewis; Meredith, J. Wayne; Schwab, C. William; Trunkey, Donald D.; Rue, Loring W.; Taheri, Paul A.</p> <p>Trauma Manual, The: Trauma and Acute Care Surgery, 3rd Edition. Editors: Peitzman, Andrew B.; Rhodes, Michael; Schwab, C. William; Yealy, Donald M.; Fabian,</p> | | |

| | |
|---------------------------|---|
| | Timothy C. Textbook of surgery, Third Edition. Blacwell publishing, 2010. Shaqiri G. Lëndimet. Botim i parë. 2005. |
| Literatura shtesë: | Burime nga interneti www.google.com |

| Hartimi i planit mësimor | |
|---------------------------------|---|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| <i>Java 1:</i> | Sistemi i Traumës |
| <i>Java 2:</i> | Parandalimi dhe Kontrolli i Lëndimit |
| <i>Java 3:</i> | Qendra e Traumës |
| <i>Java 4:</i> | Ekipi i Traumës |
| <i>Java 5:</i> | Pacienti i Traumës (Kujdesi Parahospitalor, Reanimimi Fillestar dhe Diagnostifikimi) |
| <i>Java 6:</i> | Dëmtimet Neurokirurgjike |
| <i>Java 7:</i> | Menaxhimi Kompresiv i Lëndimeve Maksilofaciale, Dëmtimeve të Syve, Lëndimeve të qafës |
| <i>Java 8:</i> | Lëndimet torakale |
| <i>Java 9:</i> | Lëndimet vaskulare |
| <i>Java 10:</i> | Lëndimet e Barkut I (Lëndimet e Ezofagut dhe stomakut, Dëmtimet e duodenit dhe Pankreasit) |
| <i>Java 11:</i> | Lëndimet e Barkut II (Lëndimet e Mëlçisë dhe Shpretkës, Vlerësimi dhe Menaxhimi i Lëndimeve të Zorrëve të Holla, Zorrës së Trashë dhe Rektumit) |
| <i>Java 12:</i> | Lëndimet e Veshkave dhe Gjenitourinare |
| <i>Java 13:</i> | Lëndimet Pediatrike |
| <i>Java 14:</i> | Kujdesi Kritik i Pacientëve të Dëmtuar, Problemi Special Ndërdisciplinor dhe Anestezioni për Traumën Kirurgjike |
| <i>Java 15:</i> | Lëndimet në Kirurgjinë Plastike, Etika dhe Kujdesi Mëshirues |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Studentët dhe stafi akademik duhet të jenë aktivë dhe interaktivë në mes vete, konform rregullave dhe Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Sistemit Shkollor të Bolonjës, në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira në mësimdhënie dhe mësimnxënje. Ligjeratat duhet të vijohen së paku 70%. Puna praktike duhet vijuar së paku 80%. Nëse studenti mungon më tepër se dy ushtrime, seminare ose nuk është aktiv gjatë mësimit, duhet të hyj në kolokvium. Mbrojtja e seminarit është kusht për hyrje në provim. Studenti nuk pranohet në provim pa indeks ose kartë identiteti e Studentit.

81. MJEKËSIA E PUNËS

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|---------------------------------|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | MJEKËSIA E PUNËS |
| Niveli: | Studime Themelore të Integruara |
| Statusi i lëndës: | Obligative |
| Viti i studimit: | Viti i IV-të Semestri VIII |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+0 |

| | |
|--|---|
| Kreditë ECTS: | 2 ECTS |
| Koha/Vendi: | Amfiteatri IKSHPK Sipas orarit. |
| Mësimdhënësi: | Naim Jerliu |
| Të dhënat kontaktuese: | naim.jerliu@uni-pr.edu ; Ndërtesa e IKSHPK, Kati 4. |
| Përshkrimi i lëndës: | <p>Lënda prezanton parimet themelore të punës dhe shëndetit dhe të mjekësisë së punës.</p> <p>Përshkruhet një skemë e gjerë për të njohur, diagnostikuar dhe menaxhuar një sërë problemesh shëndetësore të lidhura me punën. Për më tepër, kjo lëndë përqendrohet në promovimin dhe ruajtjen e shëndetit dhe aftësisë për punë të punëtorit dhe shoqërisë punuese.</p> <p>Lënda mbulon temat e mëposhtme: parimet themelore, ndikimin e punës në shëndet, efektin e shëndetit në punë, dhe promovimin e shëndetit. Ajo siguron informacion mbi këto tema dhe synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe njohuritë rreth rreziqeve në vendin e punës dhe të ndihmojë profesionistët e shëndetit për të mbrojtur shëndetin e punëtorëve dhe jetën e tyre. Gjithashtu, synohet të rritet interesimi i studentëve të mjekësisë në këtë fushë dhe të inkurajohen ata që të konsiderojnë mjekësinë e punës si një karrierë.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Qëllimet e kësaj lënde janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - t'u sigurojë studentëve të mjekësisë njohuri të mjaftueshme dhe aftësi dhe qëndrime të përshtatshme në trajtimin e çështjeve të lidhura me punën për t'i lejuar ata të funksionojnë në mënyrë efektive si profesionistë të shëndetit në një shoqëri në zhvillim dhe një botë të punës të ndryshueshme. - të informojë dhe t'i bëjë studentët entuziastë për specializimin dhe fushën e mjekësisë së punës dhe t'i inkurajojë ata që ta konsiderojnë mjekësinë e punës si karrierë. - të sigurojë mësimdhënie të mjekësisë së punës të harmonizuar me standardet në programet universitare të studimeve mjekësore nëpër vendet e BE-së. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <p>Objektivat janë që deri në fund të këtij moduli studenti të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kuptojë rëndësinë e punës dhe mjedisit më të gjerë për shëndetin dhe sëmundjen (Njohuri) - kuptojë ndikimin e shëndetit dhe sëmundjes në pjesëmarrjen në jetën e përditshme dhe në punë (Njohuri) - marrë një histori (anamnezë) të punës (profesionale) (Aftësi) - përshkruajë strukturën dhe rolin e shërbimeve të shëndetit në punë dhe mjekëve të punës (Njohuri) - vlerësojë perspektivat e ndryshme të kërkuara nga qasja e shëndetit në punë (Qëndrimet) - përshkruajë agentët të rëndësishëm (kimik, fizik, biologjik, psikosocial) dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e sëmundjeve në jetën profesionale (në punë) (Njohuri) |

| | | | |
|---|---|--------------------|-----------------|
| | <p>- analizojë punën dhe vendet e punës nga perspektiva e mjekësisë së punës në lidhje me rrezikun për sëmundje dhe aftësinë e punës të reduktuar në përgjithësi, por edhe për individët me dobësi (vulnerabilitet) të veçantë (Njohuri, aftësi)</p> <p>- përdorë burime të mëtejshme dhe të dijë se ku të kërkojë ndihmë të specializuar (Njohuri, aftësi)</p> <p>- shpërndajë këshilla të përshtatshme tek pacientët e vet për aftësinë e kufizuar, rregullimin në vendin e punës dhe rehabilitimin në vendin e punës (Njohuri, aftësi)</p> <p>- pranojë përgjegjësinë ndaj parandalimit dhe raportimit të sëmundjes në punë dhe promovimit të shëndetit në punë (Qëndrimet)</p> <p>- ketë njohuri për aspektet ligjore dhe të menaxhojë problemet etike të çështjeve të lidhura me punën (Njohuritë, aftësitë)</p> | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatin e nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orët | Ditë / Javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Ushtime / Punë Praktike | | | |
| Punë terreni/ Vizita në vend pune | 4 | 1 | 4 |
| Test, seminar, prezentime | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Vetë-studim (bibliotekë ose shtëpi) | | | 10 |
| Përgatitja për provimin përfundimtar | | | 15 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi përfundimtar) | | | 1 |
| Projektet | | | |
| Total | | | 60 |
| Metodat e mësimdhënies: | <p><i>Ligjërata, ushtime praktike, punë projekti / seminar, detyra shtëpie individuale, vizitë në vendin e punës.</i></p> <p><i>Përfshihen materiale mësimore tradicionale dhe të vetë-drejtuar, të bazuara në internet.</i></p> | | |
| Metodat e vlerësimit: | <ul style="list-style-type: none"> · Vijueshmëria dhe pjesëmarrja në klasë: 10% · Prezantimet e përgjigjeve në tema/ aktivitete: 1 0% · Projekte / detyra individuale: 20% · Provimi përfundimtar: 6 0% <p>Detyrat do të vlerësohen në bazë të përmbajtjes, organizimit dhe cilësisë së shkrimit.</p> | | |
| Literatura primare: | <p>Naim Jerliu. Mjekësia e Punës (<i>Shënime Ligjërata</i>), Prishtinë, 2021</p> <p>Joseph LaDou, Robert Harrison. Current Occupational & Environmental Medicine. 6th Edition, McGraw Hill, 2021</p> | | |

| | |
|---------------------------|---|
| | Naim Jerliu. Legjislacioni për shëndetin dhe sigurinë në punë (<i>Përmbledhje</i>). Prishtinë, 2021. |
| Literatura shtesë: | <p><i>Burime tekstesh të tjera</i></p> <p>Tee L. Guidotti M.D. M.P.H. The Handbook of Occupational and Environmental Medicine. 2nd edition. ABC-CLIO, 2020</p> <p>Finlay Dick, Julia Smedley, Steven Sadhra (Ed.) Oxford Handbook of Occupational Health. 2nd Edition, OUP Oxford, 2013</p> <p>Raymond Agius, Anthony Seaton. Practical Occupational Medicine. 2nd Ed. Hodder Education, 2005</p> <p>David Snashall, Dipti Patel (Ed.). ABC of Occupational and Environmental Medicine. 3rd Edition, Wiley, 2012</p> <p>David Soo Quee Koh, Ken Takahashi (Ed). Textbook Of Occupational Medicine Practice (3rd Edition). World Scientific Publishing Company. 2011</p> <p>Principles, Practice, Populations, and Problem-Solving, 2nd Edition</p> <p>Harrington JM, Aw TC, Gardiner K. Pocket Consultant: Occupational Health – 5th Edition, Wiley-Blackwell, 2006</p> <p>Linda Rosenstock, Mark Cullen, Carl Brodken, and Carrie Redlich. Textbook of Clinical and Environmental Medicine, 2nd Edition, 2004.</p> <p>William N Rom and Steven B. Markowitz. Environmental & Occupational Medicine, 4th Edition, 2007.</p> <p><i>Materiale mësimore të bazuara në internet</i></p> <p>European Module for Undergraduate Teaching of Occupational Medicine https://emutom.eu/</p> <p>Raymond Agius. Index of Educational Resources: Occupational and Environmental Medicine and Health http://agius.com/hew/resource/index.htm</p> <p>Dr. Tee Guidotti. Occupational and Environmental Medicine www.teeguidotti.com</p> <p>International Labour Organization (ILO), Your health and safety at work (series). http://www.ilo.org/safework/info/instr/WCMS_113080/lang--en/index.htm</p> <p>Workers' Health Education https://webcommunities.hse.gov.uk/connect.ti/riskeducation/view?objectId=62665</p> <p><i>Vegëza</i></p> |

| | |
|--|---|
| | <p>The European Association of Schools of Occupational Medicine (EASOM) http://www.easom.org</p> <p>European Agency for Safety and Health at Work http://osha.europa.eu/en/about</p> <p>International Labour Organization (ILO) www.ilo.org</p> <p>WHO. Occupational health https://www.who.int/health-topics/occupational-health</p> <p>The International Commission on Occupational Health (ICOH) http://www.icohweb.org/site/homepage.asp</p> <p>Occupational health and safety. https://ohsonline.com/Home.aspx</p> |
|--|---|

Plani i hartuar mësimor

| Java | Titulli i temës / ligjëratës |
|----------------|---|
| <i>Java 1:</i> | <p>Hyrje e përgjithshme për punën dhe shëndetin</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përkufizimet - Rëndësia e mjekësisë së punës - Marrëdhëniet midis punës dhe shëndetit - Tregu evropian / kosovar i punës |
| <i>Java 2:</i> | <p>Puna dhe shëndeti</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shëndeti dhe siguria në punë - Legjislacioni Evropian - Shëndeti dhe siguria në punë - Legjislacioni i Kosovës - Struktura dhe roli i shërbimeve shëndetësore në punë dhe detyrat e mjekëve të punës |
| <i>Java 3:</i> | <p>Puna dhe shëndeti</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shtrirja e problemit: aksidentet, sëmundjet profesionale, mungesat në punë - Pyetjet kryesore për të ardhmen: PARP (WARP) - Marrja e një historie (anamneze) profesionale (të punës) - Etika |
| <i>Java 4:</i> | <p>Efekti i punës në shëndet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi - Agjentë toksikologjikë dhe kimikatet <p>Përkufizimet dhe konceptet themelore, Burimet e rrezikut, rrugët e ekspozimit, hyrja / thithja, metabolizmi, vlerësimi i ekspozimit, monitorimin biologjik dhe i ambientit Toksikologjia në punë e fibrave minerale, metaleve, gazrave, asfiksuesve, irituesve, tretësve organikë Parandalimi</p> |
| <i>Java 5:</i> | <p>Efekti i punës në shëndet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Agjentët biologjikë <p>Përkufizimet, profesionet me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë Përmbledhje e rreziqeve kryesore biologjike dhe efekteve të tyre mbi njerëzit Parandalimi</p> |

| | |
|------------------|---|
| Java 6 : | <p>Efekti i punës në shëndet Siguria dhe shëndeti në punë në emergjencat e shëndetit publik Masat e shëndetit publik dhe sociale në vendin e punës në kontekstin e emergjencave të shëndetit publik Parandalimi, identifikimi dhe menaxhimi i infeksionit të punonjësit shëndetësor në kontekst të emergjencave shëndetësore publike</p> |
| Java 7: | <p>Efekti i punës në shëndet - Agjentët fizikë <u>Zhurma:</u> Pasqyrë e fizikës së zërit dhe njësitë e matjes, fiziologjia bazë e veshit dhe efektet e zhurmës.</p> |
| Java 8: | <p>Efekti i punës në shëndet - Agjentët fizikë <u>Vibrimi:</u> Përmbledhje e fizikës së dridhjeve dhe efektet e saj shëndetësore në gjithë trupin dhe lokalisht. <u>Klima:</u> Hyrje në përgjigjet e njeriut ndaj mjedisit termik dhe mënyrat për ta vlerësuar atë. <u>Rrezatimi:</u> Hyrje në spektrin elektromagnetik dhe brezat e ndryshëm të rrezatimit jo-dhe jonizues.</p> |
| Java 9: | <p>Efekti i punës në shëndet - Fizika (Ergonomia) Kërkesat fizike Dhimbja jospesifikë e mesit (belit) Këshillimi i punëtorit dhe parandalimi</p> |
| Java 10: | <p>Efekti i punës në shëndet - <i>Aspektet psikosociale / mendore</i> Përkufizimet Çrregullime mendore të lidhura me Punën Faktorët e rrezikut psikosocial</p> |
| Java 11 : | <p>Efekti i punës në shëndet - Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut në vendin e punës - Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë për mjekët në mjedisin klinik</p> |
| Java 12 : | <p>Efekti i shëndetit në punë (Fitness për punë) - <i>Hyrje: ndikimi, pozitiv dhe negativ, i shëndetit në punë.</i> Pasojat e sëmundjes (kronike), modeli ICF, Arsyetimi klinik dhe vendimmarrja Aktivitete që vlerësojnë aftësinë për punë dhe pjesëmarrjen, Ndërhyrjet dhe mbështetja aktive Parandalimi</p> |
| Java 13 : | <p>Promovimi i shëndetit në vendin e punës - Përkufizimet - Historiku - Modeli evropian i referimit për promovimin e shëndetit në vendin e punës</p> |
| Java 14 : | <p>Promovimi i shëndetit në vendin e punës Analiza e treguesve negativë të shëndetit në një mjedis konkret pune (incidenca e pushimit mjekësor, lëndimet e lidhura me punën dhe paaftësia) Formulimi i një propozimi për masat e duhura për të zvogëluar ose eliminuar treguesit negativë</p> |

| | |
|------------------|---|
| | Diskutime të rasteve, seminare të bazuara në probleme dhe vizita studimore |
| Java 15 : | Vlerësimi dhe diskutimi i përgjithshëm i kursit dhe detyrave të shtëpisë gjatë semestrit dhe përgatitja për provimin përfundimtar |

Politikat Akadematike dhe Kodi i Sjelljes

*Telefonat mobil / të mençur dhe pajisje të tjera elektronike (p.sh. . IPods) duhet të jenë të fikur (ose në vibrim) dhe të mos shihen gjatë kohës së mësimi.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë janë të lejuar vetëm për përdorim në heshtje; ndalohen aktivitetet e tjera të tilla si kontrollimi i postës elektronike personale ose shfletimi i internetit.*

82. PEDIATRI

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekesise |
| Titulli i lëndës: | Pediatria |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti i - V të Semestri i IX-X |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+3 |
| Kreditë ECTS: | 9 ECTS |
| Koha / Vendi: | Fakulteti i Mjekesise- Amfiteatri- Klinika e Pediatrise |
| Mësimdhënësi: | Prof. Assoc. Lidvana Spahiu, Prof. Ass. Naim Zeka, Prof Ass Vlora Ismaili - Jaha |
| Të dhënat kontaktuese: | 038 500 600 3915 |
| Përshkrimi i lëndës: | Njohuritë e studenteve me semundjet e femijeve sipas sistemeve dhe kujdesit paresor, dytesor dhe tretesor të femijeve. |
| Qëllimet e lëndës: | Studentet të fitojnë njohuri për semundjet e ndryshme të femijeve në periudha të ndryshme të femijerisë. Metodatat diagnostike, gjetjet laboratorike, ekzaminimet plotësuese dhe mjekimin e tyre. Identifikimi, përshkrimi dhe shpjegimi i tipareve më të rëndësishme të rritjes dhe zhvillimit të femijes, semundjet e sistemit neuromuskular, kardiovaskular, të frymemarrjes, renal, gastrointestinal dhe endokrine në nivelin e qelizave të organeve dhe të gjithë organizimit. Të njohin simptomat klinike të semundjeve të sistemeve të organeve të femijet. Përshkrimi, analiza dhe diskutimi i ndryshimeve që ndodhin në secilin sistem nëse ka një devijim të vlerave të parametrave brenda dhe jashtë kufijve fiziologjik. Vlerësimi në mënyrë kritike të materialit mësimor, diskutimet argumentuese dhe shprehja e mendimeve. Zbatimi i njohurive nga njësiti e përpunura për të parashikuar funksionin e pjesëve tjera. Krahasimi, ngjajshmerite dhe ndryshimet në funksionin e sistemeve |

| | | | |
|--|---|------------------|-----------------|
| | individuale te organeve. Zbatimi i rregullave te mesimit teorik dhe praktik ne zgjidhjen e problemeve specifike. | | |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | - Pas perfundimit te mesimit teorik dhe praktik, studentet i nenshtrohen provimit. Studentet duhet te posedojne njohuri te mjaftueshme per semundjet me te shpeshta te femijeve. Studentet duhet te jene te afte per sherbime te nivelit paresor dhe te jene vigjilent per referim te femijeve ne nivelin dytesor dhe tretesor. | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjerata | 2 | 30 | 60 |
| Ushtrime teorike, laboratorike | | | |
| Pune praktike | 3 | 30 | 90 |
| Kontakti me mesimdhenesi/konsultimet | | | 8 |
| Ushtrimet ne teren | - | - | - |
| Kollokviumet, seminaret | | | 2 |
| Detyra te shtepise | - | - | - |
| Koha e studimit vetanak testudentit (ne biblioteke ose ne shtepi) | | | 30 |
| Pergatitja perfundimtare per provim | | | 30 |
| Koha e kaluar ne vleresim (teste, kuiz, provim final) | | | 5 |
| Projekte prezentime etj | | | |
| Total | | | 225 |
| Metodat e mësimdhënies: | Gjate ligjeratave perdoret prezantimi me sllajde ne power point, ligjeratat jane interaktive. Ne pjesen praktike behet prane femijeve te semure me demostrim, si dhe puna laboratorike. | | |
| Metodat e vlerësimit: | Vleresimi i studentit behet me ane nenshtrimit me provim vetem nje etape. Provimi perfundimtar perbehet nga pjesa praktike dhe teorike | | |
| Literatura primare: | Mehmedali Azemi me bashautor "Pediatria" | | |
| Literatura shtesë: | Nelson textbook of Pediatrics | | |
| Hartimi i planit mësimor | | | |
| Java | Titulli i ligjëratës | | |

| | |
|-----------------|--|
| Java 1: | Pediatria sociale dhe mbrojtja shendetesore e nenes dhe femijes (Morbiditeti dhe mortaliteti i femijeve, treguesi i gjendjes shendetesore, te drejtat e femijeve ne kuader te shoqerise, psikologjia e femijeve) |
| Java 2: | I porsalinduri (aspektet fiziologjike, gjendjet patologjike, vleresimi i vitalitetit, vleresimi i moshes, reflekset |
| Java 3: | Hemato-onkologjia ne moshen femijerore (Zhvillimi dhe funksion i sistemit hemopoetike, anemite, leukemite, tumoret solide, cregullimet e hemostazes, imunodeficiencat, interpretimi i analizave laboratorike |
| Java 4: | Endokrinologjia e moshes femijrore (Diabeti melit I dhe II, gjendra mbiveshkore, |
| Java 5: | Nefrologjia e moshes femijrore (Infeksionet e traktit urinar, semundjet specifike te veshkave, nefropatite glomerulare, enureza nocturna, tubulopatite. |
| Java 6: | Gastroenterologjia (Ushqimi natural dhe artificial i femijes, ushqimi parenteral, semundje akute dhe kronike te traktit tretes, semundjet e melcise te femijet) |
| Java 7: | Principet baze te terapise elektrolitike dhe statusit acidobazik |
| Java 8: | Neurologjia e moshes femijerore (Sulmet cerebrale dhe epilepsite, anomalite e SNQ, semundjet degjenerative te trurit, iskemite dhe lendimet kraniocerebrale, ndezjet e SNQ, procedurat diagnostike, |
| Java 9: | Semundjet e traktit te frymemarrjes (Semundjet akute te traktit te siperm respirator, Pneumonite, Tuberkulozi, Bronchioliti, Bronkiti obstruktiv, Asthma, malformacionet , trupat e huaj ne traktin respirator |
| Java 10: | Semundjet e zemres dhe eneve te gjakut (Metodat diagnostifikuese, zhurmat ne zemer, anomalite ne zemer, miokarditet, cregullimet e ritmit, |
| Java 11: | Semundjet reumatizmale dhe kolagjenozat (Ethja reumatizmale , Arthriti kronik juvenil) |
| Java 12: | Gjenetika (Semundjet e trasheguara, diagnoza prenatale, antenatale dhe postnatale, semundjet kromozomale, semundjet metabolike, |
| Java 13: | Gjendjet urgjente ne pediatri |
| Java 14: | Helmimet te femijet |
| Java 15: | Terapia medikamentoze ne pediatri |

Java

Praktika Klinike

| | |
|-----------------|--|
| <i>Java 1:</i> | Anamneza dhe ekzaminimi objektiv |
| <i>Java 2:</i> | I porsalinduri |
| <i>Java 3:</i> | Semundjet e gjakut dhe organeve hematopoetike |
| <i>Java 4:</i> | Semundjet e gjendrave endokrine |
| <i>Java 5:</i> | Semundjet e traktit urinar |
| <i>Java 6:</i> | Semundjet e traktit tretes |
| <i>Java 7:</i> | Cregullimi i elektroliteve dhe statusi acido bazik |
| <i>Java 8:</i> | Semundjet e sistemit nervor dhe neuromuskular |
| <i>Java 9:</i> | Semundjet e traktit te frymemarrjes |
| <i>Java 10:</i> | Semundjet e zemres |
| <i>Java 11:</i> | Semundjet reumatizmale dhe kolagjenozat |
| <i>Java 12:</i> | Gjenetika mjekesore |
| <i>Java 13:</i> | Trajtimi i gjendjeve emergjente ne pediatri |
| <i>Java 14:</i> | Helmimet te femijet |
| <i>Java 15:</i> | Dozat terapeutike te femijet |

| Seminaret obligative | Tema |
|-----------------------------|---|
| <i>Java 1:</i> | Febriliteti te femijet |
| <i>Java 1:</i> | Ushqyerja te femijet |
| <i>Java 2:</i> | Aksidentet te femijet |
| <i>Java 2:</i> | Reanimim ne moshen femjrore |
| <i>Java 3:</i> | Diabeti melit |
| <i>Java 3:</i> | Pamjaftueshmeria e melcise |
| <i>Java 4:</i> | Hipoglikemija |
| <i>Java 4:</i> | Cregullimet e rritjes te femijet |
| <i>Java 5:</i> | Uroinfekcionet ne pediatri |
| <i>Java 5:</i> | Metodat diagnostike ne kardiologji pediatrike |
| <i>Java 6:</i> | Asthma |
| <i>Java 6:</i> | Artriti juvenil dhe diagnoza diferenciale |
| <i>Java 7:</i> | Keqtrajtimet e femijeve |

| | |
|-----------------|---|
| Java 7: | Alergjite te femijet |
| Java 8: | Ndarja e sulmeve epileptike dhe epilepsite |
| Java 8: | Sindroma e malapsorbimit |
| Java 9: | Semundjet e lindura te traktit tretes |
| Java 9: | Cregullimet elektrolitike dhe te statusit acido bazik |
| Java 10: | Diagnoza diferenciale e hematurise te femijet |
| Java 10: | Miokarditi dhe kardiomiopatie |
| Java 11: | Ushqyeshmeria e femijeve |
| Java 11: | Pamjaftueshmeria e zemres |
| Java 12: | Hiperplazioni adrenal kongjenital |
| Java 12: | Limfadenopatie |
| Java 13: | Aberacionet kromozomale |
| Java 13: | Semundjet malinje te femijet |
| Java 14: | Puberteti i hershem te femijet |
| Java 14: | Cianoza te femijet |
| Java 15: | Ketoacidoza diabetike |
| Java 15: | Konvulsionet te femijet |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*

83. GJINEKOLOGJI ME OBSTETRIKË

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë, Katedra e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës – Mjekësi e përgjithshme |
| Titulli i lëndës: | Gjinekologji dhe Obstetrikë |
| Niveli: | Mjekësi e Përgjithshme viti i V |
| Statusi i lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | V (pestë), Semestri IX dhe X |

| | |
|--|---|
| Numri i orëve në javë: | 2+0+3 |
| Kreditë ECTS: | 9 |
| Koha / Vendi: | Klinika e Gjinekologjisë me Obstetrikë/Amfiteatri dhe Repartet e Klinikës |
| Mësimdhënësi: | Prof.Ass.Dr.Vlora Ademi Ibishi , Gjinekologe Obstetër Prof.Ass.Dr.Brikene Dacaj Elshani |
| Të dhënat kontaktuese: | Prof Ass Dr Vlora Ademi Ibishi Shef I katedres Gjinekologi me Obstetrike vlora.ibishi@uni-pr.edu 044 184 766 |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda Gjinekologji me Obstetrikë përbëhet nga Gjinekologjia e cila studion traktin gjenital femëror përfshirë anatominë, fiziologjinë, proceset patologjike gjinekologjike përfshirë diagnostikën dhe trajtimin. Si dhe Obstetrika e cila studion kujdesin preconcepional shtatzaninë normale, lindja, puerperiumi dhe çrregullimet e ndërlydhura me shtatzaninë , lindjen dhe puerperiumin.. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi i lëndës Gjinekologji me Obstetrikë është të ju mundesoj studentëve njohjen e anatomisë së traktit gjenital femërorë, fiziologjisë së ciklit menstrual dhe çrregullimeve të ciklit menstrual semundjeve gjinekologjike përfshirë metodat diagnostike dhe bazat e trajtimit, shtatzaninë normale dhe patologjitë e shtatzanisë, lindjen vaginale dhe lindjen me prerje cesariane , komplikimet e mundshme në lindje dhe menaxhimin e tyre si dhe puerperiumin fiziologjik dhe patologjik. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të mësimit studenti duhet të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> 5. Përshkruaj karakteristikat themelore anatomike të traktit gjenital femëror 6. Sqaroj fiziologjinë e ciklit menstrual dhe çrregullimet e ciklit menstrual 7. Përshkruaj sëmundjet gjinekologjike, bazat e diagnostifikimit dhe menaxhimit/referimit. 8. Përshkruaj dhe demonstroj metodat e diagnostifikimit të shtatzanisë dhe kujdesin antenatal të shtatzanisë normale dhe asaj patologjike 9. Përshkruaj procesin e lindjes dhe komplikimet e mundshme në lindje. 10. Njoh dhe përshkruaj puerperiumin si fiziologjik ashtu edhe atë patologjik. <p>Studentët, njohuritë e fituara nga lënda e Gjinekologjisë me Obstetrikë do të mund t'i shfrytëzojnë në praktikë gjatë praktikës klinike</p> |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | |

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|--------------|-----------|------------|
| Ligjëratat | 2 | 30 | 60 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | 3 | 30 | 90 |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | 2.5 | 2/2 | 5 |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 40 |
| Përgatitja për provimin final | | | 28 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | 2 |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 225 |

| | |
|--------------------------------|---|
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjëratat dhe ushtrimet në grup prej 5-6 studentëve të cilat realizohen në klinikë duke përdorur mjete të ndryshme si fantoma dhe pajisje tjera për obstetrike si dhe ushtrime praktike me pacientë. |
|--------------------------------|---|

| | |
|------------------------------|--|
| Metodat e vlerësimit: | Provimi përfundimtar i cili përbëhet nga pjesa praktike dhe teorike/ 100%. |
|------------------------------|--|

| | |
|----------------------------|---|
| Literatura primare: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Obstetrika Sh.Lulaj et al. 2020 2. Obstetrika Aferdita Manaj Tirane 2014 3. Ginekologjia Simunic me Bashkepunetor 4. Clinical Obstetrics and Gynecology Brian AMagowan, Philip Owen, Andrew Thomson · 2014 5. Obstetrics and Gynecology; Charles R. B. Beckmann, Lippincott Williams & Wilkins, 2010 |
|----------------------------|---|

| | |
|---------------------------|--|
| Literatura shtesë: | Ligjëratat e pregaditura nga Prof Ass Dr Vlora Ademi Ibishi Prof Ass Dr Brikene Dacaj Elshani |
|---------------------------|--|

Hartimi i planit mësimor SEMESTRI IX

| Java | Titulli i ligjëratës |
|----------------|---|
| <i>Java 1:</i> | Hyrje në Gjinologji me Obstetrikë. Anatomia e Sistemit Gjenital Femëror/Anamneza në gjinekologji |
| <i>Java 2:</i> | Fiziologjia e ciklit menstrual, Hormonet, roli dhe përcaktimi i tyre në praktiken gjinekologjike. Ekzaminimi fizikal. |
| <i>Java 3:</i> | Gametogjeneza, frytnimi dhe implantimi. Placentacioni, fiziologjia dhe morfologjia |
| <i>Java 4:</i> | Zhvillimi morfologjik dhe funksional i embrionit dhe fetusit. Zhvillimi dhe funksioni i placentës dhe lëngut amniotik |
| <i>Java 5:</i> | Crregullimet e ciklit menstrual. Amenorrhea, Dysmenorrhea, Syndroma premenstruale |
| <i>Java 6:</i> | Endometrioza .PCOS |

| | |
|-----------------|--|
| Java 7: | Infertiliteti.Reproduksioni i asistuar |
| Java 8: | Planifikimi familjar. Kontracepcioni |
| Java 9: | Metdodat diagnostike në gjinekologji: PAP testi, Kiretazha eksplorative, Biopsia, Ultrazëri, Kolposkopia,CT dhe MRI, |
| Java 10: | Crregullimet e zhvillimit të organeve seksuale femërore.Interseksualizm.Periudhat jetesore të gruas |
| Java 11: | Menopauza |
| Java 12: | Crregullimet e statikes së organeve gjenitale |
| Java 13: | Diagnostifikimi i shtatzënisë dhe kujdesi antenatal. |
| Java 14: | Adaptimi i organizmit të gruas në shtatzani;ndryshimet endokrine dhe parakrine,hemodinamike, metabolizem,ndryshimet në organet gjenitale |
| Java 14: | Fiziologjia dhe inicimi i procesit të lindjes.Mekanizimi i lindjes normale.Fazat e lindjes.Udhëheqja bashkëho e lindjes dhe kujdesi për të porsalindurin |
| Java 15: | Crregullimet e lindjes si pasojë e crregullimeve të prezentimit, pozitës dhe rrotullimit |

| SEMESTRI X | |
|-------------------|---|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| Java 1: | Tumorët benignë të traktit gjenital femëror |
| Java 2: | Infeksionet e organeve gjenitale.PID. Lezionet prekanceroze: VIN,VaIN, CIN, Hiperplasia e endometriumi |
| Java 3: | Tumorët malignë të traktit gjenital femëror |
| Java 4: | Gjakderdhjet e crregullta nga mitra.Gjakderdhjet në premenopauzë |
| Java 5: | Abortet.Shatzania ektopike |
| Java 6: | Sëmundjet gestacionale të trofoblastit |
| Java 7: | Sëmundjet hipertenzive në shtatzani |
| Java 8: | Diabeti gestacional. |
| Java 9: | Gjakderdhjet në trimestrin e tretë të shtatzanisë |
| Java 10: | Prezentimi podalik në lindje. Lindja me WE. Lindja me Prerje cezariane |
| Java 11: | Lindja e parakohëshme.Lindja serotine |
| Java 12: | Rh izoimunizimi IUGR |
| Java 13: | Sëmundjet e zemrës, hematologjike, lëkurës, kirurgjike ,endokrine në shtatzëni. |
| Java 14: | Shtatzania multiple. Crregullimet e lëngut amniotik |
| Java 15: | Puerperiumi fiziologjik. Komplikimet në puerperium |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

84. OTORINOLARINGOLOGJIA

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Otorinolaringologjia |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti i V-rë Semestri i IX |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+3 |
| Kreditë ECTS: | 4 ECTS |
| Koha / Vendi: | AMF Dekanat |
| Mësimdhënësi: | Prof. Dr. Qazim Hysenaj |
| Të dhënat kontaktuese: | Email: qazim.hysenaj@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda në përmbajtje ka për qëllim njohjen e studenteve me lëndën e ORL-KKQ, patologjinë, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve të veshit, hundës dhe fytyrës. |
| Qëllimet e lëndës: | Zhvillimi i mësimit nga lënda e Otorinolaringologjisë Kirurgjisë së Kokës dhe Qafës sipas planit dhe programit mësimor të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë; Përgatitja e studentëve për doktor të mjekësisë, për punë praktike dhe njohuri teorike nga lënda e Otorinolaringologjisë Kirurgjisë së Kokës dhe Qafës |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <p>Përgatitja teorike, përgatitja praktike, aftësimi për të punuar vetëm dhe në ekip. Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</p> <p>Pas përfundimit të mësimit nga kjo lëndë studenti duhet të jetë në gjendje:</p> <p>Ta kuptojë përmbajtjen e lëndës së Otorinolaringologjisë Kirurgjisë së Kokës dhe Qafës;</p> <p>Të aftësohet për ekzaminimet në këtë lëmi; Të njoh ndryshimet patologjike;</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Të jetë në gjendje që të bëjë diagnostikimin e patologjive të ndryshme nga kjo lëmi;Të jetë në gjendje që për shumicën e sëmundjeve që kërkojnë trajtim konservativ të acaktojë dhe të përshkruaj terapinë adekuate;</p> <p>Të dijë, për rastet të cilat kërkojnë metoda të veçanta diagnostike dhe trajtim kirurgjik dhe përkujdesje specialistike, t'i udhëzojë në qendrat përkatëse.</p> |
|--|--|

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|--------------|-----------|------------|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | 3 | 15 | 45 |
| Konsultime me mësimdhënësin | 1 | 5 | 5 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 5 |
| Përgatitja për provimin final | | | 12 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | 3 |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 100 |

| | |
|--------------------------------|--|
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale. |
|--------------------------------|--|

| | |
|------------------------------|--|
| Metodat e vlerësimit: | Vijushmëria , testi intermediar , provimi praktik, testi dhe provimi teorik. |
|------------------------------|--|

| | |
|----------------------------|---|
| Literatura primare: | Limani A, et al: Otorinolaringologjia Kirurgjia e Kokës dhe Qafës. Pallaska.T.: Otorinolaringologjia |
|----------------------------|---|

| | |
|---------------------------|--|
| Literatura shtesë: | Ballenger J J, Snow J B.: Ballenger's Otorhinolaryngology Head and Neck Surg ISBN: 1550091972; Format: HB; Pages: 1600 Publication Date: 11 Jan 2002; Edition : 16 Cammingis : ENT Haed and neck,20011 |
|---------------------------|--|

| Hartimi i planit mësimor | |
|---------------------------------|---|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| Java 1: | <p>Ora hyrëse. Otorinolaringologjia-njohurit e përgjithshme. Anatomia dhe fiziologjia e kokës dhe qafës. Fasciet e kokës dhe qafës, Muskujt e kokës dhe qafës, Topografia e kokës dhe qafës, Arteriet dhe venat e kokës dhe qafës. Sistemi nervor i kokës dhe qafës;</p> <p>Praktika: mënyra e marrjes së anamnezës otorinolaringologjike, inspekcioni, palpacioni i kokës dhe qafës; ushtrimi i vendosjes së pasqyrës së ballit, ose kllarit, njohja me pozitën që duhet të ketë ekzaminues dhe i ekzaminuari, ushtrimi për fokusimin e dritës me pasqyrën ballore; njohja me vendin e punës së doktorit në ambulancën e kontrollit të pacientëve.</p> |
| Java 2: | <p>Indi limfatik i kokës dhe qafës, nyjat limfatike, gjëndrat pështymore, anatomia, fiziologjia, patologjia, proceset inflamatore, tumoret e indeve të buta të kokës dhe qafës, diagnostikimi dhe terapia. Disekcionet e qafës. Gjendra tiroide dhe paratiroide.</p> <p>Praktika: përcaktimi i niveleve të njave limfatike në kokë dhe qafë, inspekcioni i masave neoplazike; mënyra e ekzaminimit fizikal i gjëndrës tiroide dhe gjëndrave pështymore. Dallimi i ndryshimeve patologjike nga gjendjet normale të gjëndrës tiroide, gjëndrave pështymore dhe njave limfatike, prezantimi i rasteve.</p> |
| Java 3: | <p>Hunda. Anatomia dhe fiziologjia e hundës. Metodat diagnostikues e. Deformimet e septumit dhe piramidës së hundës. Inflammacionet e hundës, Riniti alergjik dhe vazomotorë. Polipoza e hundës. Epistaxis, trupat e huaj në hundë, Rinolitet; Ozena; Tumoret e hundës.</p> <p>Praktika: rinoskopia e përparme dhe e pasme, dallimi i pamjeve në mukozën e hundës të rastet normale dhe me procese inflamatorë, rinoskopia të rastet me hipertrofi të konkave, të rastet me poliozë të hundës. Dallimi i përmbajtjes patologjike nga sekretet fiziologjike. Dallimi i devijimeve të septumit nazal dhe frakturave të hundës në imazherit rentgenologjike. Bërja e tamponadës së përparme të hundës. Bërja dhe leximi i rinomanometrisë.</p> |
| Java 4: | <p>Hapësirat paranasale (HPN); Anatomia dhe fiziologjia; metodat diagnostikuese; Inflammacionet e sinuseve paranasale; Sinuzitet të fëmijët. Lëndimet e HPN; Fistulat oroantrale; Aerosinusitis; Komplikimet sinusogjene. Tumoret e hundës dhe HPN.</p> <p>Praktikë: karakteristikat anamnesticke të rastet me sinusit, leximi i rentgenografive klasike të sinuseve, i tomografive të kompjuterizuara dhe përshkrimi i karakteristikave imazherike të rastet pa dhe me përmbajtje në hapësirat paranasale. Bërja e tamponadës së pasme të hundës, nxjerrja e trupave të huaj nga hunda.</p> |

| | |
|----------------|---|
| Java 5: | <p>Anatomia dhe fiziologjia e hapësirës së gojës dhe orofaringut. Tumoret beninje dhe malinje të orofaringu. Malformacionet kongjenitale gojës dhe orofaringut. Manifestimet e sëmundjeve të ndryshme infektive në gojë dhe në orofaring.</p> <p>Praktika: karakteristikat anamnesticke për patologjinë e gojës dhe orofaringut, orofaringoskopia; marrja e strishos nga goja, orofaringu dhe hunda; prezantimi i rasteve me malformacione të gojës</p> |
| Java 6: | <p>Patologjia e tonsillave dhe problemi tonsillar. Tumoret malinje të nazofaringut Patologjia e hipofaringut; Anatomia dhe fiziologjia e ezofagut. Patologjia e Ezofagut, Helmimet me materie korrozive. Lëndimet mekanike të ezofagut, trupat e huaj të ezofagut. Anomalitë e lindura të ezofagut. Tumoret e ezofagut.</p> <p>Praktika: orofaringoskopia, përshkrimi i karakteristikave të bajameve normale, hipertrofike, atrofike; anginat; adenoidet hipertrofike karakteristikat e jashtme (facies adenoidea). Laring-hipofaringoskopia indirekte; laringo-faringoskopia direkte; ezofagoskopia; prezantimi irasteve me trupa të huaj në hipofaring dhe ezofag. Leximi i rentgenpasazhave të ezofagut.</p> |
| Java 7: | <p>Anatomia e veshit, Veshi i jashtëm (lapra e veshit, kanali i jashtëm auditiv). Veshi 5 mesëm (membrana timpani, zgavra timpani, kockat auditive, procesi mastoid dhe tuba e Eustakit). Veshi i brendshëm (labirinti kockor- vestibullumi, koklea dhe kanalet gjysmë rrethore kockore, labirinti membranoz- utrikuli, sakuli, duktuset gjysmë rrethore, ampullat e kanaleve gjysmë rrethore dhe duktusi koklear, organi spiral i Cort-it). Vaskularizimi dhe nervëzimi i veshit.</p> <p>Praktika: inspekcioni i veshit të jashtëm, otoskopia, dukja normale e kanalit të jashtëm të dëgjimit, pamja normale e cipës së veshit, umbo membrane timpani, stria mallearis, trigonum lucidum, cerumeni</p> |
| Java 8: | <p>Fiziologjia e dëgjimit dhe aparatit vestibular. Elementet themelore të dëgjimit. Diagnostikimi (përcaktimi) i dëgjimit, provat akumetrike, audiometria tonale, audiometria folijore, audiometria sipas Bekesy. Audiometria objektive Ekazminimi i traktit vestibulo-spinal dhe vestibulo-okulomotor. Elektronistagmografia dhe testet për ekzaminimin e sistemit të drejtpeshimit.</p> <p>Dëmtimet e dëgjimit prenatal, perinatal dhe postnatal. Dëmtimet toksike të veshit të brendshëm dhe herpes Zoster otikus.</p> <p>Aparatet ndihmëse të dëgjimit –amplifikatorët.</p> <p>Praktika: ushtrimi i përdorimit të diapazoneve akustike, bërja e provave akumetrike (testi i përcjelljes ajrore, Weber, Rhine, Schwabach), ushtrimi i përdorjes së eudiometrit dhe bërjes së audiogramave. Bërja në praktikë e testit kalorik, njohja praktike e ekzaminimit me elektronistagmografi</p> |
| Java 9: | <p>Patologjia e veshit të jashtëm. Proceset inflamatore, anomalitë e lindura, tumoret e veshit të jashtëm.</p> <p>Anatomia dhe fiziologjia e nervit facial.</p> <p>Paralizat periferike dhe qendrore të nervit facial. Diagnostikimi, klinika dhe trajtimi.</p> |

| | |
|-----------------|--|
| | <p>Praktika: prezantimi i pacientëve me cerumen obturans, me otit ekstern, marrja e anamnezës, palpimi me qëllim të diagnostikimit, dallimi i otitit ekstern difuz nga mastoiditi. Shpërlarja e kanalit të jashtëm të dëgjimit me qëllim të mënjanim të cerumenit dhe trupave të huaj. Incizioni i furunkuleve në veshin e jashtëm.</p> |
| Java 10: | <p>Patologjia e veshit të mesëm. Çrregullimet funksionale të tubës së Eustach-it. Proceset inflamatorë (otitis media secretoria, otitet akute dhe kronike), lëndimet (ruptura e membranës timpani, frakturat e kockës temporale). Komplikacionet otogjene ekzo dhe endokraniale. Otokleroza. Timpanoskleroza.</p> <p>Operacionet e veshit të mesëm, paracenteza (miryngotomia), tympanoplastika, antrotomia, mastoidektomia dhe trepanacioni radikal i kockës mastoidale.</p> <p>Implanti koklear, njohurit e përgjithshme.</p> <p>Praktika: Otokopia (dallimi i perforacioneve); karakteristikat e provave akumetrike dhe audiometrike të otitet; timpanometria; leximi i radiografisë sipas Schuller-it.</p> |
| Java 11: | <p>Patologjia e veshit të brendshëm. Syndromat kongjenitale; Proceset inflamatorë, labirintitet, neuronitis nervi vestibulares. Shurdhimet akute, kinetoza, traumat akute dhe kronike akustike, Prezbiakuza. Morbus Menier. Tumoret e veshit të brendshëm, neurinoma e nervit statoakustik.</p> <p>Praktika: leximi i audiogramëve tonale, bërja e testit kalorik dhe të tjera për vlerësimin e sistemit vestibular, testet supralimare. Përcaktimi i nistagmusit, leximi i elektronistagmogramëve, Ekzaminimet neurologjike</p> |
| Java 12: | <p>Laringu. Anatomia dhe fiziologjia e laringut. Ekzaminimet e laringut, inflamacionet akute dhe kronike të laringut. Laringjiti difterik, laringjiti subglotik dhe laringo-tracheobronchitis acuta suffocans. Perichondriti i laringut, abscesi i laringut. Ilamacionet specifike të laringut. Lëndimet e laringut.</p> <p>Praktika: laringoskopia indirekte, laringoskopia direkte, përshkrimi i pamjes normale dhe pamjeve karakteristike të proceset inflamatorë. Përshkrimi i ngjyrës të rastet inflamatorë akute dhe kronika. Karakteristikat e edemave të kordave vokale</p> |
| Java 13: | <p>Tumoret beninje të laringut dhe tumoret malinje të tij. Intubimi, punktimi i laringut, konikotomia, tirotonia, trakeotomia dhe laringektomia. Klasifikimi TNM i kancerit të laringut. Prekancerizat rehabilitimi i laringektomuarëve. Stenozat e laringut.</p> <p>Praktika: Përshkruarja e karakteristikave anamnesticke të tumoret e laringut, disfonia, dispnea, laringoskopia indirekte të rastet me tumor në laring, përcjellja e direktoskopive, laringomikroskopia. Marrja pjesë në intubimin e pacientëve, gjatë bërjes së konikotimeve, trakeotomive dhe pjesëmarrja në operacionet e tjera të laringut.</p> |
| Java 14: | <p>Trakeobronkologjia, anatomia dhe fiziologjia e trakesë dhe bronkeve, ekzaminimi i tyre, insuficienca respiratore. Trupat e huaj në rrugët e respiratore, trakeotomia dhe komplikacionet pas trakeotomisë. Trakeobronkoskopia.</p> <p>Praktika: prezantimi i rasteve me laringit subglotik; i rasteve me trupa të huaj në rrugët respiratore, përshkrimi i karakteristikave anamnesticke dhe mënyra e diagnostikimit. Marrja pjesë gjatë</p> |

| | |
|-----------------|--|
| | laringo-trakeo-bronkoskopive, marrja pjesë të rastet gjatë buzimeve. |
| Java 15: | . Lëndimet e kokës dhe qafës, lëndimet frontoetmoidale. Foniatria; Parezat dhe paralizat e laringut; Zëri dhe të folurit. Praktika: laringoskopia, indirekte, direkte, stroboskopia. Leximi i imazherive të lëndimet frontobazale; njohja me ushtrimet logopedike |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdoren gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vëllim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdoren vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

85. ORTOPIEDIA DHE TRAUMATOLOGJIA E SISTEMIT OSTEOMUSKULAR

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Ortopedia dhe traumatologjia e sistemit osteomuskular |
| Niveli: | Studimet themelore |
| Statusi i lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | Viti i V, semestri IX |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+2 |
| Kreditë ECTS: | 4 ECTS |
| Koha / Vendi: | Paradite: Salla e ligjeratave e Ortopedisë, Klinika e Ortopedisë, Sallat e operacionit të Klinikës ortopedike |
| Mësimdhënësi: | Prof. dr. Cen Bytyqi; Prof. Asoc. Dr. Faton Morina |
| Të dhënat kontaktuese: | cen.bytyqi@uni-pr.edu; faton.morina@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | <ul style="list-style-type: none"> Ky modul ka vlerë të posaçme për studentët e mjekësisë sepse e njofton studentin me lëndën e Ortopedisë dhe traumatologjisë osteomuskulare si specialitet mjekësor KIRURGJIK që merret me hulumtimin, parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe lëndimeve të sistemit osteomuskular. Lënda ndahet në mënyrë substanciale në module: Pjesa e përgjithshme dhe ajo speciale. Sëmundjet e |

| | |
|---|--|
|-------------------|---|
| Java V: | Bazat Imunologjike të grupeve të gjakut, membrana eritrocitare, reaksioni antigen antitруп, aglutinimi, hemoliza, përgjigja imune dhe rëndësia e sistemit të komplementit në mjekësinë transfuzive. |
| Java VI: | Sistemi ABO i grupeve të gjakut (antigjenet dhe antitрупat e këtij sistemi) |
| Java VII: | Testimi i parë formativ |
| Java VIII: | Sistemi Rrezus (Rh) i grupeve të gjakut antigjenet antitрупat, rëndësia dhe roli i tyre në transfuzion dhe MHN. |
| Java IX: | Sisteme të tjera antigenike të rëndësishme të grupeve të gjakut dhe rëndësia klinike e tyre në transfuzion. Sistemi Kell Sistemi Kidd/ Sistemi Duffy Fy Sistemi MNSs. |
| Java X: | Sistemi HLA, roli dhe rëndësia e tij në mjekësinë transfuzive dhe në transplantimin e indeve dhe organeve. Antigjenet dhe antitрупat trombocitare, leukocitare dhe rëndësia e tyre. |
| Java XI: | Përgatitja e komponentëve të gjakut (eritrociteve, leukociteve dhe trombociteve) dhe derivateve të plazmës (Plazmës të freskët të ngirë, krioprecipitatit, albuminave dhe imunoglobulinave) Standardizimi i komponentëve dhe kontrolli i cilësisë së tyre. |
| Java XII: | Mjekimi transfuziv me komponentet e gjakut. Indikacionet dhe kunderindikacionet. |
| Java XIII: | Testimi i dytë formativ |
| Java XIV: | Transfuzionet masive |
| Java XV: | Efekte të padëshiruara nga transfuzioni i gjakut dhe në veçanti transmetimi i sëmundjeve infektive nga transfuzioni. |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar për vijimin e mësimin teorik dhe praktik në përputhje me Statutin dhe rregulloren për studimet në Universitetin e Prishtinës. Studentët duhet t'i përmbahen edhe rregullave tjera si më poshtë:

- T'i respektojnë të drejtat e personelit akademik dhe të drejtat e studentëve të tjerë.
- T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
- Të sillen mire si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos diskredituar Universitetin.
Të respektojnë të gjitha rregullat e vendosura nga njësi akademike ku organizohet mësimi

92. Patologji Molekulare

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Patologjia Molekulare |
| Niveli: | Bazik |
| Statusi lëndës: | Elektiv |
| Viti i studimeve: | V (Semestri i IX) |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 2 |
| Koha / lokacioni: | Amfiteatër, Fakulteti i Mjekësisë |
| Mësimdhënësi i lëndës: | <p>Prof. Dr. Suzana Manxhuka-Kërliu/Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”</p> <p>Ass. Dr. Merita Hashani, PhD/Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina</p> <p>Dr. Ekrem Maloku, Neuropatolog klinik, New York University School of Medicine at New York University Langone Medical Center</p> |
| Detajet kontaktuese: | <p>Tel: +381 38 500 600 2020;</p> <p>email adresa: suzana.kerliu@uni-pr.edu</p> <p>merita.hashani@uni-pr.edu</p> <p>maloku.ekrem@gmail.com</p> |
| Përshkrimi i lëndës | <p>Identifikimi i proceseve molekulare të sëmundjes ka qenë shtytje për zhvillimin e teknikave laboratorike përmes të cilave depërtohet deri në nivelet submikroskopike të materies organike.</p> <p>Përmes këtyre teknikave identifikohen ndryshimet konformacionale dhe të ekspresionit të molekulave të shumta përgjegjëse për mirëqenjen qelizore.</p> <p>Alteracionet e gjenomit, duke filluar nga mutacionet pikësore (“point mutations”) e deri te çrregullimet numerike të kromozomeve, janë përgjegjëse për një numër të madh të patologjive jo tumorale dhe tumorale.</p> <p>Identifikimi i këtyre “ndodhive gjenetike” ka implikime kyçe në diagnostikimin, përcjelljen, skrinimin dhe trajtimin e sëmundjeve.</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>Terapia e caktuar dhe terapia individuale janë trend i ri shkencor sa i përket menaxhimit të pacientëve me sëmundje jo tumorale dhe tumorale.</p> <p>Proteinet e caktuara me funksion defekt apo të pakontrolluar “targetohen” me preparate farmaceutike të cilat i bllokojnë apo i shkatërrojnë ato në mënyrë selektive dhe specifike.</p> <p>Riparimi i materjes organike përmes metodave të ndryshme nanoteknologjike është misioni dhe vizioni i shkencës mjekësore.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | <ul style="list-style-type: none"> - Të ofrohet një pasqyrë gjithëpërfshirëse e bazës molekulare të sëmundjeve. - Të ofrohen njohuri në lidhje me teknikat laboratorike të aplikuara në patologjinë molekulare. - Të eksploroheh biomarkuesit dhe teknikat laboratorike të detektimit të: <ul style="list-style-type: none"> - ekspresionit gjenetik, modifikimeve post translacionale dhe mutacioneve - çrregullimeve kromozomale - faktorëve të ciklit qelizor - tumorëve |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Në fund të kursit, studenti do të kuptojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilët janë mekanizmat e zakonshëm molekularë të sëmundjes. - Cilat janë metodat laboratorike që i identifikojnë proceset molekulare të sëmundjes. - Cilat janë argumentet biologjike për terapinë e caktuar. |

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
|--|------------|------------------|-----------------|
| Ligjërata | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | | | 3 |
| Ushtrime në teren | / | / | / |
| Kollokfiime,seminare | 1 | 15 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | / | / | / |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | | / | 10 |

| | | | |
|---|---|--|-------------|
| Përgaditja përfundimtare për provim | | | 10 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | 2 |
| Projektet,prezentimet ,etj | | | 5 |
| Totali | | | 60 h |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Ligjërata Punë laboratorike Studime rasti Punë grupore dhe prezantime të studentëve Seminare & Punëtori Mysafirë / Instruktorë | | |
| Metodat e vlerësimit: | <i>Seminaret: 25%</i> <i>Studime rasti & Prezantime: 25%</i> <i>Punë laboratorike: 25%</i> <i>Testi final: 25%</i> | | |
| Literatura bazë: | Libra: 1. 1.Anatomia patologjike Vol. I. (Lutfi Alia, Suzana Manxhuka-Kerliu, 2009) 2. 2.Bazat Patologjike të sëmundjeve (Prof. Dr Lutfi Alia) 2020, Vol. 1, 2, 3,4. 3. 3.Robbins & Cotran Pathologic Basis of Disease, 10th (Robbins Pathology, 2020) by Vinay Kumar, Abul K. Abbas and Jon C. Aster 4. 4. WHO/IARC Classification of Tumours | | |
| Literatura shtesë: | Libra: 1. Principles of Cancer Genetics Paperback – 2018 by <u>Fred Bunz</u> 2. The Genetic Basis of Human Cancer by Bert Vogelstein, Kenneth W. Kinzler. McGraw Hill Professional, 2002 Journals: 5. Lancet Oncology, 2021 6. Cancer Journal for Clinicians, 2021 7. Nature Review Cancer, 2021 8. Journal of the National Cancer Institute, 2021 9. Cancer Research, 2021 10. Cancer Discovery, 2021 | | |
| Plani i dizajnuar i mësimit: | | | |
| Java | Ligjerata që do të zhvillohet | | |
| Java e parë: | Përbërësit kryesorë të organizmit të gjallë | | |

| | |
|-----------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Komponenta biologjike (organet, indet, qelizat, organelet) - Komponenta kimike (proteinet, lipidet, karbohidratet, acidet nukleike) |
| <i>Java e dytë:</i> | <p>ADN dhe ARN</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjenet - Bazat azotike - Enzimet restriktive - Replikimi, transkriptimi, translatimi - Modifikimet post-translacionale - Mutacionet - Sëmundjet epigjenetike |
| <i>Java e tretë:</i> | <p>Metodat e detektimit të ekspresionit gjenetik, modifikimeve post-translacionale dhe mutacioneve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sekuencionimi gjenetik - PCR, RT-PCR - Hibridizimi - Western blot - Eastern blot - Northern blot - Southern blot |
| <i>Java e katërt:</i> | <p>Aparati kromozomal</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kromozomet - Alelet - Alterimet numerike të kromozomeve - Translokacionet |

| | |
|-----------------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Delecionet - Inverzionet |
| Java e pestë: | Metodat e detektimit të çrregullimeve kromozomale <ul style="list-style-type: none"> - Kariotipi konvencional - In situ hibridizimi • Kariotipi fluorescent (chromosome painting) |
| Java e gjashtë: | Cikli qelizor <ul style="list-style-type: none"> - Faktorët e rritjes - Receptorët e faktorëve të rritjes - Sistemi tirozin kinazë - Sistemi i bartjes intranukleare të sinjalit - Protoonkogjenet - Antionkogjenet - Gjenet riparuese |
| Java e shtatë: | Metodat e detektimit të faktorëve të ciklit qelizorë <ul style="list-style-type: none"> - Imunohistokimia - ELISA - RIA - Western blot |
| Java e tetë: | Ndryshimet gjenotipike dhe fenotipike të qelizave malinje |
| Java e nëntë: | Fenotipizimi me metodën e imunohistokimisë dhe imunocitokimisë |
| Java e dhjetë: | Fenotipizimi me metodën e Flow-citometrisë |
| Java e njëmbëdhjetë: | Gjenotipizimi me metodën e in situ hibridizimit |
| Java e dymbëdhjetë: | Gjenotipizimi me metodën citogjenetike |

| | |
|------------------------------|--|
| Java e trembëdhjetë: | Gjenotipizimi me metodën e reaksionit polimerazë zingjirorë (PCR, RT-PCR) |
| Java e katërbëdhjetë: | Western blot, Eastern blot, Northern blot, Southern blot |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Markerët molekularë prognostikë dhe terapeutikë |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti gjatë semestrit duhet të jetë i rregullt në ligjërata, duhet ti përmbahet orarit të fillimit të mësimit, të ketë njohuri paraprake mbi ligjëratën, të jetë i sjellshëm dhe të mos pengojë mbajtjen e mësimit dhe të bart të gjitha obligimet që i takojnë.

93. Sëmundjet akute kirurgjike abdominale

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë, Mjekësi e përgjithshme |
| Titulli i lëndës: | Sëmundjet akute kirurgjike abdominale |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti V, semestri IX |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+0 |
| Kreditë ECTS: | 2 ECTS |
| Koha / Vendi: | Sipas orarit /ORL Amfiteater |
| Mësimdhënësi: | Prof. Dr. Rifat Latifi |
| Të dhënat kontaktuese: | Ass.dr. Astrit Hamza, sekretar i katedrës së Kirurgjisë Klinika e Kirurgjisë, Katedra e Kirurgjisë E-mail: astrit.hamza@uni-pr.edu Tel: +381385006003254 |
| Përshkrimi i lëndës: | Abdomeni akut në kuptim të ngusht të fjalës është një entitet që në vëtë përfshinë një numer të madh të sëmundjeve akute abdominale që kërkojnë tretman kirurgjik urgjent. Mirepo në kuptim më të gjërë ka raste urgjente abdominale të cilat nuk kanë nevojë për ndërhyrje kirurgjike, bile përkundrazi një shtyrje e vogël kohore dhe përcjellja e rrjedhes së sëmundjes është e preferueshme. |
| Qëllimet e lëndës: | 1. Të dëshmojë njohje të anamnezës dhe ekzaminim objektiv kirurgjik, të resepektoj rregullat themelore të sjelljes dhe punës me pacientë në klinikë, në sallën e operacionit dhe mjekimin posoperativ të pacientit. 2. Të demonstrojë njohje të parimeve dhe teknikave bazike adekuate kirurgjike, në praktikën klinike, në sallën |

| | |
|--|---|
| | <p>e operacionit, I ndihmuar dhe pa ndihmën e asistentit apo profesorit.</p> <p>3. Të dëshmojë njohje të metodave diagnostike në Kirurgjinë abdominale dhe të teknikës aseptike dhe të kuptojë parimet mikrobiologjike bazë që e mbështesin ato.</p> <p>4. Të dallojë procedurat kirurgjike sipas prirjes së tyre për t'iu nënshtruar infeksionit (të pastërta, potencialisht të kontaminuara, të kontaminuara dhe të papastërta); të kuptojë rëndësinë e këtij klasifikimi.</p> <p>5. Të jetë në gjendje të asistojë në sallën e operacionit</p> |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <p>1. Të njohë parimet bazë të ekzaminimit kirurgjik të pacientit. Të arrijë të zbatojë edhe metodat tjera ekzaminuese-diagnostikuese.</p> <p>2. Përshkruan faktorët etiologjikë dhe të rrezikut për shkaktimin e sëmundjeve kirurgjike abdominale.</p> <p>3. Krahason metodat ekzaminuese joinvazive dhe invazive si dhe kupton arsyeshmerine e zbatimit të tyre varesisht nga rasti.</p> <p>4. Fiton njohuritë themelore të nozologjisë, diagnostikimit dhe të terapisë së duhur konzervatore apo kirurgjike të pacientet me sëmundje të ndryshme kirurgjike abdominale.</p> <p>5. Fiton njohuritë themelore për organogramin e punëve klinike dhe operative për një institucion shëndetësor.</p> <p>6. Merr njohuri për mbledhjen dhe deponimin elektronik të të dhënave në dosje, dhe përdorimin e metodave statistikore për hulumtime klinike dhe shkencore.</p> |

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---------------------|------------------|-----------------|
| Ligjëratat | 2 | 1/15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | 5 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 10 |
| Përgatitja për provimin final | | | 10 |

| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | | | | | |
|---|---|--|-----------|---------------|----------------|-----|-----|
| Projektet, prezantimet, etj. | | | 5 | | | | |
| Total | | | 60 | | | | |
| Metodat e mësimdhënies: | Mësimi do të jetë i rregullt, dhe do të organizohen ligjërata grupore (dy grupime), puna klinike do të organizohet nëpër të gjitha Repartet-Klinikat e Kirurgjisë, si pjesë e ushtrimeve praktike, punë seminarike në grupe të vogla dhe zbatimi i metodologjisë së të nxënurit njohuri; mësimi i bazuar në problem (MBP). | | | | | | |
| Metodat e vlerësimit: | <p>Studjëtët do të vlerësohen për punën e tyre; me seminare, kollokiume, teste dhe provim final. Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi praktik: 40%</p> <p>Provimi final: 50%</p> <p>Total 100%</p> <table border="1" data-bbox="812 1197 1347 1312"> <thead> <tr> <th>Pjesa Teorike</th> <th>Pjesa Praktike</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>60%</td> <td>40%</td> </tr> </tbody> </table> | | | Pjesa Teorike | Pjesa Praktike | 60% | 40% |
| Pjesa Teorike | Pjesa Praktike | | | | | | |
| 60% | 40% | | | | | | |
| Literatura primare: | <ul style="list-style-type: none"> • Schein's Common Sense Emergency Abdominal Surgery, Moshe Schein, Paul N. Rogers · Ahmad Assalia (Editors) Third edition, Springer-Verlag Berlin Heidelberg 2010 • Cope's Early Diagnosis of the Acute Abdomen, 22nd edition, by William Silen. Oxford 2010 • Kirurgji. Principe dhe praktika. Volumi I dhe II. Besim Elezi dhe bashk. 2009. Tiranë • Principles and Practice of Surgery, sixth edition edited by O. James Gardon, 2012 UK • Kirurgija, Ivan Bradic i suradnici. Medicinska Naklada, 1995, Zazgreb • Prirucnik za ispite: Ivan Perpiq. Zagreb. 2005 <p>Textbook of surgery, Third Edition. Blacwell publishing, 2010.</p> | | | | | | |

| | |
|---------------------------|---|
| Literatura shtesë: | Burime nga interneti www.google.com |
|---------------------------|---|

| Hartimi i planit mësimor | |
|---------------------------------|--|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| <i>Java 1:</i> | Anatomia e peritoneumit dhe fiziologjia patologjike e dhembjes abdominale. Llojet e dhembjes abdominale Katastofat abdominal kur eshte e demtuar ndjeshmëria. Dhimbja akute abdominale te pacientet me imunitet të kompromituar. |
| <i>Java 2:</i> | Parimet e diagnozës tek sëmundjet akute abdominale. Metoda e diagnozës: Anamneza, ekzaminimi i pacientit, grupimi i simptomave dhe shenjave. Testet laboratorike dhe radiologjike. |
| <i>Java 3:</i> | Përgaditja preoperative e pacientit, Antibiotikët preoperator. Familja, Etika, Nënshkrimi i pëlqimit dhe Çështjet mjekoligjore. |
| <i>Java 4:</i> | Kolika abdominale, Apendiciti akut dhe peritonitis akut. Llojet e peritonit. Diagnoza diferenciale tek apendicitis, modalitetet e trajtimit kirurgjik. |
| <i>Java 5:</i> | Sëmundjet inflamatore të zorrëve dhe llojet e tjera të kolitit Diverticulitis i zorrës së trashë, Perforacioni i ulcers gastrike dhe duodenale. Pancreatitis akut të, Kolecistiti dhe shkaqet tjera të dhimbjes akute në kuadratin e sipërm të djathtë të abdomenit. |
| <i>Java 6:</i> | Lezionet akute abdominale me gjenezë në epigastrium dhe hypochondriumit e majtë. Obstruksioni akut i zorrëve. Invaginacioni dhe shkaqet tjera të obstruksionit |
| <i>Java 7:</i> | Urgjencat e traktit të sipërm gastrointestinal, Ruptura e ezofagut, hernia diafragmale, Ruptura diafragmale, volvulusi i lukthit, cekumit, kolonit transvers dhe sigmoid. Gjakederdhjet gastrointestinale dhe menaxhimi i tyre |
| <i>Java 8:</i> | Diagnoza e hershme e hernieve të inkarceruara dhe stranguluara. Urgjencat e kolonit dhe rektumit Komplikimet kirurgjike të endoskopisë. |
| <i>Java 9:</i> | Anastomozat intestinale. Stomat intestinale. Indikacionet dhe komplikacionet e tyre. |
| <i>Java 10:</i> | Abdomeni postoperativ. Abdomeni akut tropikal. Sëmundjet që mund të simulojnë abdomen akut. |
| <i>Java 11:</i> | Emergjencat abdominale tek foshnjët dhe fëmijët |
| <i>Java 12:</i> | Abdomeni akut me origjinë vaskulare |
| <i>Java 13:</i> | Abdomeni akut me origjinë urologjike |
| <i>Java 14:</i> | Abdomeni akut me origjinë gjinekologjike |
| <i>Java 15:</i> | Lëndimet abdominale, Trauma penetruese abdominale. Trauma e topitur abdominale, Menaxhimi operativ i lëndimeve individuale të organeve abdominale. Sindroma e kompartment abdomenit |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Studentët dhe stafi akademik duhet të jenë aktivë dhe interaktivë në mes vete, konform rregullave dhe Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Sistemit Shkollor të Bolonjës, në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira në mësimdhënje dhe mësimnxënje. Ligjeratat duhet të vijohen së paku 70%. Puna praktike duhet vijuar së paku 80%. Nëse studenti mungon më tepër se dy ushtrime, seminare ose nuk është aktiv gjatë mësimit, duhet të hyj në kolokvium. Mbrojtja e seminarit është kusht për hyrje në provim. Studenti nuk pranohet në provim pa indeks ose kartë identiteti e Studentit.

94. Ultratingulli ne Gjinekologji dhe Obstetrike

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë, Katedra e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës – Mjekësi e përgjithshme |
| Titulli i lëndës: | Ultratingulli ne Gjinekologji dhe Obstetrike |
| Niveli: | Mjekësi e Përgjithshme |
| Statusi i lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | viti i V, Semestri IX |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+0 |
| Kreditë ECTS: | 2 |
| Koha / Vendi: | Klinika e Gjinekologjisë me Obstetrikë/Amfiteatri dhe Repartet e Klinikës |
| Mësimdhënësi: | Prof.Ass.Dr.Vlora Ademi Ibishi , Gjinekologe Obstetër Prof.Ass.Dr.Brikene Dacaj Elshani |
| Të dhënat kontaktuese: | Prof Ass Dr Vlora Ademi Ibishi Shef I katedres Gjinekologji me Obstetrike vlora.ibishi@uni-pr.edu 044 184 766 |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda Ultrazeri ne Gjinekologji dhe Obstetrikë do t'ju ofroj studentëve njohuritë themelore nga fusha e diagnostikes ultrasonografike ne lemire e gjinekologjise dhe obstetrikes |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi i kesaj lende eshte te ju mundesoje studenteve te marrin njohurite bazike lidhur me fiziken dhe teknikat e aplikimit te ultrazerit ne gjinekologji dhe obstetrike, njohurite mbi ultrasonografine normale gjinekologjike dhe obstetrike, teknikat e diagnostikimit ultrasonografik te patologjive gjinekologjike dhe obstetrike, malformimet me te shpeshta fetale te diagnostikuara me ultraze, aspektet etike, siguria e aplikimit te ultrazerit, roli i ultrazerit ne raport me metodat tjera diagnostike si rezonanca magnetike. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të mësimit studentit duhet të jetë në gjendje të: 11. Përshkruaj menyren e diagnostikimit ultrasonografik ne gjinekologji dhe obstetrike |

| | |
|--|---|
| | <p>12. Te mund te detektoje organet gjenitale femerore me ultraze</p> <p>13. Te mund te detektoje pranine e embrionit dhe fetusit ne miter</p> <p>14. Te mund te detekroje disa nga patologjite fetale me te shpeshta</p> <p>15. Te fitoje njohuri lidhur me etiken e praktikimit te ultrazerit ne gjinekologji dhe obstetrike</p> <p>Studentët, njohuritë e fituara nga lënda Ultrazeri ne Gjinekologji dhe Obstetrike do të mund t'i shfrytëzojnë në praktikë gjatë praktikës klinike</p> |
|--|---|

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|--------------|-----------|-----------|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | 5 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 10 |
| Përgatitja për provimin final | | | 10 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | 5 |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 60 |

| | |
|--------------------------------|--|
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjëratat dhe ushtrimet në grup prej 5-6 studentëve të cilat realizohen ne klinikë duke përdorë mjete të ndryshme si fantoma dhe ultrazerin . |
|--------------------------------|--|

| | |
|------------------------------|---|
| Metodat e vlerësimit: | Provimi përfundimtar behet me test, 100%. |
|------------------------------|---|

| | |
|----------------------------|--|
| Literatura primare: | <p>1. Obstetrika Sh.Lulaj et al. 2020</p> <p>2.Bazat e Gjinekologjise.O Gliozheni Tirane</p> <p>3. Kurjak A, Chervenak FA. Donald School Textbook of Ultrasound in Obstetrics and Gynecology, 3rd edition. Jaypee Brothers, New Delhi, 2011.</p> <p>4. Kupesic S. Color Doppler, 3D and 4D Ultrasound in Gynecology, Infertility and Obstetrics, Jaypee Brothers, New Delhi, 2011.</p> <p>5. Ahmed B, Adra A, Nese Kavak Z. Donald School Basic Textbook of Ultrasound in Obstetrics and Gynecology, Jaypee Brothers, New Delhi, 2008.</p> |
|----------------------------|--|

| | |
|---------------------------|--|
| Literatura shtesë: | |
|---------------------------|--|

| | |
|--|---|
| | Ligjeratat e pregaditura nga Prof Ass Dr Vlora Ademi Ibishi Prof Ass Dr Brikene Dacaj Elshani |
|--|---|

Hartimi i planit mësimor SEMESTRI IX

| Java | Titulli i ligjëratisë |
|-----------------|--|
| <i>Java 1:</i> | Bazat e njohurive për funksionimin e ultrazërit |
| <i>Java 2:</i> | Njohuritë bazike lidhur me dallimin e strukturave indore përmes Ultrazërit |
| <i>Java 3:</i> | Parimet etike të përdorimit të ultrazërit në gjinekologji dhe obstetrike |
| <i>Java 4:</i> | Benefitet dhe mangësitë e përdorimit të ultrazërit në diagnostikimin e sëmundjeve gjinekologjike |
| <i>Java 5:</i> | Benefitet dhe mangësitë e përdorimit të ultrazërit në diagnostikimin e sëmundjeve gjinekologjike |
| <i>Java 6:</i> | Detektimi i strukturave normale të traktit gjeneral femëror përmes ultrazërit |
| <i>Java 7:</i> | Vizualizimi i patologjive beninje gjinekologjike me ultrazë |
| <i>Java 8:</i> | Vizualizimi i patologjive malinje gjinekologjike me ultrazë |
| <i>Java 9:</i> | Diagnostikimi i shtatzanise së hershme me ultrazë |
| <i>Java 10:</i> | Percjellja e shtatzanise normale me ultrazë |
| <i>Java 11:</i> | Detektimi i anomalive fetale me ultrazë |
| <i>Java 12:</i> | Percjellja e shtatzanive me rrezik të lartë përmes ultrazërit |
| <i>Java 13:</i> | Roli i ultrazërit në rastet emergjente |
| <i>Java 14:</i> | Përdorimi i doplerit në gjinekologji dhe obstetrike |
| <i>Java 15:</i> | Përdorimi i ultrazërit gjatë intervënimeve gjinekologjike dhe obstetrike |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdoren gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdoren vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

95. FARMAKOLOGJI DHE TOKSIKOLOGJI KLINIKE

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|-------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | FARMAKOLOGJI DHE TOKSIKOLOGJI KLINIKE |
| Niveli: | Studimet themelore |
| Statusi lëndës: | Lëndë obligative |
| Viti i studimeve: | Viti i V, semestri i X |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+1 |

| | | | |
|---|---|------------------|------------------|
| Vlera në kredi – ECTS: | 3 | | |
| Koha / lokacioni: | Sallat e Farmakologjisë | | |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. Asoc. Dr. Shaip Krasniqi, Prof. Ass. Dr. Elton Bahtiri | | |
| Detajet kontaktuese: | shaip.krasniqi@uni-pr.edu elton.bahtiri@uni-pr.edu | | |
| Përshkrimi i lëndës | Lënda “Farmakologji klinike” njofton studentët me parimet e hulumtimit klinik të barnave dhe parimet e farmakoterapisë racionale; evaluimin e efikasitetit të terapisë; interaksionet e barnave, efektet anësore të tyre dhe dimensionet në toksikologjinë klinike. | | |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Njohja me principet bazë të hulumtimit klinik të barnave dhe ilustrimi i principeve të hulumtimit klinik të grupeve specifike të barnave.</p> <p>Njohja me principet bazë të terapisë racionale dhe aplikimi praktik I principeve të terapisë racionale për konstruimin e planit të drejtë terapeutik në situatë klinike bari dhe/ose pacient specifike.</p> <p>Njohja me problemet e interaksioneve të barnave, efektet anësore të tyre dhe dimensionet në toksikologjinë klinike</p> <p>Njohja me metodologjinë e evaluimit farmakoekonomik të regjimit terapeutik.</p> <p>Njohja me principet e farmakoepidemiologjisë, duke definuar dhe përshkruar përdorimet dhe efektet e barnave në popullata të caktuara në një vend dhe kohë të caktuar.</p> | | |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Të njoh principet bazë të hulumtimit klinik të barnave</p> <p>Të njoh principet bazë të terapisë racionale dhe të aplikoj këto parime</p> <p>Të njoh metodologjinë e evaluimit të efikasitetit të terapisë</p> <p>Të njoh problemet e interaksioneve të barnave, efekteve anësore të barnave dhe të aplikoj masat adekuate me qëllim të prevenimit të tyre</p> | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjërata | 1 | 15 javë | 15 |

| | | | |
|---|---|---------|---------------|
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 javë | 15 |
| Punë praktike | - | - | - |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | - | - | - |
| Ushtrime në teren | - | - | - |
| Seminaret | 1 | 15 javë | 15 |
| Detyra të shtëpisë | - | - | - |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 15 javë | 15 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 1 | 15 javë | 15 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | - | - | - |
| Projektet, prezentimet ,etj | - | - | - |
| Totali | | | 75 orë |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Mësimi do të jetë i rregulltë, dhe do të organizohen ligjërata grupore, punë seminarike në grupe të vogla, zbatim i metodës PBL (problem-based learning), dhe në kuadër të ushtrimeve/punës praktike do të organizohen vizita nëpër Klinika për vlerësim të racionalitetit të barnave të përshkruara dhe identifikim të interaksioneve të mundshme. | | |
| Metodat e vlerësimit: | Vlerësimi i parë: 10% Vlerësimi i dytë 10% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 5% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 70% Gjithsejt 100% | | |
| Literatura | | | |
| Literatura bazë: | 1. Goodman LS, Brunton LL, Chabner B, Knollmann BC, editors. Gilman's pharmacological basis of therapeutics. 11th ed. New York: McGraw-Hill; 2014. (version i përkthyer në gjuhën shqipe). | | |

| | |
|---------------------------|---|
| | 2. Farmakologjia Klinike. G. Boçari, A. Hoxha, L. Deda, E. Grabocka, L. Kakariqi, G. Vyshka. Fakulteti i Mjekësisë, Katedra e Farmakologjisë – Universiteti i Tiranës, 2016 |
| Literatura shtesë: | 1. Rang H, Dale M, Ritter J, Flower R. Rang and Dale's Pharmacology. 6th ed. Livingston: Churchill. 2014 (version i përkthyer në gjuhën shqipe). 2. Bertram G Katzung. Basic & Clinical Pharmacology , 14 th ed., 2017 |

Plani i dizajnuar i mësimit:

| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
|------------------------------|--|
| <i>Java e parë:</i> | Njoftim me syllabusin e lëndës Hyrje në konceptet themelore të Farmakologjisë klinike dhe materialet që do të ligjërohen |
| <i>Java e dytë:</i> | Principet bazë të terapisë racionale. Konstruimi i planit të drejtë terapeutik në situatë klinike bari dhe/ose pacient specifike |
| <i>Java e tretë:</i> | Monitorimi i terapisë me barna |
| <i>Java e katërt:</i> | Efektet anësore të barnave; mënyra e përcjelljes dhe e raportimit të tyre. Sëmundjet e induktuara nga barnat |
| <i>Java e pestë:</i> | Interaksionet e barnave dhe mundësitë e kombinimeve |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Hulumtimi klinik i barnave (pjesa 1) |
| <i>Java e shtatë:</i> | Hulumtimi klinik i barnave (pjesa 2) |
| <i>Java e tetë:</i> | Vlerësimi i parë intermediar |
| <i>Java e nëntë:</i> | Farmakogjenetika dhe farmakogjenomika |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Aplikimi i barnave në shtatzani dhe laktacion |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Aplikimi i barnave në pacientët pediatrik Aplikimi i barnave në pacientët geriatrik |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Aplikimi i barnave te insuficienca renale dhe hepatike |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Vlerësimi i dytë intermediar |
| <i>Java e katërmëdhjetë:</i> | Principet farmakoekonomike. Metodologjia e evaluimit farmakoekonomik të regjimit terapeutik |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | Principet e farmakoepidemiologjisë |

Plani i dizajnuar i mësimit:

| Java | Ushtrimi që do të zhvillohet |
|------------------------------|--|
| <i>Java e parë:</i> | Sesione në grupe të vogla për zgjidhjen e problemeve klinike. |
| <i>Java e dytë:</i> | Shoku dhe terapia farmakologjike të llojet e ndryshme të shokut |
| <i>Java e tretë:</i> | Zgjidhje detyrash praktike për përpilimin dhe zbatimin e protokoleve për hulumtim klinik të barnave |
| <i>Java e katërt:</i> | Punë seminarike: Protokoli i hulumtimit klinik të barnave |
| <i>Java e pestë:</i> | Sesion i diskutimit dhe i konstruimit praktik të planit të drejtë terapeutik në situatë klinike bari dhe/ose pacient specifike më të shpeshta në praktikën klinike ose me interes të veçantë |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Sesion i diskutimit dhe përcaktimit të terapisë racionale për raste specifike klinike: raste klinike të të sëmurëve me sëmundje infektive |
| <i>Java e shtatë:</i> | Sesion i diskutimit dhe i përcaktimit të terapisë racionale për raste specifike klinike; raste klinike të të sëmurëve me sëmundje të sistemit kardiovaskular |
| <i>Java e tetë:</i> | Sesion i diskutimit dhe përcaktimit të terapisë racionale për raste specifike klinike: raste klinike të të sëmurëve me sëmundje të sistemit respirator |
| <i>Java e nëntë:</i> | Sesion i diskutimit dhe përcaktimit të terapisë racionale për raste specifike klinike: raste klinike të të sëmurëve me sëmundje të sistemit gastrointestinal |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Sesion i diskutimit dhe përcaktimit të terapisë racionale për raste specifike klinike: raste klinike të të sëmurëve me sëmundje të sistemit urogjenital dhe të rasteve gjinekologjike |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Sesion i diskutimit dhe përcaktimit të terapisë racionale për raste specifike klinike: raste klinike të të sëmurëve me sëmundje neurologjike dhe psikiatrike |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Sesion i diskutimit dhe përcaktimit të terapisë racionale për raste specifike klinike: raste klinike të të sëmurëve me sëmundje endokrinologjike dhe hematologjike |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Sesion i diskutimit dhe përcaktimit të terapisë racionale për raste specifike klinike: raste klinike të të sëmurëve me sëmundje imunologjike dhe reumatologjike. |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | Monitorimi i terapisë me barna |

| | |
|------------------------------|---|
| Java e pesëmbëdhjetë: | Metodologjia e evaluimit farmakoekonomik të regjimit terapeutik |
|------------------------------|---|

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

(1) Këshilli i njësisë akademike i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgjohen nga komisioni disiplinor i cili e këshillon këshillin e njësisë akademike. Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Senatit i cili mund të konfirmojë ose të refuzojë vendimin e këshillit të njësisë akademike.

(2) Rregulloret që i elaborojnë këto procedura nxirren nga Senati pasi të jenë konsultuar me parlamentin e studentëve.

(3) Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësiye akademike dhe njësiye organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

(4) Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësisë akademike brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.

(5) Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësisë akademike brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.

(6) Ankesa rreth vendimit në shkallë të parë vendoset nga Senati.

96. Epidemiologji

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|---|
| Njësia akademike: | Katedra e Epidemiologjisë – Mj. Përgjithshme |
| Titulli i lëndës: | Epidemiologji |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | Viti i V-të, semestri i X-të |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+2 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 3 ECTS |
| Koha / Vendi: | E Merkrure : 9.45-11.25 dhe 14.10-15.45 Amfiteatri IKSHPK |
| Mësimdhënësi: | Prof. Asoc. Dr. Naser Ramadani Prof. Asoc. Dr. Isme Humolli Prof. Asoc. Dr. Sefedin Muçaj Prof. Ass. Dr. Arijana Kalaveshi |
| Te dhënat kontaktuese: | naser.ramdani@uni-pr.edu |

| | |
|-----------------------------------|---|
| | <p>isme.humolli@uni-pr.edu</p> <p>sefedin.mucaj@uni-pr.edu</p> <p>arijana.kalaveshi@uni-pr.edu</p> <p>Konsultimet jane evidentuar publikisht në secilën hyrje të zyrës së profesorit gjegjës.</p> |
| <p>Përshkrimi i lëndës</p> | <p>Studion ligjet e përgjithshme te procesit epidemik dhe infektiv, d.m.th. ligjet themelore objektive qe janë universal për te gjitha infeksionet dhe qe kushtëzojnë shfaqjen, përhapjen dhe shuarjen e tyre. Studion karakteristikat e përgjithshme te burimit te infeksionit, rrugët e përhapjes se infeksionit, receptivitetin e popullatës si dhe vetitë dhe karakteristikat themelore te agjentit. Poashtu meret edhe me monitorimin dhe parandalimin e sëmundjet masovike kronike jo infektive etj.</p> |
| <p>Qëllimet e lëndës:</p> | <p>Qëllimi i mësimit të lëndës së epidemiologjisë, shkencës që studion dhe hulumton përhapjen e sëmundjeve, gjendjeve ose fenomeneve të lidhura ngushtë për shëndetin e një popullate të caktuar si dhe aplikimin e kësaj shkence në mbizotërimin e problemeve shëndetësore, është që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët të aftësohen në shfrytëzimin dhe interpretimin e metodave epidemiologjike në literaturën mjekësore dhe këto t'i lidhë dhe interpretojë me epidemiologjinë. • Të zhvillojë njohuritë lidhur me kuptimin e epidemiologjisë së sëmundjeve duke kuptuar metodat kryesore epidemiologjike. • Të zhvillojë parimet themelore të rëndësisë së informatës epidemiologjike në parandalimin e sëmundjeve infektive dhe semundjeve kronike joinfektive. • Të aplikojë parimet themelore të epidemiologjisë në sëmundjen specifike • Të ndërlihdë dhe praktikojë epidemiologjinë te pacienti. |

| | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Të studjojë hulumtimet epidemiologjike në artikujt shkencorë. • Diskutimi me pacientin – cila është ndërlidhja e epidemiologjisë me individin? • Të merren në konsiderim njohuritë e epidemiologjisë dhe aplikimi i tyre në praktikë në shëndetësinë publike. |
| <p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p> | <p>Nënkuptojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë që do ti fiton studenti pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi. Për ti paraqitur këto të arritura përdoren foljet si: din, njeh, përshkruan, krahason, projekton, harton, zhvillon, etj.</p> <p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</p> <p><i>Të kuptojë se Epidemiologjia është themeli i Shëndetësisë Publike.</i></p> <p><i>Njohuritë dhe çështjet që duhet të kuptohen</i></p> <p>Studentët do aftësohen të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruajnë prevalencën dhe incidencën e sëmundjeve infektive e dhe joinfektive. • Paraqesin elementet themelore të epidemiologjisë deskriptive dhe analitike të sëmundjeve infektive e dhe joinfektive. • Përshkruajnë faktorët etiologjik të sëmundjeve kronike joinfektive (SKV, Kanceri, Semundjet e sist. respirator, Diabeti etj). • Përsërisin dhe aplikojnë principet e epidemiologjisë deskriptive dhe analitike. • Përsërisin dhe aplikojnë njohuritë lidhur me modelimin e studimeve epidemiologjike. • Fillojnë të mendojnë lidhur me rolin e epidemiologjisë në programet intervenuese në shëndetësinë publike . <p><i>Shkathtësitë intelektuale</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të jenë në gjendje t'i zgjidhin problemet, t'i kuptojnë/aplikojnë metodat epidemiologjike. • Analiza e të dhënave. |

| | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Qasja logjike e të kuptuarit të epidemiologjisë së sëmundjeve. <p><i>Shkathësitë praktike profesionale</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët do të mësojnë të përdorin metodat epidemiologjike, ti zbatojnë ato varësisht nga hulumtimet që i përcaktojnë. • Analiza e të dhënave. • Aftësia për analizë kritike të një artikulli shkencor. • Nxjerrja e të dhënave kyçe nga burimet e ndryshme të të dhënave në një artikull shkencor. <p><i>Shkathësitë për transferimin e njohurive</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfshinë grumbullimin e njohurive nga burime të ndryshme: ligjërata, ushtrime, seminare, punime shkencore, historiku i sëmundjes, etj. • Aplikimi i kompjuterit. • Transmetimi i njohurive të tjerëve në grup. • Aftësitë për zgjidhjen e problemeve. • Propozimin e rekomandimeve në zgjidhjen e problemeve. • Qasje rigoroze e interpretimit të problemeve në shëndetësi. <p><i>Qëndrimet dhe sjelljet</i></p> <p>Studentët do të mësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të punojnë në grup • Të gjejnë burime të informatave shpesh për arritje të qëllimeve dhe të objektivave të caktuara. |
|--|--|

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
|--|-----|-----------|----------|
| Ligjërata | 2 | 15 javë | 30 orë |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 javë | 30 orë |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | | | |

| | | | |
|--|---|------|---------------|
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 2 | Javë | 2 orë |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | | | 5 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | | | 6 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | 2orë |
| Projektet, prezantimet ,etj | | | |
| Totali | | | 75 orë |

| | |
|--|---|
| <p>Metodologjia e mësimdhënies:</p> | <p>Mësimdhënia: do të organizohet në formë të: ligjërates, ushtrimeve dhe seminareve.</p> <p>Ligjëratat</p> <p>Ligjëratat janë dy orë në javë (në dy grupime) të cilat kryesisht mbështeten në prezentim. Pjesëmarrja aktive e studentëve është e dëshirueshme dhe e pritshme, poashtu pyetjet dhe komentet. Prezentimi i studentëve është i obliguar.</p> <p style="text-align: center;">1970 MCMLXX</p> <p><u>Ushtrimet</u></p> <p>Studentët janë të ndarë në grupe nga 6 studentë. Numri i grupeve varet nga numri i studentëve për vit. Ushtrimet janë një orë akademike për grup. Metodologjia e punës është e kombinuar: prezentim nga ana e ligjëruesve, ligjerata interaktive, punë aktive, seminare, puna ne grupe te vogla dhe detyra të shtëpisë nga ana e studentëve.</p> |
|--|---|

| | |
|--|--|
| | <p><u>Seminaret</u></p> <p>Studentët janë të obliguar që gjatë semestrit të punojnë së paku një seminar.</p> <p>Numri i seminareve caktohet në bashkëpunim me mësimmhënësit. Tema e seminarit caktohet paraprakisht varësisht nga aktualiteti dhe rëndësia e temës së paku dy javë para se të prezentohet punimi. Seminarët punohen nga grupi prej tri studentëve. Kërkohej pjesëmarrje aktive e të gjithë studentëve gjatë hartimit dhe prezentimit të punës. Studentët jo anëtarë të grupit janë të obliguar të dëgjojnë me vëmendje dhe të kontribojnë më pas me komentet, vërejtjet dhe sygjerimet e tyre. Materialet referuese dhe burimet e tyre të cilat shfrytëzohen për përgatitje të seminareve mund të jenë të nduar nduarshme. Ky është tregues i aftësisë hulumtuese të studentit. Studentët janë të obliguar të arsyetojnë punën e tyre si dhe materialin e shfrytëzuar.</p> <p><u>Rregullat e përgjithshme për seminar</u></p> <p>Je i shkurtër! I qartë dhe paraqite punën Tuaj!</p> <p><u>Puna në grupe</u></p> <p>Për t'u kuptuar esenca dhe rëndësia e thellë e epidemiologjisë është e dëshirueshme dhe preferohet puna në grupe. Grupi më së paku duhet të ketë tre studentë. Takimet e anëtarëve të grupit duhet të jenë më së paku njëherë në javë. Frekuenca e takimeve varet nga nevoja e anëtarve të grupit për të kuptuar temat e caktuara. Puna në grupe ofron mundësinë e revidimit të koncepteve të ndryshme dhe me këtë rast mundëson kursimin e kohës dhe rritjes së efikasitetit.</p> <p><u>Materiali i nevojshëm</u></p> <p>Lap top, marker, videoprojektor, transparenca, (p.sh.ligjëratë,seminar,diskutim,punë në grupe,etj)</p> |
|--|--|

| | |
|-------------------------------------|---|
| <p>Metodat e vlerësimit:</p> | <p>Vlerësimi i studentit do të bëhet përmes: vlerësimit të pjesës praktike, testit me shkrim dhe provimit teorik.</p> |
| <p>Literatura</p> | |
| <p>Literatura bazë:</p> | <p><u>Libri bazik:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Leon Gordis. Epidemiologjia, botimi i tretë në anglishtë dhe botimi i parë në shqip (përkthyer shtëpia botuese UFO Press 2009, Tiranë. - Dedushaj I., Imunoprofilaksia, FMP. Prishtinë, (2002). - Dedushaj I. EPIDEMIOLOGJIA - Parimet dhe praktika, UP. Prishtinë, (1997) - Dedushaj I., Humolli I. Epidemiologjia speciale e sëmundjeve ngjitëse – UP- Prishtinë, (2005). - Ramadani N. Epidemiologjia moderne, Prishtinë, 2006 botues IKSHPK - Ramadani N. Bioetika–Botues Shkolla Kosovare e Shëndetësisë Publike, Prishtinë 2002. - Ariana Vorko Jović, Marija Strnad, Igor Rudan. Epidemiologjia kronicnih nezaraznih bolesti. Medicinska Naklada – Zagreb, 2010. ISBN 978-975-176-480-3. (Croatia) <p><u>Librat ndihmës:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - James F. Jekel, David L. Katz, Joann G. Elmore dhe Dorothea M.G. Wild. Epidemiologji, Biostatistikë dhe Mjekësi Parandaluese, botim i lejuar nga Elsevier Inc. në gjuhën shqipe, shtëpia botuese Tabernakull, 2010. Republika e Maqedonisë - Robert B. Wallace, Neal Kohatsu. Shëndeti publik dhe mjekësia parandaluese. “Public Health and Preventive Medicine” (Përkthim shqip) - Mary-Jane Schneider. Introduction Public Health, third edition, Department of Health Policy, Managment, and Behavior School of Public Health, USA. Jones and Bartlett Publishers 2011. ISBN 0763763810, 595 pages. - Banadall E. Harris. Epidemiology of Chronic Disease, Global Perspectives, Copyright@ 2013 by Jones & Bartlett Publishers. USA 2013. ISBN 978-0-7637-8047-0. |

| | |
|----------------------------|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Roshi, E, Hyska J, Bara P, Burazeri G, Kuneshka L. “Statistika “, Tiranë, 2004 - Antony Stewart. Basic Statistics and Epidemiology. A practical guide, third edition, 2010. British Library Cataloguing in Publication Data. ISBN -13: 978 1 84619 411 5. - Emily Ferenczi i Nina Muirhead. Statistika i Epidemiologjia. Medicinska Naklada, Zagreb, 2012. - Ariana Vorko-Jovic. Prirucnik za seminare i vjezbe iz Epidemiologije. Medicinska Naklada, Zagreb, 2002. |
| Literatura shitesë: | 5. Çfarëdo literature tjetër që i përshtatet këtij syllabusi (Internet etj.) |

Plani i dizejnuar i mësimit:

| Java | Ligjerata që do të zhvillohet |
|-----------------------------|---|
| Java e parë: | Prezantimi i Sillabusit, Hyrje në Epidemiologji, Definicioni dhe Objektivat. |
| Java e dytë: | Klasifikimi i sëmundjeve infektive, lidhjet me shkencat tjera, vetit epidemiologjike të sëmundjeve infektive. Metodot epidemiologjike të studimit. |
| Java e tretë: | Monitorimi, gadishmëria, përgjigja epidemiologjike dhe kontrolla e sëmundjeve ngjitëse |
| Java e katërt: | Menaxhimi i Epidemive. Rregullativa Ndërkombetare e shëndetit (RrNSh, IHR) |
| Java e pestë: | Modelet epidemiologjike: Triasi i Gordonit, Zinxhiri i Vogralikut dhe modeli i Rrethit. |
| Java e gjashtë: | Masat Profilaktike dhe kundërepidemike, Epidemiologjia luftarake. Principet themelore të epidemiologjisë klinike. |
| Java e shtatë: | Vaksinoprofilaksa, Seroprofilaksa dhe kimioprofilaksa. |
| Java e tetë: | Përshkrimi dhe analiza e situatës epidemiologjike, izolimi, hospitalizimi dhe karantina, Dezinfektimi, dezinfektimi, deratizimi. |
| Java e nëntë: | Epidemiologjia e sëmundjeve respiratore, gastrointestinale, transmise dhe zoonozat. |
| Java e dhjetë: | Epidemiologjia e sëmundjeve vaksinë preventabile dhe SST. |
| Java e njëmbëdhjetë: | Parimet themelore të epidemiologjisë së sëmundjeve kronike – joinfektive. Shkaktaret gjenetik, identifikimi dhe monitorimi i risk faktorëve të sëmundjeve kronike joinfektive, Ambienti dhe Shëndeti. |

| | |
|------------------------------|--|
| Java e dymbëdhjetë: | Ambienti dhe sëmundjet jospecifike të sistemit respirator. Stresi dhe shëndeti, çrregullimet psikosomatike, përcaktuesit social të shëndetit dhe shprehitë e dëmshme të jetës. |
| Java e trembëdhjetë: | Epidemiologjia e sëmundjeve kardio-vaskulare, neoplazitë malinje. Fatkeqesitë, aksidentet rrugore, dhuna dhe vetevrasjet. |
| Java e katërbëdhjetë: | Epidemiologjia e çrregullimeve të sëmundjeve mendore, sëmundja e sheqerit. |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Epidemiologjia e sëmundjeve muskulo-skeletore, sëmundjet latrogjene, varësia nga drogat. |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Politika akademike dhe rregullat e mirësjelljes: mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirë sjelljes si: Mbajtja e qetësisë në mësim, ç'kyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë etj.

97. GJENETIKE MJEKESORE

| Te dhenat bazike te lendes | |
|----------------------------|---|
| Njesia akademike: | Fakulteti i Mjekesise |
| Titulli i lendes: | Gjenetika Mjekesore |
| Niveli: | Bachelor/Master |
| Statusi i lendes | Obligative |
| Viti i studimeve: | I V/ semestri i X |
| Numri i oreve ne jave: | 1+1+1 |
| Vlera ne kredi- ECTS | 3 ECTS |
| Koha /lokacioni: | Fakulteti i Mjekesise- Amfiteatri- Klinika e Pediatrie |
| Mesimdhenesi i lendes: | Prof. Assoc. Lidvana Spahiu, Prof. Ass. Naim Zeka, Prof Ass Vlora Ismaili - Jaha |
| Detajet kontaktuese: | 038 500 600 3915 |
| Pershkrimi i lendes: | Njohurite e studenteve me semundjet trasheguese (Gjenopatite, kromozomopatite, keshillimi gjenetik diagnoza prenatale) |
| Qellimet e lendes: | Studentet te fitojne njohuri per semundjet e ndryshme te trasheguarate femijet qe kane per baze mutacionet e gjeneve, anomalite numerike dhe strukture te kromozomeve, anomalite e frytit gjate zhvillimit intrauterin, diagnostifikimi i |

| | |
|------------------------------------|---|
| | semundjeve trasheguese sipas analizes se ADN-se, analizave tjera invazive dhe joinvazive, terapine gjenetike etj. |
| Rezultatet e pritura te studentit: | Pas perfundimit te mesimit teorik dhe praktik, studentet i nenshtrohen provimit. Studentet duhet te posedojne njohuri te mjaftueshme per semundjet me te shpeshta trasheguese te femijet. |

Kontributi ne ngarkesen e studentit(gje qe duhet te korrespondoj me rezultate te nxenit te studentit

| Aktiviteti | Ore | Dite/jave | Gjithsejt |
|---|-----|-----------|-----------|
| Ligjerata | 1 | 1/15 | 15 |
| Ushtrime teorike, laboratorike | - | - | - |
| Pune praktike | 1 | 1/15 | 15 |
| Kontakti me mesimdhenesi/konsultimet | - | - | - |
| Ushtrimet ne teren | - | - | - |
| Kollokviumet, seminaret | 1 | 1/15 | 15 |
| Detyra te shtepise | - | - | - |
| Koha e studimit vetanak testudentit (ne biblioteke ose ne shtepi) | 1 | 1/15 | 15 |
| Pergatitja perfundimsre per provim | 1 | 1/15 | 15 |
| Koha e kaluar ne vleresim (teste, kuiz, provim final) | - | - | - |
| Projekte prezentime etj | | | |
| Totali | | | 75 |

| | |
|-----------------------------|--|
|---------------------------------|------------------------------------|
| Njësia akademike: | Katedra e Radiologjisë MP |
| Titulli i lëndës: | Digjitalizimi në Radiologji |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi i lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | viti i V-të, semestri i 10-të; |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+0 |

| | |
|--|---|
| Kreditë ECTS: | 2 |
| Koha / Vendi: | Prof Asoc.Dr Serbeze Kabashi Muçaj, dita e marte ora 9:00-10:00 QKUK Klinika e Radiologjise Prof Ass.Dr Kreshnike Dedushi, dita e enjte ora 9:00-10:00 QKUK Klinika e Radiologjisë |
| Mësimdhënësi: | Prof.Asoc.Dr Serbeze Kabashi-Muçaj, Prof.Ass.Dr.Kreshnike Dedushi Hoti |
| Të dhënat kontaktuese: | tel. +383/48 257 554; serbeze.kabashi@uni-pr.edu tel +383/45101015: <u>kreshnike.dedushi@uni-pr.edu</u> |
| Përshkrimi i lëndës | Në rrjedhën e studimeve në fushën e mjekësisë së përgjithshme si e domosdoshme paraqitet nevoja e njohjes së: Digjitalizimit në Radiologji Prandaj është e nevojshme që studenti të marrë njohuritë elementare mbi Digjitalizimin e aparaturave Radiologjike. Ti njoh aftësitë dhe benefitet e atyre aparaturave për diagnostikimin e shpejte dhe korrekt të patologjive. Ti aplikoj metodat korrekte diagnostike digjitale për diagnostikim të shpejte dhe korrekt. |
| Qëllimet e lëndës: | Është që studenti ynë të fiton shkathhtësi në lëndën e cekur, të njoh avantazhet e digjitalizimit në radiologji Të njoh shenjat karakteristike radiologjike tek patologjitë e ndryshme <ul style="list-style-type: none"> • Të mëson bazat e mbrojtjes nga rrezet jonizuese si problem parësor në shëndetësi. • Ti din avantazhet e digjitalizimit në radiologji për diagnostikim korrekt dhe shpejt. • Më këtë nënkuptojnë njohuritë, shkathhtësitë dhe aftësitë që do t'i fiton studenti pas përfundimit të suksesëshëm të këtij lënde. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <ul style="list-style-type: none"> • Të njeh bazat e përfitimit të rrezeve jonizuese. • Te njihet me digjitalizimin modern në radiologji UZ, CT, MRI, Pet CT, Spectroskopine • Ti njihet me dozat e lejuara dhe ato letale. • Të njoftohet rreth masave mbrojtëse të pacientit, personelit dhe popullatës. |

| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
|--|--|------------------|-----------------|
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 2 | 15 javë | 30orë |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 3 | 3 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 1 | 1 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 2 | 2 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 10 | 10 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 10 | 10 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 1 | 2 | 2 |
| Projektet, prezantimet ,etj | 1 | 2 | 2 |
| Totali | | | 60 orë |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Njohuritë nga lënda: Digjitalizimit në Radiologji do të përfitohen përmes: Ligjëratave, ushtrimeve, seminareve, diskutimeve, punë në grupe sipas sistemeve. | | |
| Metodat e vlerësimit: | <p>Vlerësimi i studentit do të bëhet përmes: vlerësimit të pjesës seminarike, testit me shkrim dhe provimit teorik. Një nga mënyrat e vlerësimit mund të jetë:</p> <p>Vlerësimi i parë 5% (vlerësimi 1-5 pikë) Vlerësimi i dytë 5% (vlerësimi 1-5 pikë) Vijimi i rregulltë 5 % (vlerësimi 1-5 pikë) Puna seminarike 35% <u>Provimi final</u> 50 % Gjithsejt 100% (100 pikë maksimum)</p> <p>Kriteret e vlerësimit: Mbi 51%, student kalon</p> | | |

| | |
|---------------------------------|--|
| | 51-60% - Nota 6 61-70% - Nota 7 71- 80%- Nota 8 81-90%- Nota 9 91-100%- Nota 10 |
| Literatura | |
| Literatura primare: | 29. Strife B. Vascular and Interventional Radiology 30. Therapy Response Imaging in Oncology 31. Diagnostic Imaging- Interventional Procedures (second edition) 32. McGraw K, Interventional Radiology of the Spine 33. Watkinson L, Interventional Neuroradiology 34. Dershaw D, Imaging-guided interventional breast techniques 35. Ligjeratat e mbajtura ne klase |
| Literatura shitesë: | 6. Çfarëdo literature tjetër që i përshtatet këtij syllabusi (Internet etj.) |
| Hartimi i planit mësimor | |
| Java | Titulli i ligjëratës |
| Java e 1: | Njohja me lëndën digjitalizimi ne radiologji |
| Java e 2: | Fizika Radiologjike e gjitha metodave radiologjike digjitale. |
| Java e 3: | Radiografia konveksionale versus digjitale |
| Java e 4: | Flourosopia roli i saj ne diagnostikimin e gypit digjestiv |
| Java e 5: | Ultrasonografia roli i saj ne diagnostikimin e organeve parenkimale |
| Java e 6: | Echo Doppler metode per diagnostikim e vazave te gjakut |
| Java e 7: | Tomografia e Kompjuterizuar, metode specifike ne diagnostikim e Kockave dhe Kafazit te kraherorit. |
| Java e 8: | CT enterografia dhe MRI enterografia ne evaluimin e gypit digjestiv metode me e avansuar jo invazive |
| Java e 9: | CT tek urgjencat osteomuskulare |
| Java e 10: | CT tek urgjencat kraniale |
| Java e 11: | <u>Roli i MRI ne diagnostikim e shpejte te infarktimit truror</u> |

| | |
|-------------------|--|
| Java e 12: | Roli i spectrografise te diagnostikimi i patologjive te ndryshme truore |
| Java e 13: | <u>Roli i Pet CT ne diagnostikimin e metastazave</u> |
| Java e 14: | Mamografia si metode per diagnostikimin e patologjive te gjirit |
| Java e 15: | Urografia intravenoze dhe CT urografia, metode specifike ne diagnostikimin e patologjive te SUGJ |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Politika akademike dhe rregullat e mirësjellsjelljes: mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirë sjelljes si: Mbajtja e qetësisë në mësim, ç'kyçja e telefonave celular, hyrja në sall me kohë etj.

105. Ultratingulli në Ortopedi

| Course Basic Information | |
|------------------------------------|---|
| Academic Unit: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Course title: | Ultratingulli ne Ortopedi |
| Level: | Graduate studies |
| Course Status: | Elektive |
| Year of Study: | Viti V , semestri X |
| Number of Classes per Week: | 1+1+0 |
| ECTS Credits: | 2 |
| Time /Location: | Paradite/ Klinika Ortopedike, Fakulteti i Mjekësisë, Ambulanca specialitike. |
| Mesimdhënesit: | Prof. dr. Cen Bytyqi; Prof. Assoc. dr. Faton Morina |
| Detajet e kontaktit: | cen.bytyqi@uni-pr.edu faton.morina@uni-pr.edu |
| Pershkrimi i lendes: | <p>Studenti do të zotërojë parimet e përgjithshme dhe të veçanta në aplikimin e ultrazërit në Ortopedi. Përparimet në teknologjinë e ultrazërit dhe zhvillimi i sondave me rezolucion të lartë (këmbyesit) vitet e fundit kanë mundësuar ultrazërit të bëhet metoda e zgjedhjes së parë në vlerësimin fillestar të sëmundjeve dhe dëmtimeve të sistemit osteomuskular.</p> <p>Ky kurs synon të informojë studentët se aplikimi kryesor i ultrazërit në sistemin osteomuskular është në vlerësimin e sëmundjeve dhe dëmtimeve të indeve të buta si dhe vizualizimin e kërcit artikular në sipërfaqen e kockave.</p> <p>Studenti do të informohet për avantazhet e ultrazërit në krahasim me metodat e tjera; ultrazëri është një metodë jo invazive, koha e ekzaminimit është më e shkurtër,</p> |

| | |
|--------------------------------|---|
| | <p>zbatohet lehtësisht, mund të përsëritet, nuk ka rrezatim jonizues dhe është i lirë.</p> <p>Në pjesën praktike studenti do të përfshihet aktivisht në kabinetin e ultrazërit në ekzaminimin e sëmundjeve dhe dëmtimeve të sistemit osteomuskular të fëmijëve dhe të rriturve. Fokus i veçantë do të jetë në zbulimin e hershëm të Çrregullimit të Zhvillimit të kerdhokullave(CZHK).</p> |
| Qellimet e lendes: | <p>Me përfundimin e kësaj lënde studentët do të përvetësojnë njohuritë ne:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rëndësinë e ultratingullit në diagnostikën e sëmundjeve dhe lëndimeve të sistemit osteomuskular. • Fizikën e ultratingullit. • Rolin e ultratingullit në diagnostikën e ÇZHK si dhe gjendjeve tjera të kerdhokullës.. • Ultratingullin e lëndimeve dhe sëmundjeve të anësive të sipërme. • Ultratingullin lëndimeve dhe sëmundjeve të anësive të poshtme • Ultratingullin e lëndimeve sportive. |
| Pritjet dhe rezultatet: | <p>Me përfundimin e kësaj lënde studentët do të përvetësojnë njohuritë ne:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rëndësinë e ultratingullit në diagnostikën e sëmundjeve dhe lëndimeve të sistemit osteomuskular. • Fizikën e ultratingullit. • Rolin e ultratingullit në diagnostikën e ÇZHK si dhe gjendjeve tjera të kerdhokullës.. • Ultratingullin e lëndimeve dhe sëmundjeve të anësive të sipërme. • Ultratingullin lëndimeve dhe sëmundjeve të anësive të poshtme • Ultratingullin e lëndimeve sportive. |
| | |

| Semestri Dimëror- | | | |
|---|--|-------------|-----------------|
| Aktiviteti | Orë | Javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime praktike në kabinetin e ultratingullit | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin | 1 | 3 | 3 |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 15 | 15 |
| Koha e studimit vetanak | | | 15 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 1 | 15 | 10 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | 2 |
| Totali | | | 60 |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Organizimi i mëimit teorik dhe praktik (me metoda bashkëkohore ndërvepruese; punë seminarike në grupe të vogla). | | |

| | |
|--|--|
| Metodat e vlerësimit: | Vlerësimi i parë: 10% Vlerësimi i dytë 10% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 5% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 70% Gjithsej 100% |
| Literatura | |
| Literatura bazë: | <ul style="list-style-type: none"> ▪ C Bytyqi. Ultratingulli në diagnostikën e lëndimeve dhe sëmundjeve të sistemit osteomuskular. Dispenca. 2012, Prishtinë ▪ S Pillen. Skeletal muscle ultrasound European Journal Translational Myology 2010; 1 (4): 145-155 ▪ R Graf. Fundamentals of sonographic diagnosis of infant hip dysplasia. JPO 1984;4 (6): 735-740. ▪ R Graf. Hip Sonography: Diagnosis and Management of Infant Hip. 2006. ▪ HT Harcke. Hip ultrasonography in clinical practice. Pediatric radiology. 2017; 47 (9): 1155-1159 |
| Literatura shtesë: | <ul style="list-style-type: none"> • Musculoskeletal ultrasound: technical guidelines. Edited by The Ultrasound Subcommittee of the European Society of Musculoskeletal Radiology (ESSR) Insights Imaging DOI 10.1007/s13244-010-0032-9 (2010) 1:99–141. • John m O'Neill, Musculoskeletal ultrasound: Anatomy and technique. January 2008. DOI: 10.1007/978-0-387-7661. |
| Plani i dizajnuar i mësimi: | |
| Java I: | Hyrje në Ultrasonografinë e sistemit Osteomuskular. |
| Java II: | Vendi i ultratingullit në diagnostikën e lëndimeve dhe sëmundjeve të sistemit osteomuskular. |
| Java III: | Bazat e fizikës së ultratingullit. |
| Java IV: | Akordimi i pajisjeve ultrasonografike dhe mënyra e përdorimit. |
| Java V: | Ultratingulli në diagnostikën e çrregullimit zhvillimor të kërdhokullave. |
| Java VI: | Ultratingulli në diagnostikën e synovinit tranzitor të kërdhokullës. |
| Java VII: | Testimi i formative |
| Java VIII: | Ekzaminimi ekografik i krahut. |
| Java IX: | Diagnostika ultrasonografike e brrylit. |
| Java X: | Diagnostika ultrasonografike e nyjës radiokarpale dhe shuplakës. |
| Java XI: | Diagnostika ultrasonografike e lëndimeve sportive. |
| Java XII: | Diagnostika ultrasonografike e kolonës vertebrale. |
| Java XIII: | Testimi sumativ |
| Java XIV: | Diagnostika ultrasonografike e gjurit. |
| Java XV: | Diagnostika ultrasonografike e nyjës talokrurale dhe shputës. |
| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: | |

- (1) Këshilli i njësisë akademike i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgohen nga komisioni disiplinor i cili e këshillon këshillin e njësisë akademike. Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Senatit i cili mund të konfirmojë ose të refuzojë vendimin e këshillit të njësisë akademike.
- (2) Rregulloret që i elaborojnë këto procedura nxirren nga Senati pasi të jenë konsultuar me parlamentin e studentëve.
- (3) Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësive akademike dhe njësive organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.
- (4) Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësisë akademike brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.
- (5) Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësisë akademike brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.
- (6) Ankesa rreth vendimit në shkallë të parë vendoset nga Senati.

106. Procedurat endoskopike dhe laparoskopike ne praktiken klinike

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë, Mjekësi e përgjithshme |
| Titulli i lëndës: | Procedurat endoskopike dhe laparoskopike ne praktikën klinike |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | Lende zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti i V, semestri X |
| Numri i orëve në javë: | 2+0+0 |
| Kreditë ECTS: | 2 ECTS |
| Koha / Vendi: | Sipas orarit /ORL Amfiteater |
| Mësimdhënësi: | Prof. Dr. Rifat Latifi |
| Të dhënat kontaktuese: | Ass.dr. Astrit Hamza, sekretari katedrës së Kirurgjisë Klinika e Kirurgjisë, Katedra e Kirurgjisë E-mail: astrit.hamza@uni-pr.edu Tel: +381385006003254 |
| Përshkrimi i lëndës: | Procedurat endoskopike dhe kirurgjia laparoskopike janë teknika te reja klinike dhe kirurgjike, te cilat mundesojnë aplikimin e procedurave minimave invazive. Sot, keto teknika kanë rol dhe vend te rëndesishem ne kirurgji, ngase shume intervenime kirurgjike, qe me pare jane trajtuar ne menyre konvencionale, aktualisht jane zëvendësuar ne menyre te suksesshme permes ketyre metodave minimale invazive. Aplikimi i ketyre metodave ka rëndesi evidente per pacientin, ngase ata kursehen nga incizionet klasike laparotomike, zvogelohet koha e hospitalizimit te tyre dhe |

| | |
|--|---|
| | shoqerohen me redukim te komplikimeve pasoperatore krahasuar me metodat konvencionale. |
| Qëllimet e lëndës: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Te demonstroje njohje te teknikave minimale invazive dhe intervenimeve laparoskopike, ngase keto jane procedura dhe teknika te reja kirurgjike. 2. Të demonstrojë njohje të indikacioneve per procedurat minimale invazive dhe menyres se realizimit te tyre 3. Të dëshmojë njohje per mundesite e numerta te kirurgjisë minimale invazive. 4. Te demonstrojë njohuri per perpresite e ketyre teknikave te reja minimale invazive. 5. Të jetë në gjendje të asistojë në sallën e operacionit |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Fiton njohuri bazë per instrumentet dhe pajisjet perkatese qe shfrytezohen ne kuader te teknikave minimale invazive 2. Fiton njohuri baze per menyren e realizimit te teknikave minimale invazive 3. Fiton njohuri baze per perpresite e ketyre metodave minimale invazive krahasuar me metodat konvencionale. 4. Fiton njohuritë themelore për organogramin e puneve klinike dhe metodave minimale invazive për një institucion shëndetesor. 6. Merr njohuri për mbledhjen dhe deponimin elektronik të të dhënave në dosje, dhe përdorimin e metodave statistikore për hulumtime klinike dhe shkencore. |

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---------------------|------------------|-----------------|
| Ligjëratat | 2 | 1/15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | 3 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 10 |
| Përgatitja për provimin final | | | 15 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | 2 |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 60 |

| Metodat e mësimdhënies: | Mësimi do të jetë i rregullt, dhe do të organizohen ligjërata grupore (dy grupime), punë seminarike në grupe të vogla dhe zbatimi i metodologjisë së të nxënurit njohuri; mësimi i bazuar në problem (MBP). | | | | |
|---------------------------------|--|---------------|----------------|-----|-----|
| Metodat e vlerësimit: | <p>Studëntët do të vlerësohen për punën e tyre; me seminare, kollokiume, teste dhe provim final. Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi praktik: 40%</p> <p>Provimi final: 50%</p> <p>Total 100%</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Pjesa Teorike</th> <th>Pjesa Praktike</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">60%</td> <td style="text-align: center;">40%</td> </tr> </tbody> </table> | Pjesa Teorike | Pjesa Praktike | 60% | 40% |
| Pjesa Teorike | Pjesa Praktike | | | | |
| 60% | 40% | | | | |
| Literatura primare: | <p>Cotton BP, Williams BCH, Hawes RH, Saunders BP. Practical Gastrointestinal Endoscopy: The Fundamentals, 6th Edition, 2008</p> <p>Milsom JW, Bohm B, Nakajima K. Laparoscopic colorectal surgery, 2nd Edition, 2006</p> | | | | |
| Literatura shtesë: | Burime nga interneti www.google.com | | | | |
| Hartimi i planit mësimor | | | | | |
| Java | Titulli i ligjëratisë | | | | |
| <i>Java 1:</i> | Zhvillimi dhe te arriturat ne endoskopi, laparoskopji dhe kirurgji laparoskopike | | | | |
| <i>Java 2:</i> | Definicioni i kirurgjise laparoskopike, perparesite dhe mangesite, Instrumentet dhe pajisjet ne endoskopi dhe laparoskopji | | | | |
| <i>Java 3:</i> | Instrumentet dhe pajisjet ne endoskopi dhe laparoskopji | | | | |
| <i>Java 4:</i> | Laparoskopia urgjente dhe elektive diagnostike | | | | |
| <i>Java 5:</i> | Anestezioni ne kirurgjine laparoskopike | | | | |
| <i>Java 6:</i> | Pergatitja dhe selektimi i pacienteve per trajtim me metodat minimale invazive | | | | |
| <i>Java 7:</i> | Pozicioni i ekipes kirurgjike, pacientit dhe instrumenteve gjate procedurave minimale invazive | | | | |

| | |
|-----------------|--|
| Java 8: | Endoskopia ne urologji, pajisjet, metodat, perparosite dhe mangesite |
| Java 9: | Endoskopia dhe kirurgjia laparoskopike ne kirurgjine e femijeve |
| Java 10: | Metodat endoskopike diagnostike dhe terapeutike ne kirurgjine vaskulare |
| Java 11: | Endoskopia dhe kirurgjia minimale invazive ne kirurgjine torakale (torakoskopia) |
| Java 12: | Metodat minimale invazive ne neurokirurgji, parparosite dhe mangesite |
| Java 13: | Pergatitja dhe selektimi i pacienteve per trajtim me metodat minimale invazive |
| Java 14: | Trauma kirurgjike te metodat minimale invazive, Reaksioni neuro-endokrin, ndryshimet imunologjike dhe hematologjike |
| Java 15: | Principet themelore te hemostazes, qepjes, ligimit dhe ekstarahimit te preparateve gjate trajtimit me metoda minimale invazive |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Studentët dhe stafi akademik duhet të jenë aktivë dhe interaktivë në mes vete, konform rregullave dhe Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Sistemit Shkollor të Bolonjës, në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira në mësimdhënie dhe mësimnxënje. Ligjeratat duhet të vijohen së paku 70%. Puna praktike duhet vijuar së paku 80%. Nëse studenti mungon më tepër se dy ushtrime, seminare ose nuk është aktiv gjatë mësimit, duhet të hyj në kolokvium. Mbrojtja e seminarit është kusht për hyrje në provim. Studenti nuk pranohet në provim pa indeks ose kartë identiteti e Studentit.

107. PROJEKTI SHKENCOR

Informatat themelore për lëndën

| | |
|-------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë/ Katedra e Mjekësisë sociale me Statistike mjekësore, Mjekësi Familjare dhe Mjekësi e Punës |
| Titulli i lëndës: | Projekti Shkencor |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti i V-të Semestri i X-të |
| Numri i orëve në javë: | 1+1+0 |
| Kreditë ECTS: | 2 ECTS |
| Koha / Vendi: | Klasa Sipas orarit |
| Mësimdhënësi: | Prof. Ass. dr Rina Hoxha rina.hoxha@uni-pr.edu |
| Të dhënat kontaktuese: | IKSHPK, nr.12/ 038 551 431 208/ Kosnultimet me Profesor mbahen të Premten në IKSHPK prej ores 8:00-9:00 |

| | |
|--|---|
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda e Projektit shkencor t'u japë studentëve njohuri për të shkruar dhe një mundësi për të punuar me një projekt kërkimor brenda fushës së Stomatologjisë në mënyrë të pavarur. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi i lëndës është aftësimi i studentëve për të shkruar një projekt kërkimor brenda fushës së stomatologjisë në mënyrë të pavarur. Studentët do të fitojnë aftësi të mira për punë të pavarur dhe aftësi në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në projekte jo laboratorike dhe laboratorike dhe për të shkruar dhe planifikuar një projekt shkencor në formën e një projekt propozimit kërkimor. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <ul style="list-style-type: none"> -Aftësojë studentët në planifikimin e pavarur të hulumtimit dhe mënyrën e shkruarjes së projektit shkencor -Aftësi për identifikimin e problemit të hulumtimit dhe krijon elementet kryesore të një projekt propozimi kërkimor. -Demonstron aftësinë për të kryer rishikime të literaturës dhe për të mbledhur informacionin kritik shkencor në lidhje me propozimin e hulumtimit. -Të lexojë literaturë shkencore me rëndësi për projektin dhe arsyeshmerinë e projektit dhe të shkruajë një projekt propozim kërkimor bazuar në literaturën e shfletuar. -Të mbledhë të dhëna për vlerësim dhe trajtim të një projekti shkencor. -Të tregojë pavarësi, mendim kritik dhe krijues në një projekt shkencor. -Të jetë në gjendje të formulojë pyetje të reja shkencore në lidhje me projektin hulumtues. -Të vlerësojë planifikimin real të kohës, bashkëpunimit dhe lidhjes midis njohurive teorike dhe praktike. -Të aplikojë dhe trajtojë në mënyrë korrekte çështjet etike në projektin shkencor. Përshkruani konceptet dhe parimet themelore të sjelljes së keqe shkencore dhe plagjiaturës |

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---------------------|------------------|-----------------|
| Ligjëratat | 1 | 15 | 15 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Konsultime me mësuesin | 1 | 3 | 3 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | 1 | 15 | 15 |
| Detyrë shtëpie | | | 10 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 10 |
| Përgatitja për provimin final | | | 4 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | 3 |
| Total | | | 60 |

| | |
|------------------------------|--|
| Metodat e mësimeve: | Ligjëratat, seminarët gjatë orëve të mësimit duke përdorë punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale. |
| Metodat e vlerësimit: | Ligjëratat dhe seminarët - Hulmimi i çështjeve të ndryshme stomatologjike për projekte hulumtuese përmes shfletimit të burimeve në internetit - Detyra me shkrim në formë të projekteve të shkruara nga ana e tyre (studenteve) - Vijimi i rregullt: 10% - Projekti i shkruar: 30% - Projekti i prezantuar: 10% - Provimi final: 50% Total 100% |
| Literatura primare: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Konceptet e ligjerimeve 2. Matthews B, Ross L. Metodat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. CDE. 2010. 3. Leed P.D and Ormrod J.E., Practical research: Planning and Design, 7th Edition. 2001 4. Charles H. Hennekens, Julie E. Buring. Epidemiologjia në Mjekësi. Tiranë: Libri Universitar, 1998 |
| Literatura shtesë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. file:///C:/Users/User/Downloads/HOW_TO_WRITE_A_RESEARCH_PROPOSAL.pdf 2. World Health Organization. Health Research Methodology: A Guide for Training in Research Methods (2nd Edition), 2001. file:///C:/Users/User/Downloads/929061157X_eng.pdf |

Hartimi i planit mësues

| Java | Titulli i ligjëratës |
|-----------------|---|
| Java 1: | Hyrje në konceptet themelore dhe materialet që do të ligjërohen; prezantimi i syllabusit të Projektit shkencor. |
| Java 2: | Konceptet themelore të kërkimit dhe rëndësia e projekteve shkencore |
| Java 3: | Ideja fillestare (duke bërë një pyetje kërkimore) Formulimi i pyetjes kërkimore |
| Java 4: | Kërkimi dhe shqyrtimi i literaturës në internet dhe dokumenteve egzistuese |
| Java 5: | Ridefinimi i pyetjes kërkimore shkruarja e hipotezave pas shfletimit të literaturës |
| Java 6: | Planifikimi i projektit (Fazat e planifikimit të Projektit -Gantogrami) |
| Java 7: | Shkrimi i protokollit të studimit dhe pjesët e protokollit |
| Java 8: | Hyrja dhe arsyeshmëria e një projekti hulumtues |
| Java 9: | Marrja e miratimit Etik dhe institucionet implementuese të projekti |
| Java 10: | Resurset e projektit dhe buxheti |
| Java 11: | Pilotimi i metodologjisë dhe menaxhimi i projektit (Mbledhja e të dhënave, zhvillimi dhe testimi i instrumenteve të mbledhjes, përpilimi i pyetsoreve dhe pilotimi) |
| Java 12: | Analizimi i të dhënave |
| Java 13: | Shkrimi dhe shpërndarja e rezultateve, metodat e regjistrimit të literaturës |
| Java 14: | Prezantimi i projekteve dhe diskutimi për projektet e realizuara |
| Java 15: | Rekapitullimi i lëndës dhe prezantimi i projekteve |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse detyra e dhënë nga ana e profesorit nuk realizohen nga ana e studentit dhe poashtu vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

108. Pediatria

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekesise |
| Titulli i lëndës: | Pediatria |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti i - VI të Semestri i XI |
| Numri i orëve në javë: | 5 ditë (3+0+5) |
| Kreditë ECTS: | 2 |
| Koha / Vendi: | Fakulteti i Mjekesise- Amfiteatri- Klinika e Pediatrise |
| Mësimdhënësi: | Prof. Assoc. Lidvana Spahiu, Prof. Ass. Naim Zeka, Prof Ass Vlora Ismaili - Jaha |
| Të dhënat kontaktuese: | 038 500 600 3915 |
| Përshkrimi i lëndës: | Njohurite e studenteve me semundjet e femijeve sipas sistemeve dhe kujdesit paresor, dytesor dhe tretesor te femijeve. |
| Qëllimet e lëndës: | Studentet te fitojne njohuri per semundjet e ndryshme te femijeve ne periudha te ndryshme te femijerise. Metodot diagnostike, gjetjet laboratorike, ekzaminimet plotesuese dhe mjekimin e tyre. Identifikimi, pershkrimi dhe shpjegimi i tipareve me te rendesishme te rritjes dhe zhvillimit te femijes, semundjet e sistemit neuromuskular, kardiovaskular, te frymemmarjes, renal, gastrointestinal dhe endokrine ne nivelin e qelizave te organeve dhe te gjithë organizimin. Te njohin simptomet klinike te semundjeve te sistemeve te organeve te femijet. Pershkrimi, analiza dhe diskutimi i ndryshimeve qe ndodhin ne secilin sistem nese ka nje devijim te vlerave te parametrave brenda dhe jashte kufijeve fiziologjik. Vleresimi ne menyre kritikei materialit mesimor, diskutimet argumentuese dhe shprehja e mendimeve. Zbatimi i njohurive nga njesit e perpunaora per te parashikuar funksionin e pjeseve tjera. Krahasimi , ngjajshmerite dhe ndryshimet ne funksionin e sistemeve |

| | | | |
|--|---|------------------|-----------------|
| | individuale te organeve. Zbatimi i rregullave te mesimit teorik dhe praktik ne zgjidhjen e problemeve specifike. | | |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | - Pas perfundimit te mesimit teorik dhe praktik, studentet i nenshtrohen provimit. Studentet duhet te posedojne njohuri te mjaftueshme per semundjet me te shpeshta te femijeve. Studentet duhet te jene te afte per sherbime te nivelit paresor dhe te jene vigjilent per referim te femijeve ne nivelin dytesor dhe tretesor. | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjerata | 3 | 5 ditë | 15 |
| Ushtrime teorike, laboratorike | | | |
| Pune praktike | 5 | 5 ditë | 25 |
| Kontakti me mesimdhenesi/konsultimet | | | |
| Ushtrimet ne teren | | | |
| Kollokviumet, seminaret | | | |
| Detyra te shtepise | | | |
| Koha e studimit vetanak testudentit (ne biblioteke ose ne shtepi) | | | 10 |
| Pergatitja perfundimtare per provim | | | |
| Koha e kaluar ne vleresim (teste, kuiz, provim final) | | | |
| Projekte prezentime etj | | | |
| Total | | | 50 |
| Metodat e mësimdhënies: | Gjate ligjeratave perdoret prezantimi me sllajde ne power point, ligjeratat jane interaktive. Ne pjesen praktike behet prane femijeve te semure me demostrim, si dhe puna laboratorike. | | |
| Metodat e vlerësimit: | <i>Pjesëmarrja aktive 40%</i> <i>Përfundimi i portfolios 60%</i> <i>Përfundimi i këtij moduli kontribuon (me proporcion) në arritjen e 4 ECTS për grupin e lëndëve të parapara në planprogram</i> | | |
| Literatura primare: | Mehmedali Azemi me bashautor “Pediatria” | | |
| Literatura shtesë: | Nelson textbook of Pediatrics | | |

| Hartimi i planit mësimor | |
|---------------------------------|--|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| <i>Java 1:</i> | Emergjencia pediatrike |
| <i>Java 2:</i> | I porsalinduri (aspektet fiziologjike, gjendjet patologjike, vleresimi i vitalitetit, vleresimi i moshës, refleksët dhe reanimimi) |
| <i>Java 3:</i> | Rritja dhe zhvillimi i femiut |
| <i>Java 4:</i> | Ushqyerja natyrale dhe përgatitja e ushqimit plotësues |
| <i>Java 5:</i> | Semundjet e traktit gastrointestinal |
| <i>Java 6:</i> | Semundjet e traktit hepato-biliar |
| <i>Java 7:</i> | Semundjet e sistemit hematopoetik |
| <i>Java 8:</i> | Onkologjia pediatrike |
| <i>Java 9:</i> | Semundjet e sistemit kardiovaskular |
| <i>Java 10:</i> | Semundjet e traktit respirator |
| <i>Java 11:</i> | Semundjet e traktit urojenital |
| <i>Java 12:</i> | Semundjet e sistemit endokrinologjik |
| <i>Java 13:</i> | Semundjet e sistemit neuromuskular |
| <i>Java 14:</i> | Helmimet të fëmijet |
| <i>Java 15:</i> | Terapia medikamentozë në pediatri |

| Java | Praktika Klinike |
|-----------------|--|
| <i>Java 1:</i> | Anamneza dhe ekzaminimi objektiv |
| <i>Java 2:</i> | I porsalinduri |
| <i>Java 3:</i> | Semundjet e gjakut dhe organeve hematopoetike |
| <i>Java 4:</i> | Semundjet e gjendrave endokrine |
| <i>Java 5:</i> | Semundjet e traktit urinar |
| <i>Java 6:</i> | Semundjet e traktit tretës |
| <i>Java 7:</i> | Çregullimi i elektrolitëve dhe statusi acido bazik |
| <i>Java 8:</i> | Semundjet e sistemit nervor dhe neuromuskular |
| <i>Java 9:</i> | Semundjet e traktit të frymëmarrjes |
| <i>Java 10:</i> | Semundjet e zemrës |
| <i>Java 11:</i> | Semundjet reumatizmale dhe kolagjenozat |

| | |
|-----------------|---|
| <i>Java 12:</i> | Gjenetika mjekesore |
| <i>Java 13:</i> | Trajtimi i gjendjeve emergjente ne pediatri |
| <i>Java 14:</i> | Helmimet te femijet |
| <i>Java 15:</i> | Dozat terapeutike te femijet |

| Seminaret obligative | Tema |
|-----------------------------|---|
| <i>Java 1:</i> | Rritja dhe zhvillimi |
| <i>Java 1:</i> | Ushqyerja te femijet |
| <i>Java 2:</i> | Ushyerja nartrale |
| <i>Java 2:</i> | Ushqimi plotesues |
| <i>Java 3:</i> | Dehidrimi |
| <i>Java 3:</i> | Pamjaftueshmeria e melcise |
| <i>Java 4:</i> | Hipoglikemija |
| <i>Java 4:</i> | Fibroza cistike |
| <i>Java 5:</i> | Uroinfekcionet ne pediatri |
| <i>Java 5:</i> | Metodat diagnostike ne kardiologji pediatrike |
| <i>Java 6:</i> | Asthma |
| <i>Java 6:</i> | Artriti juvenil dhe diagnoza diferenciale |
| <i>Java 7:</i> | Sindroma epileptiforme |
| <i>Java 7:</i> | Alergjite te femijet |
| <i>Java 8:</i> | Ndarja e anemive ne pergjithesi |
| <i>Java 8:</i> | Leukemite akute te femijet |
| <i>Java 9:</i> | Tumoret solide te femijet |
| <i>Java 9:</i> | Cregullimet elektrolitike dhe te statusit acido bazik |
| <i>Java 10:</i> | Diagnoza diferenciale e hematurise te femijet |
| <i>Java 10:</i> | Miokarditi dhe kardiomiopatie |
| <i>Java 11:</i> | Sindromi i malabsorbimit |
| <i>Java 11:</i> | Pamjaftueshmeria e zemres |
| <i>Java 12:</i> | Hiperplazioni adrenal kongjenital |
| <i>Java 12:</i> | Limfadenopatie |

| | |
|-----------------|------------------------------|
| Java 13: | Sindromi nefrotik |
| Java 13: | Insuficienca akute e veshkes |
| Java 14: | Ketoacidoza diabetike |
| Java 14: | Cianoza te femijet |
| Java 15: | Helmimet te femijet |
| Java 15: | Konvulsionet te femijet |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*

109. GJINEKOLOGJI ME OBSTETRIKË

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë, Katedra e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës – Mjekësi e përgjithshme |
| Titulli i lëndës: | Gjinekologji dhe Obstetrikë |
| Niveli: | Mjekësi e Përgjithshme viti i VI |
| Statusi i lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | Viti VI (gjashtë), Semestri XI |
| Numri i orëve në javë: | 5 ditë (3+0+5) |
| Kreditë ECTS: | 2 |
| Koha / Vendi: | Klinika e Gjinekologjisë me Obstetrikë |
| Mësimdhënësi: | Prof.Ass.Dr.Vlora Ademi Ibishi , Gjinekologe Obstetër Prof.Ass.Dr.Brikene Dacaj Elshani |
| Të dhënat kontaktuese: | Prof Ass Dr Vlora Ademi Ibishi Shef I katedres Gjinekologji me Obstetrike vlora.ibishi@uni-pr.edu 044 184 766 |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda Gjinekologji me Obstetrikë përbëhet nga Gjinekologjia e cila studion traktin gjenital femëror përfshirë anatominë, fiziologjinë, proceset patologjike gjinekologjike përfshirë diagnostikën dhe trajtimin. Si dhe Obstetrika e cila studion kujdesin prekonceptonal |

| | | | |
|--|--|------------------|-----------------|
| | shtatzaninë normale, lindja, puerperiumi dhe crregullimet e ndërlihdura me shtatzaninë , lindjen dhe puerperiumin. | | |
| Qëllimet e lëndës: | Ka për qëllim që të shtjellohen ne aspektin teorik dhe klinik, si dhe të demonstrohen në praktikë sëmundjet e gjinekologjike. Të ofrohen njohuri për epidemiologjinë e këtyre sëmundjeve, etiologjinë e tyre, pasqyrën klinike, komplikimet e mundshme, diagnostikimin, diagnozën diferenciale dhe metodat e mjekimit te tyre. | | |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Studenti duhet të mësojë dhe praktikoj metodat klinike bazë për ekzaminimin e pacientit me sëmundje gjinekologjike (ekzaminim klinike, metodat diagnostike komplementare, diagnoza diferenciale, metodat terapeutike dhe të përcjellët klinikisht efektet e tyre. Studenti duhet të bëjë diferencimin dhe menaxhimin e situatave urgjente në kushte spitalore dhe jashtë spitalore, të identifikoj rastet të cilat kërkojnë trajtim spitalor në nivelet e shërbimeve shëndetësore sekondare ose terciare, si dhe të orientoj (udhëzoj) pacientin në institucionin përkatës mjekësor. | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjëratat | 3 | 5 | 15 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | 5 | 5 | 25 |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 10 |
| Përgatitja për provimin final | | | |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 50 orë |
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjerata; Punë praktike me studentët nën mbikqyrje. | | |
| Metodat e vlerësimit: | Pjesëmarrja aktive 40% Përfundimi i portfolios 60% Përfundimi i këtij moduli kontribuon (me proporcion) në arritjen e 4 ECTS për grupin e lëndëve të parapara në planprogram. | | |
| Literatura primare: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Obstetrika Sh.Lulaj et al. 2020 2. Obstetrika Aferdita Manaj Tirane 2014 3. Ginekologjia Simunic me Bashkepunetor | | |

| | |
|---|--|
| | |
| Literatura shtesë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Clinical Obstetrics and Gynecology Brian AMagowan, Philip Owen, Andrew Thomson · 2014 2. Obstetrics and Gynecology; Charles R. B. Beckmann. Lippincott Williams & Wilkins, 2010 |
| Hartimi i planit mësimor SEMESTRI IX | |
| Java | Titulli i ligjëratës |
| Java 1: | <ol style="list-style-type: none"> 10. Hyrje në praktikën klinile/ Anamneza gjinekologjike dhe Obstetrike/ perpunimi i rasteve 11. Pregaditja e pacientës për operacion/ Ekzaminimi gjinekologjik para nderhyrjes operative/ Diagnoostikimi klinik/ Ultrazëri/ CT dhe MRI 12. Kompletimi I pacientes me analiza të duhura laboratorike/ interpretimi i tyre dhe konsultat interdisciplinare mjekësore 13. Komplikimet intraoperative dhe postoperative/ Menagjimi i pacientit 14. Diagnostikimi klinik i karcinomave te organeve gjenitale/ metodat diagnostike/ ekzaminimi / kollposkopia/ citologjia/ Ultrazëri/ CT dhe MRI, si dhe plotesimet e tjera eventuale |
| Java 2: | <ol style="list-style-type: none"> 15. Pjesmarrja e studentëve në intervenimet gjinekologjike: Kiretazha eksplorative, C.e fraksionuar, RCUI, ekzaminimi me UT, LEEP, Konizimi 16. Pjesmarrja aktive e studentëve gjat lindjes normale duke filluar prej pranimit të pacientës dhe duke vazhduar deri tek mbarimi i periudhës së IVtë lindjes/ Ekzaminimi gjinekologjik dhe obstetrik/ Përcjuellja e gjendjes së fetusit gjat lindjes 17. Menagjimi I gjakderdhjeve pas lindjes/ Përdorimi I uterotonikëve/ Reanimimi I pacientës me infusion dhe transfusion/ teknika e tamponadës së kavitetit të lindjes/ reanimimi I pacientës të shoku obstetrik 18. Emergjecat gjinekologjike : Gjakderdhja juvenile, gjakderdhjet me etiologji të panjohut, diagnostikimi i gjakderdhjeve, menagjimi i traumave gjinekologjike, gjakderdhjet intraabdominale, Grav EU, apopleksioni ovarial, tretmani i cistave të torkfuara, <ol style="list-style-type: none"> a. Diagnostikimi diferencial në mes të sëmunjdeve abdominale kirurgjike dhe gjinekologjike : b. Apendiciti, adnexiti, cista e torkfuar, ileusi hematoperitoneumi, abdomeni akut 19. Emergjecat Obstetrike: gjakderdhjet te abortet, mollae hydatidosa, rapture e mitres, gjakderdhjet në tremujorin e fundit të shtatzanisë, embolia me lëngun amnional, sepsa në shtatzani dhe pas lindjes. Periudha e peurperiumit dhe komplikimet |
| | |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

110. NEUROLOGJIA DHE PSIKIATRIA

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Neurologjia dhe Psikiatria |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti i VI Semestri i XI |
| Numri i orëve në javë: | 8 ditë (3+0+5) |
| Kreditë ECTS: | 3.2 ECTS |
| Koha / Vendi: | Sipas orarit |
| Mësimdhënësi: | Prof. Zylfije Hundozi, Prof. Afrim Blyta, Prof. Nexhmedin Shala, Ass. Vera Kukaj, Ass. Valbona Govori, Ass. Blerim Myftiu |
| Të dhënat kontaktuese: | Klinika e Neurologjisë dhe e Psikiatrisë |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda i pajis studentët me të kuptuarit e përgjithshëm të simptomave dhe të shenjave të çrregullimeve të ndryshme strukturale të sistemit nervor qendror dhe periferik, me vlerësimin e pacientëve me simptoma neurologjike, si dhe kur të dyshohet për një çrregullim neurologjik, kur të bëhen procedurat diagnostike dhe nëse duhet të fillohet terapia. Qëllimi i lëndës është që t'i trajtojë studentët si mjekë të ardhshëm, që t'i identifikojnë, diagnostikojnë dhe t'i menaxhojnë çrregullimet mendore. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi i këtij moduli është që të fitohen njohuri teorike dhe praktike në fushën e neurologjisë dhe të psikiatrisë. Studentët duhet të kenë njohuri për bazën patologjike dhe simptomat klinike të çrregullimeve neurologjike dhe procedurat diagnostikuese, trajtimin dhe prognozën e tyre. Studentët fitojnë njohuri për psikiatrinë, karakteristikat e çrregulimeve mendore sipas klasifikimit ICD-10 të OBSH-së, për identifikimin dhe diagnostikimin e çrregullimeve mendore dhe trajtimin e tyre. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <ul style="list-style-type: none"> - Të jenë në gjendje që të marrin anamnezë dhe ta kompletojnë ekzaminimin neurologjik të pacientit; - Të formulojnë diagnozën punuese dhe të indikojnë hulumtimin bazik laboratorik; |

| | | | |
|--|--|------------------|-----------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Të kenë njohuri me parimet bazike të menaxhimit të rasteve urgjente neurologjike; - Të jenë në gjendje të kryejnë intervista psikiatrike, vlerësimin e funksioneve psikiatrike dhe të sjelljes së individëve me çrregullime të ndryshme mendore; - Të jenë në gjendje të vendosin diagnoza (diagnozën punuese dhe diferenciale) dhe t'i menaxhojnë pacientët; - Studentët të jenë të përfshirë në trajtimin e çrregullimeve mendore; - Të fitojnë aftësi për krijimin e komunikimit të mirë me pacientët neurologjikë dhe psikiatrikë. | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjëratat | 3 | 8 ditë | 24 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | 5 | 8 ditë | 40 |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 16 |
| Përgatitja për provimin final | | | |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 80 |
| Metodat e mësimdhënies: | Punë praktike, seminare, studime të rastit, diskutime interactive | | |
| Metodat e vlerësimit: | Pjesëmarrja aktive 40% Përfundimi i portfolios 60% Përfundimi i këtij moduli kontribuon (me proporcion) në arritjen e 4 ECTS për grupin e lëndëve të parapara në planprogram | | |
| Literatura primare: | <ul style="list-style-type: none"> - David A. Greenberg, Michael Jeffrey Aminoff, P Simon Roger. Lange Clinical Neurology, 10th edition, 2017. - John C.M. Brust. Diagnostikimi dhe trajtimi i tanishëm në neurologji, 2011. - J. Cambier, M. Masson, H. Dehen. Neurologjia, Tiranë. - Ulvi Vehbiu, Psikiatria, Tiranë, 1999 | | |
| Literatura shtesë: | - Arben Taravari. Praktikum Neurologjik, Shkup, 2014. | | |
| Hartimi i planit mësimor | | | |
| Java | Titulli i ligjëratës | | |

| | |
|-----------------|---|
| Dita 1: | Marrja e anamnezës neurologjike. Ekzaminimi i nervave kranialë. |
| Dita 2: | Ekzaminimi i qafës, i gjymtyrëve të sipërme dhe të poshtme (ushqyeshmëria, tonusi, lëvizshmëria, reflekset muskulore, fuqia, testet muskulore). Ekzaminimi i ndjeshmërisë/sensitivitetit. |
| Dita 3: | Simptomat dhe shenjat ekstrapiramidale. Ekzaminimi i funksioneve cerebellare. Ekzaminimi i funksioneve të larta kortikale. Ekzaminimi i pacientit komatoz. Ekzaminimi i pacientit me miastenia gravis. Ekzaminimi neurologjik i pacientit pediatrik. |
| Dita 4: | Procedurat diagnostike në neurologji (EEG, video EEG, ENMG, PE, PL, LTSH, ultrasonografia, TK, RM, PET, SPECT) |
| Dita 5: | Ekzaminimi komplet neurologjik i sëmundjeve të ndryshme neurologjike, diagnoza diferenciale. Raporti i rasteve. |
| Dita 6: | Intervista psikiatrike: teknikat e intervistimit psikiatrik. Informata të rëndësishme për historinë personale, familjare dhe mjekësore të sëmundjes. |
| Dita 7: | Statusi psikik: vlerësimi i funksioneve psikologjike (vetëdija, orientimi, të menduarit, perceptimi, emocionet, memoria, inteligjenca, dinamizmi, vëmendja) dhe vlerësimi i sjelljes. |
| Dita 8: | Çrregullimet mendore organike – historia, statusi mental, diagnoza, kujdesi. Sëmundjet e shkaktuara nga abuzimi i substancave psikoaktive – drogat: historia mjekësore, statusi mental, diagnoza, kujdesi. Sëmundjet e shkaktuara nga abuzimi i substancave psikoaktive – alkooli: historia mjekësore, statusi mental, diagnoza, kujdesi. |
| Dita 9: | Skizofrenia - historia mjekësore, statusi mental, diagnoza, kujdesi. Çrregullimet skizotipike dhe skizoaktive - historia mjekësore, statusi mental, diagnoza, kujdesi. Çrregullimet e disponimit - historia mjekësore, statusi mental, diagnoza, kujdesi. |
| Dita 10: | Çrregullimet neurotike dhe të indukuara nga stresi - historia mjekësore, statusi mental, diagnoza, kujdesi. Gjendjet urgjente në psikiatri. Çrregullimet mendore në fëmijë - historia mjekësore, statusi mental, diagnoza, kujdesi. Çrregullimet mendore në adoleshencë - historia mjekësore, statusi mental, diagnoza, kujdesi. Psikiatri në ekip. Psikiatria forensike. Studimet e rasteve, |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

111. Oftalmologjia

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Oftalmologjia |
| Niveli: | Doktor i Mjekësisë |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Mjekësi e përgjithshme, semestri i XI-të, viti i VI-të |
| Numri i orëve në javë: | 2 ditë (3+0+5) |
| Kreditë ECTS: | 0.8 |
| Koha / Vendi: | Klinika e syve në QKUK (Qendra Klinike Universitare e Kosoves). Sipas orarit. |
| Mësimdhënësi: | Prof.Assoc.Gazmend Kaçaniku Prof.dr.Kelmend Spahiu Prof.Asis.Naser Salihu |
| Të dhënat kontaktuese: | <p>Prof.Asoc.Gazmend Kaçaniku Klinika e syve Konsultimet: Të mërkureve 08.10-08.20 h Tel.lok. 038 500 600 3422 Tel.mob. 044 122324 gazmend.kacaniku@uni-pr.edu</p> <p>Prof.dr.Kelmend Spahiu Klinika e syve Konsultimet: Të mërkureve 08.00-08.10 h Tel.lok. 038 500 600 3427 Tel. mob. 044 117587 kelmend.spahiu@uni-pr.edu</p> <p>Prof.Asis.Naser Salihu Klinika e syve Konsultimet: Të mërkureve 08.20-08.30 h Tel.lok. 038 500 600 3501 Tel. mob. 044 177801 naser.salihu@uni-pr.edu</p> |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda e Oftalmologjisë i mundëson studentit të njihet me egzaminimet e syrit; të fitoj njohuri për sëmundjet e syrit si dhe trajtimin e tyre; të njihet me anomalitë e refraksionit, ç'rregullimet e motilitetit dhe menagjimin e tyre; të ofroj ndihmën e parë të lëndimet e syrit dhe gjendjet emergjente; të njihet me shenjat dhe simptomat në sy të shkaktuara nga sëmundjet sistemike si dhe të njihet me aplikimin e barnave për sëmundje të syrit. |
| Qëllimet e lëndës: | Njohja e studentëve me njohuritë themelore për sëmundjet e syve si dhe aftësi themelore për të ofruar ndihmë pacientëve me sëmundje të syve. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që: |

| | |
|--|--|
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

119. SHËNDETI PUBLIK

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | SHËNDETI PUBLIK |
| Niveli: | Studime Themelore të Integuara |
| Statusi i lëndës: | Obligative |
| Viti i studimit: | Viti i 6-të Semestri 12-të |
| Numri i orëve në javë: | 5 ditë (3+0+5) |
| Kreditë ECTS: | 4 ECTS |
| Koha/Vendi: | IKSHPK Sipas orarit. |
| Mësimdhënësit: | Prof. Dr. Tahire Maloku-Gjergji Prof. Asoc. Dr. Sefedin Muçaj Prof. Asoc. Dr. Merita Berisha Prof. Asoc. Dr Naser Ramadani Prof. Asoc. Dr Isme Humolli Prof. Ass. Dr Arijana Kalaveshi Prof. Ass. Dr Drita Zajmi- Salihu Prof. Ass. Dr Naim Jerliu Prof. Ass. Dr Valbona Zhjeqi Prof. Ass. Dr Sanije Gashi Prof. Ass. Dr Rina Hoxha |
| Të dhënat kontaktuese: | tahire.gjergji@uni-pr.edu sefedin.muçaj@uni-pr.edu merita.berisha@uni-pr.edu naser.ramadani@uni-pr.edu isme.humolli@uni-pr.edu arijana.kalaveshi@uni-pr.edu drita.zajmi@uni-pr.edu naim.jerliu@uni-pr.edu valbona.zhjeqi@uni-pr.edu sanije.gashi@uni-pr.edu rina.hoxha@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda Shëndeti Publik prezanton në mënyrë të përmbledhur aspektet teorike dhe punën praktike nga lëndët gjatë studimeve bazike, në fushën |

| | |
|---|---|
| | <p>e shëndetit publik përfshirë epidemiologjinë, mjekësinë sociale dhe ekologjinë humane.</p> <p>Lënda paraqet kornizën mbizotëruese, parimet dhe përgjegjësitë kryesore të shëndetit publik me fokus në rëndësinë e tij për praktikën mjekësore.</p> <p>Studentëve u ofrohet mundësia që të kuptojnë konceptet kyçe, përkufizimet dhe qasjet në shëndetin publik, qëllimet dhe fushat e reja të interesit të shëndetit publik.</p> <p>Ata do të diskutojnë dhe kuptojnë përcaktuesit (determinantat) e shëndetit dhe faktorët e rrezikut, metodat epidemiologjike, treguesit e gjendjes shëndetësore të popullatës; organizimin e sistemeve shëndetësore dhe kujdesit shëndetësor, përfshirë planifikimin, financimin, dhe aspektin ekonomik të funksionimit të shëndetit publik.</p> <p>Aspektet e parandalimit, qasjet dhe veprimet/intervenimet në shëndetin publik, do të trajtohen, gjithashtu. Përmbajtja e lëndës thekson kompetencat kryesore dhe temat e tërthorta thelbësore për programet e suksesshme të ndërhyrjes në shëndetin publik, përfshirë menaxhimin e problemeve/sëmundjeve kronike dhe ndryshimit të shprehive jetësore.</p> <p>Poashtu, do të vihet theksi tek vlerësimi dhe intervenimet që kanë të bëjnë me statusin shëndetësor të grupeve të caktuara dhe vulnerable të popullsisë si foshnjat dhe fëmijët e vegjël, fëmijët parashkollorë dhe shkollorë, të moshuarit, gratë shtatzana, personat me aftësi të kufizuara, etj.</p> <p>Për më tepër, do të adresohen aspektet në lidhje me emergjencat dhe shëndetin publik dhe rëndësia e komunikimit të riskut, koncepti “One Health”, si dhe aspektet në lidhje me etikën në shëndetin publik.</p> |
| <p>Qëllimet e lëndës:</p> | <p>Qëllimet e lëndës janë të mësohet se çfarë është shëndeti publik dhe si funksionon ai. Shëndeti publik përqendrohet në popullata dhe strategji që mund të përdoren për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. Përmes diskutimeve në grupe të vogla dhe veprimeve e ushtrimeve praktike synohet të nënvizohen rolet e teorisë dhe praktikës në shëndetin publik, dhe të mësohen strategjitë që mund të përdoren për të përmirësuar shëndetin e popullatës.</p> |
| <p>Rezultatet e pritshme të nxënies:</p> | <p>Objektivat janë që në fund të këtij moduli studenti të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - fitojë një bazë të gjerë njohurish dhe aftësish të nevojshme në shëndetin publik; - zhvillojë qëndrimet, aftësitë dhe sjelljen e nevojshme për një praktikë të mirë profesionale në fushën e shëndetit publik; - identifikojë, përcaktojë dhe përshkruajë nevojat shëndetësore të popullatës duke marrë parasysh grupet e ndjeshme; - përcaktojë përparësitë dhe planifikimin e sigurimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parandalues dhe të |

| | |
|--|---|
| | <p>qëndrueshëm optimal për popullatën dhe grupet e veçanta të synuara brenda popullatës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - aplikojë metodat shkencore në mbikqyrjen e problemeve shëndetësore, në fushën e shëndetit publik. - aplikojë në praktikë në mënyrë efikase njohuritë nga shëndeti publik gjatë ushtrimit të profesionit të mjekut si p.sh. edukimi dhe promovimi shëndetësor, përparimi i shëndetit, parandalimi i sëmundjeve, si dhe ruajtja e shëndetit përmes praktikave konkrete: zbulimi i hershëm i sëmundjeve, mbikëqyrja dhe kontrolli i sëmundjeve ngjitëse dhe jo- ngjitëse, epidemiologjia dhe kërkimi, etj. - zbatojë rregullativat e shëndetit publik dhe politikat e shëndetit mjedisor, - mbikëqyrë dhe kontrollon rreziqet e shëndetit mjedisor - përgatitë vlerësimin e evidencës së efektivitetit të ndërhyrjeve, programeve dhe shërbimeve të shëndetit publik dhe të kujdesit shëndetësor - përgatitë planifikimin e kujdesit shëndetësor dhe hulumtimin e shërbimeve shëndetësore - përgatitë vendosjen, monitorimin dhe vlerësimin e standardeve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor - njeh ligjet ekzistuese në fushën e shëndetit publik, zbatimin praktik të legjislacionit, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative në fushën e shëndetit publik - përgatitë materiale edukativo shëndetësore dhe zbaton në praktikë aktivitete në bashkësi, shkollë, familje dhe me individë. - analizon, vlerëson dhe menaxhon riskun mjedisor - njeh dhe kupton dimensionet ndërkombëtare të shëndetit publik dhe reagimin ndaj katastrofave - identifikon agjensët kimik, biologjik, fizik, social dhe psikosocial dhe implikimet e tyre në shëndet, - përgatitë rekomandime për korrigjimin e problemeve mjedisore me ndikim në shëndet - merr pjesë aktive me ekipe në terren me rastin e imunizimit, asanacionit, kampanjave të organizuara nga subjektet shëndetësore dhe bashkësia - përgatitet për punë në ekip në rastet e fatkeqësive dhe situatave të emergjencës së shëndetit publik. |
|--|---|

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatit e nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orët | Ditë / Javë | Gjithsej |
|---------------------------------|------|-------------|----------|
| Ligjërata | 3 | 5 ditë | 15 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë Praktike | 5 | 5 ditë | 25 |
| Ushtime në terren | 2 | 5 | 10 |
| Kollokiume, seminare, | 2 | 2 | 4 |
| Detyrë shtëpie | | | |

| | | | |
|--|--|---|-------------------|
| Vetë-studim (bibliotekë ose shtëpi) | | | 55 |
| Përgatitja për provimin përfundimtar | | | |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi përfundimtar) | | | |
| Projektet, prezentimet | 1 | 1 | 1 |
| Total | | | 100/4 ECTS |
| Metodat e mësimdhënies: | <i>Punë praktike, seminarike, studim rasti, scenario, diskutim interaktiv</i> <i>Përfshihen materiale mësimore tradicionale dhe të vetë-drejtuar, të bazuara në internet.</i> | | |
| Metodat e vlerësimit: | Prezentimi i seminareve/detyrave: 20% Puna praktike: 60% Aktiviteti gjatë diskutimeve: 20% Totali: 100% | | |
| Literatura primare: | <ul style="list-style-type: none"> - Ramadani N. Epidemiologjia moderne. Shkolla Kosovare e Shëndetësisë Publike. Prishtinë, 2006. - Ramadani N. Shëndetësia Publike dhe Etika. Shkolla Kosovare e Shëndetësisë Publike. Prishtinë, 2005. - Dedushaj I., Humolli I. Epidemiologjia speciale e sëmundjeve ngjithëse. UP. Prishtinë, 2005. - Fatime Arënliu Qosaj, Merita Berisha. Transition in health and health care in Kosovo. Prishtinë, 2010. - A.Pollozhani, V.Kendrovski, S.Krasniqi. Ekologjia Humane dhe Shëndeti publik. 2009 - Ilir Begolli. Edukimi shëndetësor. Prishtinë, 2001 - Ichiro Kawachi, Iain Lang, and Walter Ricciardi (Editors). Oxford Handbook of Public Health Practice (4 ed.). Oxford University Press, 2020. - Roger Detels, Martin Gulliford, Quarraisha Abdool Karim, and Chorh Chuan Tan (Editors). Oxford Textbook of Global Public Health (6 ed.). Oxford University Press, 2015. - Riegelman and Kirkwood (Editors). Public Health 101: Healthy People—Healthy Populations. Enhanced Second Edition. Jones and Bartlett. 2015. - Leon Gordis. Epidemiologjia. (Botimi i parë në shqip i botimit të tretë në anglisht). UFO Press 2009, Tiranë - James F. Jekel, David L. Katz, Joann G. Elmore dhe Dorothea M.G. Wild. Epidemiologji, Biostatistikë dhe Mjekësi Parandaluese. Tabernakull. Shkup, 2010. - Robert B. Wallace, Neal Kohatsu. Shëndeti publik dhe mjekësia parandaluese. Tabernakull. Shkup, 2010. - Mary-Jane Schneider. Introduction Public Health, third edition, Department of Health Policy, Management, and Behavior School of Public Health, USA. Jones and Bartlett Publishers 2011. | | |

| | |
|---------------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Roshi, E, Hyska J, Bara P, Burazeri G, Kuneshka L. Statistika. Tiranë, 2004. |
| Literatura shtesë: | <p><i>Burime tekstesh të tjera</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Public Health Teaching Books (Open Access). https://www.seejph.com/index.php/seejph/article/view/1910 - Genc Burazeri, Lijana Zaletel Kragelj. Health: Systems – Lifestyle – Policies ; Forum for Public Health in Southeastern Europe. Vol I. https://www.seejph.com/index.php/seejph/article/view/1919/1854 - Genc Burazeri, Lijana Zaletel Kragelj. Health Investigation: Analysis – Planning – Evaluation ; Forum for Public Health in Southeastern Europe. Vol II. https://www.seejph.com/index.php/seejph/article/view/1920/1855 <p><i>Materiale mësimore të bazuara në internet</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - An online public health curriculum for medical students. https://www.publichealthcommute.com/ - Public Health 101. An introduction to public health and the sciences essential to public health practice. https://www.cdc.gov/training/publichealth101/index.html - European Observatory on Health Systems and Policies. https://eurohealthobservatory.who.int/ <p><i>Vegëza</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës https://niph-rks.org/ - The Association of Schools of Public Health in the European Region (ASPHER) https://www.aspher.org/ - WHO https://www.who.int - WHO Europe. Public health services. https://www.euro.who.int/en/health-topics/Health-systems/public-health-services - European Centre for Disease Prevention and Control https://www.ecdc.europa.eu/en - European Commission. Public Health. https://ec.europa.eu/health/home_en - The European Public Health Association (EUPHA) |

<https://eupha.org/>

Plani i hartuar mësimor

| Java | Titulli i temës |
|------------------|--|
| Java 1: | Koncepti i shëndetit publik, përkufizimi, qëllimet dhe fushat e reja të interesit të shëndetit publik. |
| Java 2: | Shëndeti, sëmundja, determinantat e shëndetit dhe faktorët e riskut |
| Java 3 : | Shëndeti dhe matjet e shëndetit publik. Matjet e sëmundjes, matjet e shoqërimit ose matjet e efektit, dhe shkakësia. Vlerësimi i gjendjes shëndetësore (Indikatorët epidemiologjik). |
| Java 4: | Studimet epidemiologjike përshkruese dhe eksperimentale; Epidemiologjia përshkruese dhe modeli/dizajni i hipotezave; Epidemiologjia analitike dhe testi i hipotezave. |
| Java 5: | Format e organizimit dhe funksionet e shëndetit publik (vlerësimi, zhvillimi i politikave dhe sigurimi). Operacionet Esenciale të Shëndetit Publik (EPHOS). Organizimi dhe prioritetet e shëndetit publik në Kosovë. |
| Java 6 : | Mbikëqyrja (Survejanca) e shëndetit publik. Mbikëqyrja dhe hetimi i shpërthimit. Ndodhja e shpërthimit të sëmundjes; Konceptet themelore të një shpërthimi. Vlerësimi dhe përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes. |
| Java 7: | Faktorët mjedisor, përfshirë ndryshimet klimatike si përcaktues të shëndetit publik. Analiza, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut mjedisor. Vlerësimi i ndikimit të kushteve mikroklimatike dhe higjienës shkollore në shëndetin e fëmijëve. |
| Java 8: | Situatat e jashtëzakonshme - Emergjencat, analiza, vlerësimi menaxhimi dhe komunikimi i riskut dhe katastrofave. |
| Java 9: | Siguria ushqimore. Principet e sistemit HACCP. Problemet mikronutritive - luftimi dhe parandalimi i tyre përmes pasurimit të artikujve të ndryshëm ushqimor (deficienca jodike, fluoroza, anemia, spina bifida, kariesi). Analiza e furnizimit me ujë të pijshëm në Kosovë. |
| Java 10: | Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës, procedura dhe struktura e saj. Indikatorët shëndetësor; Indikatorët e cilësisë në kujdesin shëndetësor. Performanca e sistemit shëndetësor. |
| Java 11 : | Parandalimi, qasjet dhe veprimi në shëndetin publik. Nivelet e parandalimit: primar, sekondar, terciar, kuaternar. Qasjet e bazuara në popullatë për të përmirësuar shëndetin publik (edukimi, marketingu, politika dhe ligji). Përpilimi i materialeve edukativo shëndetësore; informimi lidhur me realizimin e anketave nga lëmi i shëndetit publik. |
| Java 12 : | Grumbullimi, përpunimi, llogaritja e parametrave dhe analiza statistikore e të dhënave. Sistemi i Informimit Shëndetësor dhe Klasifikimit Ndërkombëtar. |
| Java 13 : | Rëndësia e qasjeve ndërdisiplinore për shëndetin publik. |

| | |
|------------------|---|
| | Koncepti Një Shëndet (One Health): Ndërthurja e shëndetit të njeriut, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të mjedisit. Aspektet etike në shëndetin publik. |
| Java 14 : | Përpilimi i një projekti edukativo shëndetësor - punë grupore (program për shkolla, peer to peer apo për nënat lidhur me ushqimin, për femrat lidhur me kontracepsionin) |
| Java 15 : | Elaborimi i projektit- punë grupore. Prezantimi i punës para grupit. Aktivitetet në terren: Mbajtja e ligjëratave edukativo shëndetësore në shkolla, çerdhe, me të moshuarit, në komunitet. |

Politikat Akademike dhe Kodi i Sjelljes

Mësimdhënësi konform Statutit të UP cakton kriteret për vijimin e rregullt në mësim dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë.

120. DERMATOVENEROLOGJI

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|-------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | DERMATOVENEROLOGJI |
| Niveli: | Bachelor/ Mjekësi e përgjithshme |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | VI/ Semestri XI |
| Numri i orëve në javë: | 3 ditë (3+0+5) |
| Vlera në kredi – ECTS: | 1.2 |
| Koha / lokacioni: | Përcaktohet nga orari për pjesën praktike /Klinika e Dermat. |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Klinika e Dermatovenerologjisë Anëtarët e Katedrës: <u>Prof. Dr.Afërdita Daka</u> -Shefi i Katedrës; <u>Ass.Dr. sci.Antigona Gerqari;</u> <u>Ass. Dr.Adelina Aliu.</u> |
| Detajet kontaktuese: | aferdita.daka@uni-pr.edu antigona.gerqari@uni-pr.edu adelina.aliu@uni-pr.edu |

| | |
|---|---|
| | |
| Përshkrimi i lëndës | <p>Profesionistët mjekësorë në përditshmëri duhet të marrin vendime për diagnostifikimin, trajtimin dhe edukimin e pacientëve. Qëllimi i njohjes së lëkurës në përgjithësi dhe anekseve të saj në veqanti, të metave, aplikimi i preparateve terapeutike të cfardo lloji forme në dermatoza të ndryshme me pasqyrë klinike të veqanta e që kanë shkaktar dhe favorizues të shumëllojt.</p> <p>Kujdesi shëndetësor ka një rol të veçantë në dermatomikozat, dermatozat bulloze, dermatozoonozat, dermatozat alergjike, në terapine fizikale.</p> <p>Duke u bazuar në standardet tona jetësore, është më se e nevojshme të bëhet hetimi (zbulimi), diagnostifikimi, analizat laboratorike të përgjithshme, të veqanta si dhe ato specifike për llojet e dermatozave. Natyrisht, në këto kontekste hyn dhe efikasiteti i përdorimit të barnave.</p> <p>Puna praktike që do bëhet, e rrit vetëbesimin e studentit –mjekut të ardhshëm për marrjen e vendimeve, kualitetin e kujdesit dhe aftësinë e tyre për të komunikuar me kolegët, pacientët dhe familjet e tyre- elemente kyçe të profesionalizmit. Prandaj kjo lëndë i përket zhvillimit profesional.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Lënda ka për qëllim të përgatit studentët të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ketë kujdes shëndetësor kualitativ për individët dhe popullatën; 2. Përdorin metoda më të reja shkencore-hulumtuese në diagnostikë dhe trajtim. |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Pas përfundimit të pjesës praktike të lëndës studentët do të kenë mundësi të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. T'i qasen me përkushtim pacientit; 2. Kuptojnë qëllimet laboratorike dhe diagnostike të sëmundjeve për të ardhur te diagnoza e saktë ; 3. Performojnë kërkimin e trajtimit në bazë të protokoleve; 4. Ruajnë dhe nxjerrin materialet në softver të përshtatshëm; 5. Aplikojnë evidencën më të mirë për qëllime profesionale dhe shkencore; 6. Të bëjnë hulumtime nga rishikimi i literaturës |

| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
|---|---|------------------|------------------|
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjerata | 3 | 3 | 9 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | 5 | 3 | 15 |
| Vetëmësim | | | 6 |
| | | | |
| Totali | | | 30 |
| *Semstri Dimror | | | |
| Metodologjia e mësimdhënies: | <ul style="list-style-type: none"> - Seminare - Raporte të shkurtra studentore nga lista e leximit - Pjesa praktike me pacientet në reparte, ambulanta specialistike, laboratore të klinikës - Diskutim në klasë <p>Studentët do të kenë një projekt që duhet ta realizojnë përgjatë kursit (në klasë dhe shtëpi) dhe ta prezantojnë në fund.</p> | | |
| Metodat e vlerësimit: | <p>Pjesëmarrja aktive 40%</p> <p>Përfundimi i portfolios 60%</p> <p>Përfundimi i këtij moduli kontribuon (me proporcion) në arritjen e 8 ECTS për grupin e lëndëve të parapara në planprogram</p> | | |
| Literatura | | | |

| | |
|-------------------------------------|---|
| Literatura bazë: | <p>1. Prof.Dr.Afërdita Krasniqi-Daka <i>Atlasi i Dermatologjisë</i> ALB-MED(bot.II), 2014</p> <p>2. Prof.Dr.Simë Dobreci <i>Dermatologjia</i> Universiteti i Prishtinës(bot.IV), 2009</p> <p>3. Fitzpatric <i>Atlas me ngjyra dhe përmbledhje e Dermatologjisë Klinike (përkthim i botimit të gjashtë)</i> Bato-Divajn Skopje, 2011</p> |
| Literatura shtesë: | Burime të tjera ;Interneti; Punime të botuara që do të shpërndahen, përmes së cilave studentët zhvillojnë shkathtësitë. |
| Plani i dizajnuar i mësimit: | |
| Një jave | Mësimi praktik është në Semestrin Dimëror |
| Dita e parë: | <p>2 orë seminare (nga dy grupe të dermatozave)</p> <p>2 orë ushtrime teorike/ laboratorike; mikologjia,venerologjia</p> <p>2 orë punë praktike reparti”A” dhe ambulanta.</p> |
| Dita e dytë: | <p>2 orë seminare (nga dy grupe të dermatozave)</p> <p>2 orë ushtrime teorike/ laboratorike; fototerapia, dermatoskopi</p> <p>2 orë punë praktike reparti”B” dhe ambulanta.</p> |
| Dita e tretë: | <p>2 orë seminare (nga dy grupe të dermatozave)</p> <p>2 orë ushtrime teorike / laboratorike, dermatokirurgjia, Terapia fizikale</p> <p>2 orë punë praktike reparti”C” dhe ambulanta.</p> |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të ndjekin mësimin teorik-seminare dhe praktik në përputhje me rregulloren për studime themelore ne Fakultetin të Mjekësisë te UP. Studentët duhet t'i përmbahen edhe rregullave tjera si më poshtë:

T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë.

Të sillen mire në hapësirat e Universitetit,

Të respektojnë të gjitha rregullat e vendosura nga njësia akademike ku organizohet mësimi praktik dhe teorik.

121. Mjekesia Familjare

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|----------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë/ Dega Mjekesia e përgjithshme/ Katedra e Mjekësisë sociale, Mjekesise Familjare dhe Mjekësisë së Punës |
| Titulli i lëndës: | Mjekësia Familjare |
| Niveli: | Themelor |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | Viti i VI-të i studimeve, Semestri i XI |
| Numri i orëve në javë: | 2 ditë (3+0+5) |
| Vlera në kredi – ECTS: | 0.8 |
| Koha / lokacioni: | Njesit e Mjekesia Familjare |
| Mësimëdhënësi i lëndës: | Prof.asoc.dr Ibrahim Rudhani |
| Detajet kontaktuese: | QKUK-Instituti B 044178573 ose 049178573 Ibrahim.rudhani@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | Ky modul njohton studentet me aspektet e kujdesit parësor shëndetësor / mjekësisë familjare e cila përfshinë një rrjet të shërbimeve shëndetësore në bazë apo qendër në komunitet, institucionet e kujdesit paresor shendetesor, Qendrat Kryesore te Mjekësisë Familjare si bartëse të shërbimeve kujdesit parësor shëndetësor në |

| | |
|--|---|
| | <p>bazë të koncepteve të Mjekësisë familjare dhe njesite e tyre, organizimin e sistemit shëndetësor me theks në KPSH, ekipin e mjekësisë familjare detyrat dhe obligimet, problemet me të shpeshta që hasen dhe principet dhe metodat shkencore që shfrytëzohen në KPSH.</p> |
| <p>Qëllimet e lëndës:</p> | <p>Qëllimet lëndës së mjekësisë familjare janë që përmes teorisë dhe praktikës t'i njoftoj studentet me aspektet e kujdesit parësor shëndetësor / mjekësisë familjare e cila përfshinë një rrjet të shërbimeve shëndetësore në bazë apo qendër në komunitet.</p> <p>Qendrat e Mjekësisë Familjare janë bartëse të shërbimeve kujdesit parësor shëndetësor në bazë të koncepteve të Mjekësisë familjare.</p> <p>Rezultatet e pritura të nxënies nënkuptojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë që do të fiton studenti pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lëmie.</p> <p>Lënda do të jetë e përqendruar në studentë dhe do të jetë interaktive. Studentët do të përdorin edhe ditarin e punës ku do t'i evidentojnë rastet klinike, trajtimin dhe menaxhimin e tyre</p> |
| <p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p> | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptoj organizimin e sistemit shëndetësor në Kosovë dhe ofrimin e shërbimeve në kujdes parësor shëndetësor / mjekësi familjare dhe në komunitet dhe definicionin e kujdesit parësor shëndetësor /mjekësisë familjare dhe shërbimet që ofrohen në KPSH/MF ▪ Të bëjë identifikimin e problemeve të cilat paraqiten në mjekësi familjare si dhe zgjidhjet e duhura për njohje, parandalim dhe kujdes të vazhdueshëm të pacientëve të tyre ▪ Të kuptoj rëndësinë e raportit të mirë mjek-pacient përmes shkathtësive të mira të komunikimit dhe konsultimeve cilësore ▪ Të kuptoj konceptin, planifikimin, menaxhimin dhe evaluimin e shërbimeve të mjekësisë familjare ▪ Të aplikoj qasje sistemike dhe gjithëpërfshirëse për pacientët dhe familjet e tyre ▪ Të kuptoj rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm dhe çështjeve që kanë të bëjnë me cilësinë |

| | | | |
|---|---|------------------|------------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> Të aplikoj principe të shëndetësisë publike, përshkrimin, sqarimin dhe zgjidhjen e problemeve në ofrimin e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor / mjekësisë familjare | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjërata | 3 | 2 | 6 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | 5 | 2 | 10 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | | | |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | | | |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | | | 4 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | | | |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | |
| Projektet,prezentimet ,etj | | | |
| Totali | | | 20 |
| Metodologjia e mësimdhënies: | <p>Ligjërata interaktive, ushtrime përmes punës në grupe, seminare, mësimi i vetëdrejtuar, takime punuese, prezentime nga studentët.</p> | | |
| | | | |
| Metodat e vlerësimit: | Pjesëmarrja aktive 40% | | |

| | |
|---|---|
| | <p>Përfundimi i portfolios 60%</p> <p>Përfundimi i këtij moduli kontribuon (me proporcion) në arritjen e 8 ECTS për grupin e lëndëve të parapara në planprogram</p> |
| Literatura | |
| Literatura bazë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Mjekësia Familjare, Zagreb, 2. Modulet e Mjekësisë Familjare (11 modulet) 4. “Orientimi në Mjekësinë Familjare “ 2003 – 2004 5. “Të Menduarit kritik dhe hulumtimi” 2003 – 2004 6. The New Public Health, Theodore Tulchinsky, Elena A.Varavikova 7. Socijalna Medicina – Želimir Jakšić, Luka Kovacic i suradnici 2000 8. Sistemet Shëndetësore/Transition in Health and Health Care in Kosovo-Prof.Ass.Dr.Merita Koçinaj, Fatime Arënlju –Qosaj 2010 9. Edukimi Shëndetësor”- Ilir Begolli 2001 10. Konceptet e ligjerimeve, libri ne dorëshkrim |
| Literatura shtesë: | <p>Web faqet e ndryshem:</p> <p>www. Evidence Based Medicine</p> |
| Plani i dizajnuar i mësimit: Praktika Klinike do të zhvillohet | |
| Njesia 1 | - Hyrja, njoftimi me lëndën (prezentimi i Syllabusit) |
| Njesia 2: | - Organizimi i sistemit shëndetësor në Kosovë |
| Njesia 3 | - Definicioni i Kujdesit parësor shëndetësor dhe rëndësia e MF |
| Njesia 4 | - Zhvillimi i MF në vende të ndryshme dhe te ne |
| Njesia 5 | -Komunikimi me pacientë -Komunikimi verbal -Komunikimi joverbal |
| Njesia 6: | - Konsultimi dhe rëndësia e konsultimit në mjekësi familjare (7 detyrat e konsultimit) |

| | |
|-------------------|---|
| Njesia 7 | - Procesi diagnostik në mjekësinë familjare / Metodatat induktive dhe hipotetiko-deduktive të zgjedhjes së problemeve |
| Njesia 8 | - Dosjet mjekësore për Mjekësinë Familjare |
| Njesia 9: | - Plotësimi i kartelave shëndetësore për pacientë |
| Njesia 10 | - Kompetencat dhe detyrat e mjekut familjar |
| Njesia 11 | - Çanta e mjekut |
| Njesia 12 | -Ndikimi i mjedisit në shëndet |
| Njesia 13 | - Problemet më të shpeshta në kujdesin parësor |
| Njesia 14 | - Kujdesi për popullatën e grupeve të caktuara- Diabeti- menaxhimi i sëmundjeve kronike-diabtit |
| Njesia 15: | - Zhvillimi fizik i fëmijëve shkollor |
| Njesia 16 | - Kujdesi për adoleshentët |
| Njesia 17 | - Kujdesi për popullatën e grupeve të caktuara- Sëmundjet Kardiovaskulare |
| Njesia 18 | - Shëndeti i femrës (Planifikimi familjar) – Shëndeti i femrave |

| | |
|------------------|--|
| Njesia 19 | - Kujdesi për popullatën e grupeve të caktuara |
| Njesia 20 | - Kujdesi për të moshuarit- (HTA) |
| Njesia 21 | - Kujdesi për të moshuarit |
| Njesia 22 | - Vlersimi i pare intermediar |
| Njesia 23 | - Puna ekipore |
| Njesia 24 | - Formimi i grupeve të rishqyrtimit kolegjial |
| Njesia 25 | - Mjekësia e bazuar në hulumtime të dëshmuara |
| Njesia 26 | - Auditi në Kujdesin Parësor Shëndetësor |
| Njesia 27 | - Skreningu në Kujdesin Parësor Shëndetësor |

| | |
|-----------|--|
| Njesia 28 | Çështjet e cilësisë në Kujdes parësor shëndetësor / mjekësi Familjare - Vlersimi i dyte intermediar |
| Njesia 29 | Përdorimi i udhërrëfyeseve dhe protokolleve klinike |
| Njesia 30 | - Rekapitullimi i lëndës dhe ligjërata përmbledhëse |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët/tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara*

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humbë të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

122. MJEKËSI URGJENTE

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë, Mjekësi e përgjithshme |
| Titulli i lëndës: | Mjekësi Urgjente- Mësim klinik |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti i VI, semestri XI |
| Numri i orëve në javë: | 2 ditë (3+0+5) |
| Kreditë ECTS: | 0.8 ECTS |
| Koha / Vendi: | Sipas orarit/ Klinika e Kirurgjisë dhe Anesteziologjisë |
| Mësimdhënësi: | Prof. Asoc. Nehat Baftiu, Prof Asoc Antigona Hasani, Prof Ass Fatos Sada, |
| Të dhënat kontaktuese: | Ass.dr. Astrit Hamza, sekretar i katedrës së Kirurgjisë Klinika e Kirurgjisë, Katedra e Kirurgjisë E-mail: astrit.hamza@uni-pr.edu Tel: +381385006003254 |
| Përshkrimi i lëndës: | Mjekësia Urgjente ka për qëllim njohjen dhe zhvillimin e shkathtësive themelore të studentit në lidhje me ekzaminimin klinik, diagnostikimin dhe trajtimin e të sëmurëve me gjendje të rëndë e jetëkërcnuese, të shkaktuara qoftë nga sëmundjet e natyrës internistike, kirurgjike, traumatike, infektive e toksike. |

| | | | |
|--|--|------------------|-----------------|
| Qëllimet e lëndës: | <ul style="list-style-type: none"> • Të ofroj njohuri bazë mbi sëmundjet ose gjendjet urgjente ne mjekësinë klinike, • Të ofroj njohuri mbi etiologjinë e tyre, klinikën, ecurinë, prognozën, diagnostikimin, diagnozën diferenciale dhe mjekimin e tyre. • Synon të aftësoj studentin në aspekt teorik dhe praktik për menaxhimin. • Synon të aftësoj studentin në aspekt teorik dhe praktik triazhimit dhe • Synon të aftësoj studentin në aspekt teorik dhe praktik të trajtimit të këtyre rasteve. <p>Të ofroj njohuri mbi masat e reanimimit kardiopulmonar dhe kujdesit intenziv emergjent.</p> | | |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <p>Në fund të këtij syllabusi studentët do të jenë të aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të i qasen pacientit urgjent/emergjent. • Si të menaxhojnë çrregullimet e vetëdijes dhe rrugët e vështira të frymëmarrjes. • Trajtimin e pacientit në shok. • Trajtimin e pacientit me probleme kardiovaskulare. • Trajtimi i pacientit urgjent në repart. • Trauma, BTLA dhe ATLS. • Trajtimin e pacientit urgjent kirurgjik (trauma e kokës, toraksit, vaskulare, urologjike, pediatrike) <p>Trajtimi i djegieve.</p> | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjëratat | 3 | 2 | 6 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | 5 | 2 | 10 |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 4 |
| Përgatitja për provimin final | | | |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 20 ore |
| Metodat e mësimdhënies: | <p>Pune praktike me pjesëmarrje pasive dhe aktive ne punët ne ambulance kirurgjike, repart, emergjencë, sallë të operacionit, poliklinike, kabinetet e diagnostikës joinvazive dhe invazive, seminare dhe konsultime.</p> | | |
| Metodat e vlerësimit: | <p>Pjesëmarrja aktive 40%</p> | | |

| | |
|--|--|
| | Përfundimi i portfolios 60% Përfundimi i këtij moduli kontribuon (me proporcion) në arritjen e 8 ECTS për grupin e lëndëve të parapara në planprogram |
|--|--|

| | |
|----------------------------|--|
| Literatura primare: | <p>Mjekësia Urgjente, Hasan Ahmeti & Antigona Hasani, Universiteti i Prishtines “Hasan Prishtina”, Prishtinë 2020.</p> <p>Urgjencat ne Kirurgjine e pergjithshme, Sam Mehta, Andrew Hindmarsh, Leila Rees. Libri shkollor, Prishtine 2009</p> <p>Surgery. Principles and Practice. Volume I dhe II. Besim Elezi et al. 2009. Tiranë</p> <p>Surgery, Ivan Bradic i suradnici. Medicinska Naklada, 1995, Zazgreb</p> <p>Prirucnik za ispite: Ivan Perpiq. Zagreb. 2005</p> <p>Textbook of surgery, Third Edition. Blacwell publishing, 2010.</p> <p>Principles and Practice of Surgery, sixth edition edited by O. James Gardon, 2012 UK</p> <p>Anesteziologjia dhe Reanimacioni – N Baftiu 2015</p> <p>2. Anesteziologjia Klinike-Carl & Matthew Gwinnut, Wiley Blackwell, botim i 4-të, 2012.</p> <p>3. Anesteziologjia dhe Mjekimi Intensiv, grup autorësh nga Tirana, botim i 1-rë, 2011</p> <p>4. Anesteziologjia-Xhymret Skenderi, botim i 1-rë, 2011</p> <p>Fauci A, Braunwald E et all. Harrison’s Principles of Internal Medicine, 17th Edition, International edition, 2008</p> <p>Grup Autorësh. Parimet e Mjekësisë së Përgjithshme. Tiranë, 2002</p> |
|----------------------------|--|

| | |
|---------------------------|---|
| Literatura shtesë: | Burime nga interneti www.google.com |
|---------------------------|---|

| Hartimi i planit mësimor një javor – Semestri XII | | |
|--|---|--|
| Dita | Seminari/Ushtrimi që do të zhvillohet | |
| Dita e parë: | Neurokirurgjia dhe Kirurgjia Vaskulare | Egzaminimi i pacienteve me gjendje emergjente Neurokirurgjike dhe Vaskulare. |
| Dita e dytë: | Kirurgjia Abdominale dhe Urologjia | Egzaminimi i pacienteve me gjendje emergjente abdominale dhe Urologjike |

| | | |
|-----------------------|--|--|
| Dita e tretë: | Kirurgjia Torakale dhe Plastike | Egzaminimi i pacienteve me gjendje emergjente Torakale dhe kirurgjisë plastike. |
| Dita e katërt: | Anesteziologji me Reanimacion | Egzaminimi i pacienteve me disbalanc elektrolitik. Menaxhimi i shokut. Intubimi dhe Extubimi |
| Dita e pestë: | Kujdesi Intenziv | Basic trauma life support (BTLS) and Advanced Trauma life support (ATLS). |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Konform statutit të UP-së.

123. ANESTEZIOLOGJIA

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Anesteziologjia |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti i VI-të Semestri i XI-të |
| 9+9+0 | 3 ditë (3+0+5) |
| Kreditë ECTS: | 1.2 |
| Koha / Vendi: | Katedra e AR Sipas orarit |
| Mësimdhënësi: | Prof. Asoc. Nehat Baftiu, Prof Asoc Antigona Hasani, Prof Ass Fatos Sada, Ass Dr Rajmonda Nallbani-Komoni, Ass Dr Mifail Morina |
| Të dhënat kontaktuese: | nehat.baftiu@uni-pr.edu; antigona.hasani@uni-pr.edu; fatos.sada@uni-pr.edu; rajmonda.nallbani@uni-pr.edu; mifail.morina@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Beteja më e madhe të cilën e ka fituar njerëzimi është beteja kundër dhimbjes. Kjo ndodh, pikërisht, me zbulimin e anestezionit dhe anestetikëve. Anesteziioni është shkencë e cila lufton dhimbjen. Kjo arrihet nëpërmjet të: anestezionit të përgjithshëm dhe anestezionit lokal dhe regjional. Reanimacioni, në anën tjetër nënkupton ringjalljen, mbajtjen dhe trajtimin e pacientëve kritik. Kjo realizohet kryesisht në mjekimin intensiv. Ky modul mundëson njohjen e anestezionit të përgjithshëm, anestezionit lokal dhe regjional, reanimimit, trajtimin e dhimbjes akute dhe kronike dhe trajtimin intensiv të pacientëve. |

| | |
|--|--|
| Qëllimet e lëndës: | <p>Ky modul është i drejtuar për të mësuar studentët në lidhje me anestezionin e përgjithshëm, anestezionin lokal dhe regional, reanimimin, trajtimin e dhimbjes akute dhe kronike dhe kujdesin intensiv.</p> <ul style="list-style-type: none"> • për intervenim kirurgjik. • Të aftësoj studentët në aplikimin e vijave venoze periferike. • Të aftësoj studentët të monitorojnë pacientët dhe të përcjellin monitorimin. • Të mësoj studentët me teknikat e intubimit dhe ventilimit. • Të njoftoj studentët me aplikimin e anestezionit spinal, peridural dhe te përgjithshëm. • Njohjen e studentit me procedurat e reanimimit kardiopulmonal (CRP) pas arrestit kardial dhe mjekimin intensiv. <p>Njohjen e studentit me rregullimin e statusit acido bazik dhe ushqimit parenteral dhe enteral.</p> |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <p>Pas përfundimit të orës së mësimit, studenti duhet të jetë i aftë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përgatisë pacientët për ndërhyrje kirurgjikale. 2. Vendosja e linjave intravenoze periferike tek pacienti. 3. Aplikoj monitorimin dhe menaxhoj situatat kritike. 4. Mbajtja e rrugëve të frymëmarrjes të hapura, kryerja e ventilimit jo invaziv dhe intubimit endotrakeal. 5. Zbatimi i sedacionit të shkallës së lehtë dhe moderuar. 6. Menaxhimi i pacientëve me sëmundje kritike. <p>5. Reanimimi kardiopulmonar (CPR), dhe defibrilimi manual dhe automatik.</p> <p>Studentët do të jenë në gjendje të përdorin njohuritë e marra nga lënda e Anesteziologjisë dhe Reanimacionit në praktikë në sallën e operacionit , mjekimin intensiv dhe në laboratorin e simulimit.</p> |

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---------------------|------------------|-----------------|
| Ligjëratat | 3 | 3 | 9 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | 5 | 3 | 15 |
| Konsultime me mësime të mësuara | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | - | - | 6 |
| Përgatitja për provimin final | - | - | |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | - | - | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |

| | | |
|--------------|--|-----------|
| Total | | 30 |
|--------------|--|-----------|

| | |
|--------------------------------|---|
| Metodat e mësimdhënies: | <ul style="list-style-type: none"> - Ligjërata - Huluntimi i çështjeve të përzgjedhura duke përdorur burimet e internetit - Detyra me shkrim dhe redaktim nga kolegët/instruktorët - Raporte të shkurtra studentore nga lista e leximit - Diskutim në klasë -Puna praktike në sallën e operacionit , mjekimin intensiv dhe në laboratorin e simulimit |
|--------------------------------|---|

| | |
|------------------------------|--|
| Metodat e vlerësimit: | Pjesëmarrja aktive 40% Përfundimi i portfolios 60% Përfundimi i këtij moduli kontribuon (me proporcion) në arritjen e 8 ECTS për grupin e lëndëve të parapara në planprogram |
|------------------------------|--|

| | |
|----------------------------|--|
| Literatura primare: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Anesteziologjia dhe reanimacioni- Nehat Baftiu, botim i parë, 2015 2. Anesteziologjia Klinike-Carl &Matthew Gwinnut, Wiley Blackwell, botim i 4-të, 2012 (përkthyer në shqip). 3. Anesteziologjia dhe Mjekimi Intensiv, grup autorësh nga Tirana, botim i 1-rë, 2011 4. Anesteziologjia-Xhymret Skenderi, botim i 1-rë, 2011 |
|----------------------------|--|

| | |
|---------------------------|---|
| Literatura shtesë: | <ol style="list-style-type: none"> 5. Essentials of Anesthetic Equipment-B. Al-Shaikh, S. Stacey.Churchill Livingstone, botimi 3, 2007 6.BLS for Healthcare Providers Student Manual & CD Product. American Heart Association. 7.ALS Provider Manual (includes Student CD, Pre course Preparation Checklist, ACLS Pocket Cards). AHA |
|---------------------------|---|

Hartimi i planit mësimor

| Java | Titulli i ligjëratës |
|----------------|--|
| <i>Java 1:</i> | ANESTEZIONI I PËRGJITHSHËM |
| <i>Java 2:</i> | PREPARATET QË PËRDOREN GJATË ANESTEZIONIT TË PËRGJITHSHËM |
| <i>Java 3:</i> | ANESTEZIONI REGJIONAL |
| <i>Java 4:</i> | ARRESTI KARDIAK-REANIMIMI KARDIOPULMONAR II |
| <i>Java 5:</i> | MONITORINGU JO INVAZIV DHE INVAZIV |
| <i>Java 6:</i> | PAMJAFTUESHMËRIA AKUTE RESPIRATORE |
| <i>Java 7:</i> | ÇRREGULLIMET ACIDO-BAZIKE |
| <i>Java 8:</i> | USHQIMI ENTERAL DHE PARENTERAL. <i>Vlerësimi i i dytë intermediar</i> |

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
 Mjetet që përdoren gjatë orëve të mësimimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
 Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

124. SËMUNDJET INFEKTIVE

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Sëmundjet Infektive |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti VI semestri XI |
| Numri i orëve në javë: | 5 ditë (3+0+5) |
| Kreditë ECTS: | 2 |
| Koha / Vendi: | Klasa S6 Sipas orarit |
| Mësimdhënësi: | Prof. Asoc. Dr. Ilir Tolaj |
| Të dhënat kontaktuese: | +383 44 199 908, ilir.tolaj@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | <p>Sëmundjet infektive është lëndë e cila përshkruan raportin specifik të numrit të pafund të mikroorganizmave me njeriun, bashkëjetesen e tyre në një ekuilibër mjaft delikat dhe shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme kur ky ekuilibër priset.</p> <p>Asnjë nga grup sëmundjet nuk ka pasur ndikim më të madh në historinë e zhvillimit të njerëzimit siç kanë pasur sëmundjet infektive.</p> <p>Sëmundjet infektive përshkruajnë epidemiologjinë, etiologjinë, manifestimet klinike, mjekimin dhe parandalimin e sëmundjeve të veçanta infektive por edhe të sindromeve të veçanta që për etiologji kanë mikroorganizmat e ndryshëm.</p> <p>Në aspektin e mjekimit sëmundjet infektive janë gjithashtu unike. Derisa, për trajtimin e shumicës së sëmundjeve tjera në japim barna me veprimin e dëshiruar farmakologjik për ndonjë receptor apo proteinë për pacientin, për trajtimin e infeksioneve ne japim antimikrobikët që të ushtrojnë efektin e dëshiruar farmakologjik në organizmin patogjen që është shkaktar i infeksionit në njeriun.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Qëllimet e lëndës janë që të fitohen njohuritë e nevojshme për egzaminimin e personit me sëmundje infektive; të fitohen njohuri për sëmundjet e veçanta infektive, etiologjinë, manifestimet klinike, diagnostikimin dhe ecurinë e tyre në kategori të ndryshme të pacientëve; të fitohen njohuritë e domosdoshme për mjekimin dhe parandalimin para dhe pas ekpozimit e sëmundjeve të veçanta infektive.</p> |

| | | | |
|--|---|------------------|-----------------|
| | Studenti pas kalimit të provimit duhet të ketë njohuri solide për menaxhimin e nje të sëmundjeve të dyshuar me sëmundje infektive. | | |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | <ul style="list-style-type: none"> - Të njohurit me parimet themelore të egzaminimit të të personit të dyshuar për sëmundje infektive - Të njohurit me simptomat dhe shenjat e grupeve të sëmundjeve infektive dhe sëmundjeve të veçanta infektive - Të njohurit me ecurinë e sëmundjeve të veçanta infektive ne persona paraprakisht me shëndet të mirë dhe në ata me komorbiditete - Të njohurit me parimet themelore të diagnostimit të sëmundjeve infektive, njohja me testet e ndryshme diagnostikuese, rëndësinë e këtyre metodave dhe testetve si dhe interpretimin e tyre në rstin specifik - Të njohurit me parimet e mjekimit simptomatik dhe specifik antimikrobik për sëmundjet e veçanta infektive - Të njohurit me parimet e profilaksës antimikrobiale për sëmundjet e veçanta infektive | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjëratat | 3 | 5 ditë | 15 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | 5 | 5 ditë | 25 |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 10 |
| Përgatitja për provimin final | | | |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 50 |
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjëratat, ushtrimet praktike me pacientët me sëmundje infektive | | |
| Metodat e vlerësimit: | Pjesëmarrja aktive 40% Përfundimi i portfolios 60% Përfundimi i këtij moduli kontribuon (me proporcion) në arritjen e 8 ECTS për grupin e lëndëve të parapara në planprogram | | |
| Literatura primare: | Tolaj I, et al. Sëmundjet Infektive . Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, 2018. | | |

| | |
|---------------------------|---|
| Literatura shtesë: | Essentials of Clinical Infectious Diseases, Second Edition. by William F. Wright Introduction to Clinical Infectious Diseases by Joseph Domachowske (Editor) Mandell, Douglas, and Bennett's Principles and Practice of Infectious Diseases, ed.9 by John E. Bennett; Raphael Dolin; Martin J. Blaser Harrison's Infectious Diseases, ed.3 by Dennis L. Kasper; Anthony S. Fauci |
|---------------------------|---|

| Hartimi i planit mësimor | |
|---------------------------------|---|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| Dita 1: | Menaxhimi dhe diagnostikimi i Sindromit akut respirator |
| Dita 2: | Menaxhimi i Sepses |
| Dita 3: | Menaxhimi i sindromit të paralizës akute flakside |
| Dita 4: | Diagnostikimi dhe menaxhimi i gjendjeve kronike febrile |
| Dita 5: | Diagnostikimi dhe diferencimi diagnostik i sindromes akute hemoragjike. |

| Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes |
|--|
| <p><i>Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.</i> <i>Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.</i> <i>Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.</i></p> |

125. OTORINOLARINGOLOGJIA

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Mjekësisë |
| Titulli i lëndës: | Otorinolaringologjia |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | I obligueshëm |
| Viti i studimeve: | Viti i VI Semestri i XI |
| Numri i orëve në javë: | 3 ditë (3+0+5) |
| Kreditë ECTS: | 1.2 |
| Koha / Vendi: | Klinika e Otorinolaringologjisë |
| Mësimdhënësi: | Prof. Dr. Qazim Hysenaj |
| Të dhënat kontaktuese: | Email: qazim.hysenaj@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda në përmbajtje ka për qëllim njohjen e praktike të studenteve me lëndën e ORL-KKQ, |

| | | | |
|--|---|------------------|-----------------|
| Qëllimet e lëndës: | Zhvillimi i mësimin nga lënda e Otorinolarinologjisë-Kirurgjisë së Kokës dhe Qafës sipas planit dhe programit mësimor të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë; Përgatitja praktike e studentëve për doktor të mjekësisë, për punë praktike dhe njohuri teorike | | |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të aftësohet për ekzaminimet në këtë lëmi; Të njoh ndryshimet patologjike; 2. Të jetë në gjendje që të bëjë diagnostikimin e patologjive të ndryshme nga kjo lëmi; 3. Të jetë në gjendje që për shumicën e sëmundjeve që kërkojnë trajtim adekuat; 4. Të kërkojnë metoda të veçanta diagnostike dhe trajtim duke u përkujdesur të dij cilat raste referohen te specialisti | | |
| Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
| Ligjëratat | 3 | 3 | 9 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | 5 | 3 | 9 |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 6 |
| Përgatitja për provimin final | | | |
| Total | 30 | | |
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjëratat, ushtrimet praktike me pacientët me sëmundje | | |
